

ERE HËNA

www.bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk

Revistë kulturore informative islame

Loja me ndjenjat fetare është lojë me zjarr



Arabia Saudite
njohu Shtetin
e Kosovës

Faqe 12



Dialogu objektiv
me Papën e Vatikanit

Faqe 14



Mësim-besimi fetar
nëpër shkolla shtetërore
po ose jo

Faqe 22



Nuk ka dhunë në fe

Faqe 36

Islami, mbrojtës i kulturave shoqërore

Abaz ISLAMI

Feja Islame është e ngritur mbi tre koncepte të cilat përbëjnë fundamentet kryesore të saj përmes së cilave vihet deri te formësimi i individit dhe shoqëris në tërësi. Besimi në Zotin xh.sh nga bindja që krijon një besimtar mysliman është se të gjithë shoqëritë janë krijesa të All-llahu xh.sh. Pjestari i fesë Islame e ka obligim parsorë të respekton gjithë atë çka i takon ndonjë shoqërie tjetër duke filluar nga tradita, kultura, zakonet, veçorit e trashigimisë kulturore e deri tek elementi më i vogël që llogaritet pjesë e atij religjioni apo feje. Koncepti mbi të drejtën Islame na jep një definicion të qartë se në Islam ka ligje dhe rregulla mbi të cilat ndërtohet shoqëria. Përmes të së drejtës që Islami e përkufizon bëhet ruajtja dhe mbrojtja e të drejtave individuale dhe kolektive, të etnitetëve dhe pjestarëve të religjioneve tjera. Në bazë të atyre ligjeve ndërtohet shteti multietnik dhe multikonfesional duke respektuar dallimet që përfaqësojnë ato. Koncepti i jurisprudencës islame ndërton shoqëri me vlera dhe ngritë atë në të gjitha aspektet. Ndërton individ që respekton ligjin, shtetin, kulturat dhe traditat, i bazuar në atë që është e shpallur nga Zoti xh.sh. Koncept që mundëson çdo qytetarë të kupton përgjegjësinë, të ngritë vetëdijen fetare dhe intelektuale, duke e ndërtuar personalitetin e tij me virtyte pozitive, e njejtën duke reflektuar në rrethin më të gjërë. Ndërsa, me konceptin e moralit (etikës) arrihet deri tek afirmimi i vlerave kulturore dhe fetare të një populli nga njëra anë dhe respektimi i po atyre nga ana tjetër. Etika luan një rol shumë të rëndësishëm dhe pozitiv në edukimin, emancipimin dhe formimin e shoqërisë së drejtë dhe profitabile

Kur bie fjala tek koncepti i parë fundamental i Islamit e që është besimi në ekzistimin e krijesës absolute Allahun xh.sh., mbikqyrës dhe i gjithëdijshëm, tek çdo besimtar ekziston besimi (bindja) se qenia absolute Allahu xh.sh në vazhdimësi përcjell çdo individ, shkalla e lartë e dijes së Tij na flet se posedon njohuri për atë që është e shfaqur dhe atë që është e fshehur dhe se me këto bindje ndërton qëndrime se çdo njeri duhet të kontribuon në ruajtjen e vlerave shoqërore.



Historia asnjëher nuk na flet se Islami ka bërë ndryshimin e saj(historisë njerëzore) për interesat e saj, e as më pak të grabit diçka nga ajo, apo t'i mveshë vetvetes. Liberalizmin fetar që promovoi Islami është mënyra më e përkryer që mund të haset në ndonjë sistem juridik dhe më gjërë.



LIBERALIZMI FETAR

Zhvillimet shoqërore fillimisht na prezentojnë evoluimin e njeriut ndërkohë me zhvillimin e kulturës, tashigimisë historike dhe civilizimit të tyre, dëshmojnë se e gjithë ajo që u takon atyre do të jetë pasqyr për gjeneratat e reja. Për të mbrojt trashigimin kulturore doemos duhet krijuar kushte dhe opinion për mos zhdukjen e tyre. Lidhur me këtë çështje janë paraqitur mendimtarë dhe ideologë të ndryshëm për të kontribuar trashigimisë së shoqërive. Gjatë periudhës së kaluar ka pasur teoristë politikë të quajtur liberalë, nga më të rëndësishmit e të cilëve janë Adam Smith në shekullin e XVIII që i dha një rëndësie të madhe filozofike, pastaj Xhon Stuart Mill, etj. Idetë e Tomas Hobsit, Xhon Lokut dhe Imanuel Kantit kishin një influencë të madhe në teorinë liberale, me të cilat mundësuan që shoqëria perëndimore të pranon çdo kulturë tjetër duke mos thithë dhe dëmtuar atë. Mes filozofëve bashkëkohorë John Rawls është padyshim më i shquari i liberalizimit për të cilin është shkruar shumë, edhe pse kujdes i ishte dhënë formave të liberalizimit të përparuar nga Aron, Dewey, Habermas i dhanë jehonë të madhe zhvillimeve perëndimore përmes teorive të tyre. Shiquar Islamit nga një këndvështrim më i gjërë vërejmë se kemi të bëjmë me një fe e cila avanson çdo kulturë, civilizim dhe qytetërim. Islami i ka

dhënë edhe një ngjyrë më të bukur shoqërive aty ku morri pjesë, e në asnjë mënyrë nuk bëri dëmtimin e tyre. Islami nuk është ngritur nga vepra e myslimanëve, por njëashtu nuk është ngritur nga thënie të mendimtarëve perëndimor.

BOJKOTIMI I KONFERENCËN PËR RACIZËM NË GJENEVË

E kaluara e feve në botë është e mbushur përplot me ngjarje të tmerrshme persekutimi dhe intolerance. Shumë popuj në emër të së drejtës kanë shfrytëzuar rastet që të persekutojnë kultura dhe civilizime të popujve anekënd globit, mbi të cilët është ushtruar dhe përdorur dhunë, e cila u ka shërbyer qëllimeve të ndryshme kolonialiste, siç u trajtuan popujt mysliman dhe të tjerët nga evropianët të krishterë. Historia asnjëher nuk na flet se Islami ka bërë ndryshimin e saj(historisë njerëzore) për interesat e saj, e as më pak të grabit diçka nga ajo, apo t'i mveshë vetvetes. Liberalizmin fetar që promovoi Islami është mënyra më e përkryer që mund të haset në ndonjë sistem juridik dhe më gjërë. E gjithë këtë e ka bazuar në atë që ka prezentuar dhe në atë që ka ndërtuar ithtarët e vet në atë frymë që të jenë ndërtues e jo rrënues, vlerësues e jo zhvlerësues, kontribues të denjë e jo iniciues konfliktesh, tolerant e asnjëher intolerant. Në të vërtetë zhvillimi i normave liberale në politikën globale në shekullin në vijim na flet qartë për nevojën e individit në shoqëri për tolerancën

dhe respektin ndërkonfesional dhe ndërshtetëror. Periudha e reformimit duhet edhe më tej vazhduar më të vetmin qëllim që të zhduken ambicjet e kolonializmit modern që janë duke e ushtruar disa shtete me industri dhe ekonomi të zhvilluar ndaj popujve të pazhvilluar.

Në konferencë ndërkontinentale të mbajtur gjatë mesit të muajit Prill të këtij viti (18.04.2009), të organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për racizmin në Gjenevë, bëri mospërfilljen e kësaj konference nga disa shtete perëndimore. Realizimi i shumëpritur i kësaj konference ndërkombëtare e cila vlerësohej si një nga më të mëdhatë të organizuar ndonjëherë u bojkotua nga disa vende perëndimore.

Konferenca kishte si objektivi të shqyrtojë përparimet dhe shënimin e të arriturave globale në luftën kundër racizmit që prej takimit të fundit në Afrikën e Jugut para tetë vitesh.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Izraeli dhe disa shtete të Evropës perëndimore nuk morën pjesë gjegjësisht e bojkotuan mbajtjen e kësaj konference duke u larguar nga ajo me pretekst se shtetet arabe po përpiqeshin ta cilësojnë sionizmin si dukuri raciste.

Ato janë ndër vendet që kanë thënë se nuk do të marrin pjesë në takimin e Gjenevës dhe se të njëjtat kanë vlerësuar se ajo që po i përshkruhet shtetit sionist është e padrejtë kundrejt asaj që është bërë mbi popullin hebraik para dhe pas Luftës së Dytë botërore.

Papa Benedikti XVI shprehu përkrahjen e tij për organizimin e kësaj konference me çka shoqëritë janë duke kuptuar vlerat e respektit të ndërsjelltë ndërshtetëror dhe ndërkulturore. Shtetet që po e etiketojnë Islamit kinse gjatë historisë ka bërë padrejtësi mbi shumë popuj duke zhdukur kulturën dhe trashëgiminë historike të po atyre popujve, atëherë sigurisht se duhet shqyrtuar deklaratat e tyre dhe gjithë atë që është thënë mbi shoqërinë myslimane në mënyrë të padrejtë. Këtë edhe organizatat ndërkombëtare e kanë shprehur duke theksuar se kjo që po e bëjnë disa shtete lidhur me këtë konferencë ndërkombëtare na fletë mbi perspektivat e së ardhmes së botës dhe rendit botëror. Sa për ilustrim organizata për të drejtat e njeriut, Human Rights Watch, tha se ato vende që po e bojkotojnë konferencën, po iu kthenin shpinën viktimave të racizmit.



TE KUJT JANË VAKËFI DHE XHAMITË!?

Pas reagimit të Bashkësisë Fetare Islame lidhur me gurthemelin e filarmonisë në pronën e saj, pronë e cila është në procedurë e sipër të denacionalizimit, nga bota e harresës, në opinion dolën dy "brojtës" të kauzës ortodokse, me apelet e tyre përplotë me shije dhe orekse fashizoide e nacionaliste.

I pari, me kredibilitetin e "profesorit" bën nëpërkëmbjen e pasurisë së vakëfit duke konstatuar se "toka islame" me shkuarjen e turqve i mbetet Republikës së Maqedonisë dhe se shteti me të bën çka të dojë!

I dyti, me kredibilitetin e "kryetarit" shpejtoi që ta plotësojë të parin duke "zbuluar" se xhamitë e ndërtuara në kohën osmane i takojnë shtetit e jo Bashkësisë Fetare Islame, sepse ato i kanë ndërtuar vetë maqedonasit ortodoks si haraç robëresh dhe jo turqit dhe shqiptarët muslimanë!

Edhe i pari edhe i dyti, me konstatimet e tyre ndaj pronës së vakëfit dhe xhamive, nxorën në pah logjikën patologjike ndaj pronës dhe objekteve fetare që i takojnë bashkëqytetarëve të tyre, të cilëve "të tjerët" ua kanë ndërtuar xhamitë dhe sipas kësaj muslimanët e këtij vendi, nuk duhet të habiten, nëse në të ardhmen për iks arsye apo për interesa shtetërore, secilës xhami i vihet dryni.

Neglizhenca për kthimin e vakëfit të nacionalizuar dhe mosdhënia e lejes për mëkëmbjen e xhamive të rrënuara tregon qartë se organet kompetente kanë çasje të një logjike të këtillë, logjikë kjo që muslimanët e këtij vendi i bënë të jenë të diskriminuar dhe qytetarë të rendit të dytë.

Përndryshe s'ka si të kuptohet kthimi i tërësishëm i pronës bashkësive tjera fetare, apo ndërtimi i kishave edhe në vende që nuk kanë ekzistuar fare, e në anën tjetër zvarritet procedura e kthimit të vakëfit me vite të tëra dhe nuk jepet leje për ndërtimin e xhamive, së paku aty ku kanë ekzistuar.

Pra, një qëndrim i këtillë ndaj vakëfit dhe xhamive, parashtron pyetjet se deri kur do të merret nëpër këmbë pasuria e vakëfit, pse ajo nuk ka të njejtin tretman si pronat tjera në vend, pse organet kompetente sillen me të sikur fare nuk ekzistojnë muslimanët në këtë vend.



REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME



Botues:
Rijaseti i BFI në RM



Redaksia:
Agim Mehmeti
Abaz Islami
Skender Buzaku



Redaktori teknik:
Halil Berisha



Telefonat e redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk
e-mail: bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen



16


BESIMI NDJENJË E
PARALINDUR

BASHKËSIA
ISLAME
SHQIPTARE "HËNA
E RE" NË
KREUZLINGEN TË
ZVICRËS



18

PROMINENCA
AKLIMATIZUESE E
SISTEMIT ISLAM
DHE MODELET
POLITIKE TË
AKROPOLIT
FITROPERENDIMO




20



34

DITURIA KA MBËSHTETJE NË KUR'AN DHE SUNNET

MUHAMEDI
A.S. DHE
MESAZHI I TIJ I
PAQES



38

FETARËSIA E
BARACK OBAMËS
MODEL EDHE
PËR
LIDERËT SHQIP-
TAR



46

Leximi i Kur'anit
mrekulli e veçantë ... 21

Njerëzimi i përmalluar
për dashuri ... 24

Qëllimi i Arsimit
Islam ... 29

Koncepti i
sunnetit në edukimin
e individit (2) ... 31

Dituria - një nga
mekanizmat kryesorë të
qytetërimit Islam ... 32

Mesazhi i fundit i
Muhamedit a.s. ... 39

Ihvanus-Safa dhe
muzika ... 40

Përdorimi i
alfabetëve ... 41

Libri i Kafsheve ... 42

Atomi .. 44

Roli mobilizues i fesë në
Lidhjen Shqiptare
të Prizrenit ... 48

Hafiz Ali Korça ... 51

H. Sulejman ef. Rexhepi uron krerët e shtetit Shqiptar anëtarësimin në NATO

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema

H. Sulejman ef. Rexhepi ka uruar presidentin shqiptar

z. Bamir Topi, kryeministrin

z. Sali Berisha dhe

kryeparlamentaren znj. Jozefina Topalli për anëtarësimin e shtetit shqiptar në NATO

Në urimin e tij Reis ul Ulema i BFI është shprehur se: "Shqipëria anëtare e plotëfuqishme e Aleancës NATO paraqet sendërtimin e dëshirave dhe synimeve të të gjithë shqiptarëve, brenda apo jashtë kufinjëve gjeografik. Kënaqësia dhe gëzimi me këtë rast janë të paimagjinueshme dhe unë ju bashkangjitem atyre në emrin tim personal sikur edhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të



Maqedonisë dhe të një milion besimtarëve muslimanë që janë pjesëtarë të saj.

Uroj që nën udhëheqjen e juaj të urtë, Shqipëria dhe shqiptarët të vazhdojnë rrugën e sigurtë drejtë familjes evropiane, njëkohësisht

duke rrezatuar miqësi dhe dialog në rajon e më gjërë". Në vazhden e këtij urimi kryetari i BFI shprehi që "Shqipëria dhe populli i saj t'i realizojnë deri në fund objektivat e tyre, duke rrezatuar konstruktivitet e dialog në rajon. Stabiliteti dhe



siguria e Shqipërisë si pjesë e strukturave euroatlantike, paraqet siguri dhe stabilitet edhe për të gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë shtetit Shqiptar".

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

**Reisul-Ulema i BFIM,
H. Sulejman ef. Rexhepi**

Përfaqësues të Bankës Islame për Zhvillim vizituan kreun e BFI-së

Bashkësia Fetare Islame në R.M që nga 02.04.2009 deri më 05.04.2009 ishte nikoqire e përfaqësuesve të Bankës Islame për Zhvillim me seli në Xhidde të Arabisë Saudite, gjegj. të D-r. Avad al Asaime dhe Muhamed Ahmed Salem.

Bashkësia Fetare Islame që nga viti 1991 ka krijuar marrdhënie të mira dhe të fuqishme bashkëpunimi me Bankën Islame për Zhvillim në disa sfera dhe për realizimin e disa projekteve të mëdha. Bashkëpunimi i BFI me Bankën Islame për Zhvillim është vërejtë dukshëm, andaj ky kooperim edhe më tej vazhdon në linjë të ndërsjelltë.

Përfaqësuesit e lartë të BIZH gjatë qëndrimit të tyre vizituan selinë e BFI dhe udhëheqësin e këtij institucioni Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi dhe institucionet edukativo arsimore si Medresenë Isa-Beu dhe Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Banka Islame për Zhvillim ka participuar edhe në ndërtimin e Fakultetit të Shkencave Islame gjatë viteve 1995/97. Meqë BFI viteve të fundit ka zgjeru shkollën e mesme teologjike Medresenë Isa-Beu në disa qytete në teritorin e R.M me hapjen e disa paraleleve për meshkuj dhe femra, qëndrim të cilin përfaqësuesit e BIZH përshëndetën politikën e BFI në zgjerimin e shkollës së mesme teologjike. Medreseja Isa-Beu me zgjerimin e saj në disa qytete është



duke ofruar kushte për edukimin e gjeneratave të reja, dhe një mundësi e re për prodhimin e teologëve të rij që do të kontribuojnë për Islamin dhe shoqërinë në të ardhmen.

Një nga projektet e BFI që është duke u realizuar dhe i cili tani më është tradicional dhënia e bursave për studentët tanë në R. e Maqedonisë.

BFI pas kësaj përvoje të fituar disa vjeçare me bankën në fjalë themeloi fondin për bursa studentore të quajtur "FONDI i VAKUFIT BURSATOR". Deri më tani kanë përfunduar studimet një numër i madhë studentë që kanë shfrytëzuar bursa, edhe më tej do të vazhdohet dhënia e bursave. BFI me realizimin e këtij projekti disa vjeçarë po dëshmon pjekuri të lartë institucionale në përkujdesjen e studentëve musliman pamëvërrësisht se çka ata studiojnë. Bursa

studentore ndahet për studentë të Mjeksisë, Stomatologjisë, Arhitekturës, Ndërtimtarisë etj. Në shenjë të themelimit dhe pikënisjes së funksionimit të fondit për bursa studentore më 03 Janar 2009 në lokalet e BFI u realizua një takim në mes përfaqësuesve të BFI dhe studentëve për të kurorëzuar realizimin e këtij projekti. Bashkësia Fetare Islame në R.M në krye me Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi në kontinuitet hapëron me realizimin e projekteve të reja që kanë të bëjnë me institucionet edukativo-arsimore. Veprimtari e cila është theksuar në disa fusha, kësaj rradhe u përqëndrua që të ofron kushte dhe standarde ende më të larta për studentët që ndjekin studimet në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Gjatë vizitës së përfaqësuesve nga BIZH në FSHI të shoqëruar nga Sekretari Gj. H

Afrim ef. Tahir, Dekani i FSHI morrën pjesë në përmbylljen e ceremonisë të lëshimit në përdorim të internatit për studentët. Në përfundim e sipër është projekti mbi ngritjen e standardeve shkencorohulumtuese në F.S.H.I. Fillimisht, në suaza të këtij projekti është bërë sanimi i objektit (godinës) të Fakultetit, rregullimi i amfiteatrit të Fakultetit, salla e studimit për studentët aktual dhe gjeneratave të ardhshme që do të ndjekin studimet postdiplomike, si dhe pajisje të reja në Fakultetin e Shkencave Islame, Shkup.

Vizita e përfaqësuesve të BIZH vazhdoi edhe në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me donacionin për Klinikën e qytetit të Tetovës, për konkretizimin e projektit të cilën BFI e ka inicuar në BIZH që nga fundi i vitit 2007. Njëherit nga BFI u kërkua mendim se donacioni në fjalë duhet të përkrahet apo refuzohet, sepse kjo është kusht për bashkëpunim me shtetet joanëtare të kësaj banke.

Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi përmes një shkrese kërkoi nga BIZH që të jepet donacioni në fjalë. Vitin e kaluar personalisht Kryetari i BFI, Reis ul Ulema vendimin pozitiv për ndarjen e 600.000 \$ ia dorëzoi Kryeministrit të Qeverisë së R.M, z. Nikolla Gruevski. Lidhur me këtë donacion për Ministrinë e Shëndetësisë, Reis ul Ulema ishte për vizitë në selin e Bankës Islame për Zhvillim nga 02.03.2009 deri më 07.03.2009.

U lëshua në përdorim xhamia "Haxhi Azemi" në lagjen Orizare të epërme

Më 10.04.2009 (e premte/xhuma) në Shkup u bë hapja solemne e xhamisë së "Haxhi Azemi" në Lagjen Orizare të epërme. BFI në krye me Reis ul Uleman H. Sulejman ef. Rexhepi po zgjerojnë ritmin e veprimtarisë së tyre duke ngritë edhe një xhami të re në kryeqendrën tonë.

Hapja solemne e kësaj xhamie u bë edhe më e pasur ku përveç pjesëmarrjes së Kryetarit të BFI morrën pjesë edhe strukturat tjera të këtij institucioni, Atesheu për çështje fetare praën ambasdadës së R. Turqisë, z. Bahatin Bildik, Prefekti i komunës së Shuto Orizares dhe deputeti i kësaj ane z. Amdi Bajram. Programin e hapjes solemne të xhamisë "Haxhi Azemi" e bëri referenti për arsim praën Myftinisë së Shkupit Ismet ef. Bytyqi. Në fjalën hyrëse përshendeti prezencën e Resi ul Ulemasë, Myftitë e Myftinive të BFI, përfaqësuesin e ambasadës së Turqisë, prefektin e komunës dhe deputetin e kësaj ane në kuvendin e R.M. Me këtë rast fjalë përshendetës e mbajti Myftiu i Myftinisë së Shkupit, Ibrahim ef. Shabani theksoi se: "Myfti i Muftinisë së Shkupit në mënyrë të hapur shprehi bindjen se do të jetw i ndihmuar nga Reisu Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, Riaseti i BFI-së, si dhe nga të gjitha subjektet relevante të cilat sfidojnë përmbushjen e objektivave jetike dhe vlerave fetare të vendit tonw, me ndihmën e të cilëve gjithsesi mund të arrihet edhe kthimi i pronave të cilat në forma dhe mënyra të ndryshme kanë qenw të nacionalizuara në të kaluarën". Mes tjerash shtoi se:



Myftinia e Shkupit do të angazhohet edhe në kthimin e xhamive Faik Pasha, Arasta dhe të tjera të cilat kanë ekzistuar në këtë anë të Vardarit, si dhe Burmalit xhamisë që gjendet andej lumit Vardar për të cilat veçmë kemi formuar edhe këshilla iniciativ për ndërtimin e të njëjtave".

Më pas me këtë rast fjalim mbajti Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi i cili vlerësoi pa masë veprën e Haxhi Azemit, duke përkujtuar se këtë e ka bërë me ndihmën e miqëve dhe dashamirëve të fesë. "Xhamitë njëherit llogariten tempuj të shenjtë ku roli i tyre përveç që është në realizimin e obligimeve ditore është i evidentuar edhe në ngritjen e besimit në Fuqinë absolute All-llahun xh.sh., edukimin, ndikimi pozitiv i xhamis në aspektin etik(moral) dhe në të gjithë sferat ku vjen në shprehje dobia dhe siguria e shoqëris myslimane në vendin tonë dhe më gjërë". Kryetari i BFI nderoi me mirënjohje personalitet që kontibouan në ndërtimin e kësaj xhamie. Fillimisht

mirënjohje pranoi Haxhi Azemi, ai që me ndihmën e Zotit tejkaloi pengesat gjatë ndërtimit të kësaj xhamie. Mirënjohje morrën Haxhi Shabi Pajaziti dhe Imer Imeri, personalitet që ndihmuan gjithashtu në përmbylljen dhe rrumbullaksim të kësaj xhamie. Në fund të këtij programi ashere këndoi M-r. Abaz Jahjai, duanë e bëri myftiu i myftinisë së Gostivarit H. Shaqir ef. Fetahu, hutben e namazit të xhumasë e realizoi teologu i posa emëruar hfz. Xhelal Zeqiri, ndërsa namazin e xhumasë e realizoi myftiu i myftinis së Tetovës, H. Alifkiri ef. Esati. Këtë solemnitet e begatoi kori i Medresesë së Isa-Beut me këndimin e ilahive. Për Imam Hatib, Vaiz dhe Mualim në këtë xhami u autorizua nga Reis ul Ulema teologu hfz. Xhelal ef. Zeqiri, i cili ka mbaruar medresenë Isa-Beu në Shkup, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Më pas me përfundimin e namazit të xhumasë pasoj edhe drekë e organizuar nga Haxhi Azemi në restorantin "Kalabria".



AMBASADORË TË
REPUBLIKËS ARABE TË
EGJIPTIT VIZITOJNË BFI

Ta njohin mëvetësin e Kosovës e gjithë bota arabe

Më 03.04.2009, në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi ishte nikoqir i ambasadores nga Ministria e Punëve të Jashtme, znj. Safije Ibrahim Amin dhe ambasadores së Egjiptit në Bullgari znj. Hiba el-Mirasi.

Në këtë takim Reis ul Ulema njohtoi për veprimtarinë institucionale që është duke e realizuar BFI në shumë sfera dhe dimensione, nevojën e zhvillimit të jetës fetare në RM dhe me problemet me të cilat ballafaqohet institucioni në realizimin e qëllimeve.

Në këtë takim me theks të veçantë u bisedua rreth tri problematikave apo më mirë thënë mbi tri çështje: Ekspreicencën e fituar nga Kongreset mbarëbotërore Islame të organizuar nga shteti Egjiptian në kryeqendrën e saj në Kairo. Bashkëpunimin që e kemi në mes të BFI dhe Universitetit më të vjetër në botë Al-Az'her në Egjipt. Njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet arabo-islame.

Kongresi i fundit i realizuar nën patronatin e kryetarit të Egjiptit, ekselencës së tij z. Muhammed Husni Mubarek me temë kryesore: "Ripërtërirja e mendimit Islam" ishte edhe një dëshmi për kapacitetin dhe nivelin e lartë organizativ të organizatorit të këtij kongresi. Reis ul Ulema lidhur me këtë Kongres shprehi eksperiencën që kishte fituar nga këto kongrese dhe reflektimin pozitiv që patën tek mendimtarët dhe ulematë në gjithë botën islame.

Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga bota arabe theksoi se njohja sa më e shpejtë nga ana e Republikës Arabe të Egjiptit do të ishte një hap që do të ndikonte që ky shtet i ri të njohet edhe nga shumë shtete të tjera arabo-islame, kjo duke theksuar pozitën që ky shtet e mban në mesin e tyre.

Musafiret shprehën kënaqësi për mikëpritjen nga kreu i BFI dhe vlerësuan lartë veprimtarinë e realizuar deri më tani të këtij institucioni fetar dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtutjeshëm në sfera të interesit të përbashkët dhe në dobi të besimtarëve tanë në vend dhe më gjërë.

Për herë të parë në gjuhën shqipe, pas suksesit të jashtëzakonshëm në vende të ndryshme të botës, vjen vepra "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman" në dy vëllime.

Ky libër botohet nën përkudjesjen e veçantë të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC) dhe hedh dritë plotësisht mbi historinë e Perandorisë Osmane. Të shkruash mbi historinë e një perandorie të madhe, e cila përmbodhi shumë shtete në qendër të tre kontinenteve dhe mbikëqyri rrugët ndërkom-bëtare për më shumë se 500 vjet, është njësoj si të shkruash historinë e botës.

Libri "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman" është hartuar nga një grup historianësh turq, ku vlen të përmendësh disa nga emrat më të shquar të studimeve historike, si: Prof. dr. Ekmeleddin ?hsanoglu, Prof. dr. Feridun Emecen, Prof. dr. Mehmet Âkif Aydin etj. dhe është përkthyer në gjuhën shqipe nga AIITC. Ky grup ekspertësh ka inspektuar arshivat e pasura në thellësi dhe ka nxjerrë në pah elementë të rinj të pikturës historike. Pa dyshim që kjo punë kolosale, ka regjistruar një hap shumë të rëndësishëm, që meriton vëmendjen e duhur nga lexuesit.

Autorët, për hartimin e librit, përdorën burimet e arkivave, kronikat osmane, studimet e historianëve bashkëkohorë, si dhe burimet perëndimore. Synimi i librit është prurja e një perspektive të re, duke u bazuar në informacion objektiv dhe të besueshëm nga kërkimet e fundit shkencore. Libri nuk përmban përafrimin klasik të kronologjisë në historiografi me përshkrimet e ngjarjeve gjatë sundimeve të sulltanëve. Përshkrimet jepen vetëm kur është e nevojshme. Gjithçka paraqitet në mënyrë analitike, në përpjekje për ta shpalosur të plotë subjektin dhe në të njëjtën kohë, për të përcaktuar lidhjen ndërmjet shkaqeve dhe pasojave të ngjarjeve politike. Nuk bëhet thjesht paraqitje faktesh, por qartësohen dhe shpjeg-

Botohet për herë të parë në formë të plotë libri "HISTORIA E SHTETIT, SHOQËRISË DHE QYTETËRIMIT OSMAN"



Botimi original turk u publikua në dy vëllime (1994 dhe 1998) dhe mbulon periudhën nga themelimi i principatës osmane, deri në shpallje e Republikës së Turqisë. Këto vëllime u përkthyen dhe botuan në arabisht në vitin 1999, në anglisht në vitin 2002 dhe së fundmi, falë punës këmbëngulëse të AIITC, ky libër vjen edhe në gjuhën shqipe.

gohen me baza argumentuese institucionet e civilizimit osman, duke pasur si pikësynim përfshirjen e të gjithë Perandorisë Osmane, pa përjashtuar Anadollin, Rumelinë dhe Arabinë. Studiues të njohur, specialistë në fushat e tyre, shkruajnë artikuj në këtë libër. Secili nga këta kapituj mund të ishte një libër më vete. Gjithashtu, jepet ecuria e historiografisë dhe shpaloset realiteti osman në tërësi, sepse brenda çdo

periudhe pasqyrohen pikëpamjet politike, shoqërore dhe shkencore. Shumë nga të dhënat dhe informacionet konkretizohen edhe me imazhe e miniatura, me qëllimin për të përcjellë sa më qartë përmasat e Perandorisë Osmane.

Përveç zhvillimeve politike, është trajtuar gjerësisht struktura sociale, ushtarake, studimore dhe e organizimit administrativ, por pa lënë mënjanë aspektin ekonomik,

trëtinë dhe industrinë apo jetën shkencore dhe atë kulturore. Sigurisht, që për të shkruar historinë e një shteti që ka sunduar për më shumë se pesë shekuj dhe që bashkoi shumë shoqëri të ndryshme duke respektuar kombësinë, besimin, kulturën dhe gjuhën, është nevojitur punë kërkimore shumë e gjerë dhe përpjekje të stërmëdha. Është pothuajse e pamundur që një person i vetëm të përfundojë një studim të këtyre përmasave, duke kërkuar burimet e rëndësishme osmane dhe perëndimore. Pa dashur të nënvlerësojmë përpjekjet individuale të historianëve të ndryshëm, theksojmë se libri i historisë osmane duhet shkruar nga një skuadër e organizuar dhe efektive, në vend të një individi të vetëm, i cili disponon mjete dhe mundësi të kufizuara.

Botimi original turk u publikua në dy vëllime (1994 dhe 1998) dhe mbulon periudhën nga themelimi i principatës osmane deri në shpalljen e Republikës së Turqisë. Këto vëllime u përkthyen dhe botuan në arabisht në vitin 1999, në anglisht në vitin 2002 dhe së fundmi, falë punës këmbëngulëse të AIITC, ky libër vjen edhe në gjuhën shqipe. Së shpejti ky botim do të kristalizohet edhe në gjuhën ruse e boshnjake.

Vëllimi i parë trajton organizimin politik, historik, administrativ dhe ushtarak, si dhe sistemin ligjor, ekonominë, financën dhe strukturën sociale osmane. Ndërsa vëllimi i dytë i librit trajton jetën fetare, gjuhën së bashku me letërsinë, historinë e artit dhe arkitekturën, jetën intelektuale, arsimimin dhe fushën shkencore.

Kritika bashkëkohore ka shprehur vlerësim maksimal për nivelin e këtij libri, kjo vërtetohet edhe në pasthënien e përgatitur nga studiuesi Halil Inalxhik. Ky botim përmbush nevojën për kërkime të reja në historinë osmane, si dhe hap horizontet për studime të mëtejshme në këtë fushë. Gjithashtu lexuesin e thjeshtë e pajis me fjalorin e plotë informues mbi shtetin dhe civilizimin osman.

LIBRA TË RINJË


TRINITETI-Misteri shekullor i Krishterimit (Autori: Senad Maku)

ndaj kësaj doktrine, duke cekur emrat e saj që e përmbajnë këtë doktrinë siç janë: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë, duke i elaboruar secilën prej tyre në mënyrë të veçantë sipas citateve Biblike dhe ajeteve Kuranore.

Kurse në kapitullin e tretë dhe të fundit të këtij punimi e cila njëherit është edhe e titulluar:

"TRINITETI DHE VËRTETËSIA E SAJ", ku janë shqyrtuar citatet që sipas të krishterëve e argumentojnë këtë doktrinë.

Pastaj është folur për mendimet e personaliteteve të njohura rreth trinitetit dhe për fund autori ka shtjelluar pikëpamjet Kuranore të kësaj doktrine.



Përgjigje ndaj deklaratës së dhënë nga KBM për mediumet më 13.04.2009

Me shqetësim e pranuar deklaraten e dhënë nga Kongresi Botëror Maqedon për disa media në Maqedoni në të cilën zhvendosen ngjarjet historike të së kaluarës, të lidhura me Bashkësinë Fetare Islame, kulturën islame, si dhe me statusin e pronës gjegjësisht vakufin e Bashkësisë fetare Islame në R.M.

Opinionin (mendimi) se në periudhën e sundimit të Perandorisë Osmane i kanë ndërtuar ortodoksët maqedon si haraç në periudhën e skllavërisë të cilën mund ta quajnë vetëm personalitete të cilët para syve nuk shohin dhe me veshë nuk dëgjojnë, personalitete që kanë kataraktë jo vetëm në sy por edhe në zemër, përplot të mbushur me urrejtje, qëllimkeq dhe nënçmues me qëllim të tjerët t'i zhvlerësojnë, kulturën e tyre ta përqeshin, ndjenjat e tyre t'i lëndojnë. Xhamitë vazhdimisht i kanë ndërtuar muslimanët dhe me mjetet të tyre për vetvete dhe asnjëherë ata nuk kanë qenë të ndërtuara nga të tjerët, posaçërisht jo me punë imponuese e as me mjete imponuese. Ndërtimi i të drejtave dhe historive në bazë të legjendave dhe miteve pa asnjë fakt historik bëjnë individ të cilët nuk kanë histori të realtë dhe të vërtetë, të cilët vetvetiu nuk njihen e as që kanë vlera kulturore e civilizuese personale.

Bashkësia Fetare Islame në R.M., është institucion fetar konstantë ndër kohë që nga paraqitja e Islamit në këto hapësira e deri më tani. Edhe

atëherë kur ka qenë pjesë e asociacioneve të gjëra apo aleate (lidhje) e bashkësive fetare të këtyre hapsirave, vazhdimisht e ka ruajtë dhe ruan autonominë e saj, andaj për shkak të saj ka të drejtë të patëhuajsuar personale ndaj të gjitha gjeneratave muslimane të cilët e kanë ndërtuar si nevojë shpirtërore në këto anë dhe e gjithë ajo që na e paraqet si pronësi të saj. Bashkësia Fetare Islame asnjëherë nuk ka përjetu që të jetë e ndarë, e përfutur nga ndonjë bashkësi tjetër fetare ose prona e saj të udhëheqet nga bashkësi fetare fqinje ashtu siç ka përvojë me disa institucione tjera fetare në vendin tonë. Nëse e drejta antike (e vjetër) për pronësi të kulturës shpirtërore fetare i takoj dikujt në këto hapsira pikërisht është Bashkësia Fetare Islame, atëherë është e dhimbshme që kontinuitetit t'i merret e drejta, ndërsa diskontinuitetit t'i pranohet e drejta hiostorike e ekzistimit.

Xhamitë gjithnjë janë ndërtuar në hapsira jo ndërtuese edhe ajo na paraqet principe të larta fetare islame. Sigurisht, se gjatë historisë ka pasur përjashtime nga forca lokale dhunuese të cilët kanë ndërtuar në kundërshtim me principin e lartëthekësuar por me gjithatë ato janë përjashtime. E drejta ashtu si historia nuk mund të ndërtohen në bazë të përjashtimeve. Legjenda në Maqedoni ka për çdo xhami, kinëse është e ndërtuar mbi themele të

kishave edhe atë në bazë të një urrejtjeje ndaj Islamit dhe islamofobisë së planifikuar tek struktura të caktuara me të vetmin qëllim që të zhdukun kulturën islame nga këto hapsira. Sondet në xhaminë e Murat Pashës në Shkup, sondet në xhaminë Sulltan Pajaziti në Kërçov, sondet në Çarshi xhaminë e djegur në Prilep, si dhe në shumë xhami tjera për të cilat legjendat flasin se janë të ndërtuara mbi themele të kishave e tregojnë pikërisht të kundërtën.

Filloi kthimi i pronës së Bashkësisë Fetare Islame e cila ishte me pa të drejtë e nacionalizuar edhe pse jo me tempon e dashur, por për fat të keq të KBM, rregullat pozitive ligjore të shtetit e pranojnë dhe e respektojnë Bashkësinë Fetare Islame si subjekt fetar dhe juridik i padiskutueshëm historik dhe aktual. Dëshira e parashtuar në qëndrimet e KBM të mos kthehet prona (vakufi) dhe xhamitë e Bashkësisë Fetare Islame mund ta përcjellin vetëm logjika të cilat kanë nevojë për terapi nga aspekti i bashkëjetesës dhe respekti i ndërsjellt. Gjithashtu dëshira që të ekziston përveç BFI edhe një bashkësi tjetër islame në Maqedoni, mund ta shprehin vetëm individ të cilët janë të ngarkuar me helmime historike të shkallës së lartë, ndërsa me ate mund t'i sjellin më shpejt dëm bashkësisë së tyre fetare sesa Bashkësisë Fetare Islame në R.M që ka një kontinuitet të padiskutueshëm

historik.

Në xhamitë ashtu si gjithëkund në botë edhe në R.M kryhet ceremoni fetare në gjuhën në të cilën e kuptojnë besimtarët. Edhe në kryeqendrën tonë, në Shkup predikimet dhe ceremonitë fetare kryhen në gjuhën shqipe, turke, boshnjake, rome si dhe në gjuhën maqedone më saktësisht për ata që për herë të parë e pranojnë Islamit si fe personale. Bashkësia Fetare Islame në R.M nuk ka asnjë problem me maqedonët ashtu në deklaratën siç quhet " me fe islame", por të njetët kanë probleme me një institucion tjetër që qëndron me bindje se vetëm besimtarët ortodoks mund të jenë maqedonë. Ashtu që KBM nuk duhet që t'i mashtrojë maqedonasit me perkatësi fetare islame se e kanë problemin se Bashkësia Fetare Islame për arsye se Bashkësia Fetare Islame me asnjë pyetje nacionale dhe gjuhësore nuk është e ngarkuar, edhe për atë shkak, duhet t'u tregon vendin e vërtetë të problemit.

E kemi obligim që zotërive t'iu tregojmë se Xhamia Burmalë ka ekzistuar dhe se e njëjta me ndihmën e Zotit të plotëfuqishëm do të ekziston edhe në periudhën që vijon pa marrë parasysh islamofobinë e fuqishme të KBM dhe zgjerimin e tendencave të tyre për urrejtje dhe mosbesim ndërfetar. E drejta dhe e vërteta vazhdimisht fitojnë.

Shërbimi për Informim, BFI

Toka nuk është as e "Juaja" as e "Jona", ajo është e Zotit!

Zotëri Marjanoviç

Nuk e dimë pse, por ama fare nuk jemi të mahnitur nga teksti qëllimkeq i publikuar nga ana juaj, pasi që ju e qëlloni pse njëzërit në këtë tokë (shtet) ju përjetojnë si qëllimkeq. Nëse e ndjekim logjikën tënde qëllimkeqe, përgjigjen tonë do ta emërtonim "Toka (ortodokse) e Juaj". Mirëpo, ne jemi qëllimmirë dhe dëshirojmë vetëm të tregojmë se mesazhet dëmtuese të cilat mundoheni t'i adresoni ka Bashkësia Fetare Islame dhe tek muslimanët në tërësi, sa do që të jenë cinike dhe të nënfshehura, i pranuar dhe të njejtat i lexuam. Për fat të keq, zotëri "profesor", shkrimi i juaj i ngjan shkaravitjeve të njeriut shkencë i cili vazhdon të jeton në mjegullirat e së kaluarës, i ngarkuar me bagazh nga i cili kohëve të fundit intenzivisht çlirohen edhe mentorët e tij nga fqinjësia që bartin mbiemra të njejtë. Sa i takon përsëri përmbajtjes së shkrimit të juaj, patjetër të konstatojmë se në atë edhe sika përmbajtje, ka vetëm fshehje nën frigën e brenqosjes së kulturës maqedonase. E dhimbshme është nëse filarmonikët maqedon dhe tempulli i ardhshëm i tyre duhet që ju ta mbron. Edhe atë,

(Përgjigje ndaj tekstit qëllimkeq të Gjorgji Marjanoviç, i publikuar në gazetën ditore " Shpic" më 07.04.2009 me titull " Nivna (islamska) zemja" " Toka (Islame) e tyre")

nga kush? Nga Bashkësia Fetare Islame, nga institucioni që në kontinuitet tregon se i pranon dhe i respekton postulatet e demokracisë, dialogut dhe bashkëjetesës. Në të kundërtën, vetëm t'iu përkujtojmë, Bashkësia Fetare Islame në R.M., asnjëherë nuk ka pretenduar që të bënë uzurpimin e pronave të huaja, por i ka mbrojtur ata dhe do të vazhdojë që t'i mbroj atë që është e saj, ajo që u takon pjestarëve të fesë Islame. Vakufi me siguri i takon BFI në R.M dhe pjestarëve të saj, për të cilat ekzistojnë dokumente valide. Dokumentacion të tillë ne posedojmë dhe për pronën në të cilën planifikohet ndërtimi i filarmonisë së Maqedonisë. Nënkuptohet se jemi të vetëdijshëm për vlerat e filarmonisë për kulturën e një shteti, pikërisht për ate ndjehemi qor për këtë kontest të panevojshëm. Nënkuptohet jemi të bindur se ekziston një zgjidhje e logjikshme e cila do të gjindet dhe do t'i kënaq të dy palët, ashtu edhe Qeverinë e R.M dhe Ministrinë e Kulturës të cilët janë bartës të proektit. Mirëpo, kompromiset i arrijnë

vetëm të mençurit dhe figurat që kanë qëllim të mirë, vetëm individ të cilët janë të gatshëm t'i tejkalojnë mosmarrëveshjet në emër të prosperitetit të përgjithshëm të shoqërisë në të cilën jetojnë. E dhimbshme është " profesor" Marjanoviç, por ju nuk i takoni atij lloji të zgjedhur të njerëzve, ju jeni që herët të bartur nga stuhia e ndryshimeve që kanë ndodhur në shoqërinë tonë dhe sigurisht nuk kuptoni për çka ju flasim. Kaluan kohëra kur" disa njerëz të islamit" kanë ndërtuar çajtoje, ndërsa tani njerëzit e Islamit ndërtojnë universitete, spitale, biblioteka. Madje, çmendurisht mundoheni ta identifikoni kulturën dhe traditën Islame me çajtoje, në përgjithësi gjurmët e saj janë të ndryshme. Edhe diçka, zotëri Marjanoviç. Storja për " tokën turke" e keni shumë të stërpërdorur dhe shumë infantile, çmendurisht po bëni përpjekje ta irritoni opinionin maqedon dhe njëkohësisht ta satanizoni Bashkësinë Fetare Islame. Vetëm shumë njerëzve të humbur mund t'iu shkon ndërmend se në" toka

që dikur ka qenë turke nuk guxon të ndërtohet asgjë", vetë të menduarit për një gjë të tillë i tejkalon kufijtë e mendjes së shëndosh. Ideja e tillë që dine se si është lindur në mendjen e juaj por nuk keni gjetur kopsht ku ta mbjellni. Ne themi se gjithçka që ka qenë turke nuk është vakuf dhe në një tokë të tillë mund të ndërtohet. Bashkësia Fetare Islame në R.M vetëm përkujton se ajo drejton me tokën dhe objektet që prezentojnë vakufin dhe se për atë vakuf është përgjegjëse para pjestarëve të saj dhe para Allahut. Për shkak të lartëthekësuarës, ju lutemi " profesor", kurseni opinionin maqedon nga vërejtje jo të logjikshme, kjo nuk është koha e juaj, ju nuk jeni ai që do ta mbron kulturën dhe traditën e popullit maqedon, ju atë e realizoni plotësisht në mënyrë të gabuar, ju në të vërtetë, me apo pa vetëdije, shndërohni në shpirtkeq. Mos luani me dinjitetin e qytetarëve të juaj pamëvarësisht nga cili kombë ose fe ngase të tillët si ju jo në një të kaluarën jo shumë të largët paraqitët shumë tmerr dhe dhimbje nga të cilat i tërë regjioni nuk arrijti të merret. Qëndroni atje ku jeni në harresë!

Sektori për informim pranë BFI në R.M

Kujdes, Islamofobët po vijnë

Abaz ISLAMI

Në emër të të vërtetës dhe të tolerancës, të dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, në emër të vlerave universale të islamit dhe të krishterimit sikurse edhe në emrin e bashkëjetesës tradicionale të njerëzve të këtij nënqielli, po i drejtohem opinionit të këtushëm e më gjërë me qëllim t'ia tërheqi vëmendjen për përhapjen e urrejtjes fetare që kohëve të fundit po plasohet nga individë dhe organizata të caktuara.

LUZERËT

Maqedonia po kalon nëpër një periudhë të vështirë kontrollimesh e monitorimesh, po ballafaqohet me bençmarkë dhe presione të cilat po e vejnë në pikëpyetje orientimin e saj euro-atlantik, po imponohen dilema rreth emrit të shtetit dhe identitetit të një pjese të qytetarëve të saj. Në një situatë të këtillë, Maqedonia dhe qytetarët e saj duhet të jenë unik, në shumë se kurdoherë është e nevojshme toleranca etnike e fetare me të cilën do të dëshmohej para botës se në këtë shtet vlerat e demokracisë nuk janë emra kuptimi por realitet.

Për fat të keq, pikërisht në këto çaste kaq të rëndësishme për ardhmërinë e vendit dhe të gjeneratave të reja, opinionin po e shqetësojnë individ të sojit të Gjorgji Marjanoviçit e Todor Petrovit dhe KBM-ja e tij, ndryshe luzerë të njohur që asnjëherë nuk kanë arritur ta realizojnë veten në shoqëri. Dhe, pikërisht këta dy individë me një grusht përkrasish, po përplojnë përmes fjalëve të thëna publikisht për të cilat nuk janë në gjëndje të bartin përgjegjësi as përpara njerëzve e as përpara Zotit, ta përhapin dhe ta etablojnë islamofobinë.

Qëndrimi i tyre ofendues ndaj vlerave kulturore islame, ndaj vakufit i cili sipas islamit është i

Mjerisht, jemi dëshmitarë të përpjekjeve për profilimin e islamofobisë në opinionin tonë dhe këtë dukuri nuk do të duhej shikuar me indiferencë. Në Ballkan përherë është e mundur çdo gjë dhe një shkëndi mund të shkaktojë zjarr me përmasa të tmershme dhe pikërisht për këtë shkak është e domosdoshme të prevenohen dukuritë e këtilla



patëhuajsueshëm, insistimi diskriminues e bile bile fashizoid që Qeveria e R.M ta ndërpresë procesin e denacionalizimit të xhamive e të vakufeve, paraqesin

ofendim ndaj BFI në R.M dhe ndaj një milion besimtarëve myslimanë në Maqedoni të cilët, nga ana tjetër, me sjelljet e tyre po kontribuojnë në të gjitha sferat dhe

segmentet të përjetohet bukuria e një shoqërie multietnike e multi-konfesionale.

KUSH DO FLIJOHET

Duke i kundërshtuar faktet e thëna më lartë që janë vetëm një pjesë e arsenalit të ofendimeve të drejtuara ndaj islamit dhe ndaj besimtarëve myslimanë në Maqedoni, kisha dashur që opinionin i këtushëm t'i gjykojë e t'i hedhë poshtë tendencat e këtilla të zotërinjve të përmendur sepse qëndrimet e atilla rigjide mund të shkaktojnë vetëm fatkeqësi. Njëkohësisht, thirrja ime ju drejtohet të gjithë pjestarëve të Islamit që mos të bien pre e provokatorëve dhe provokimeve të këtilla. Individët sikurse Marjanoviçi dhe Petrovi, po shihet qartë se po ballafaqohen me dilema rreth identitetit të tyre intelektual, kombëtar e fetar. Duke mos pasur alternativë dhe shteg tjetër, ata po zhyten në ujërat e turbullta të urrejtjes e të shovenizmit. Mjerisht, jemi dëshmitarë të përpjekjeve për profilimin e islamofobisë në opinionin tonë dhe këtë dukuri nuk do të duhej shikuar me indiferencë. Në Ballkan përherë është e mundur çdo gjë dhe një shkëndi mund të shkaktojë zjarr me përmasa të tmershme dhe pikërisht për këtë shkak është e domosdoshme të prevenohen dukuritë e këtilla. Maqedonia është përfundimisht hapsirë në të cilën kryqëzohen orienti dhe oksidenti, këtu islami dhe krishterizmi ndër shekuj kanë krijuar tradita të bashkëjetesës dhe të respektit të ndërsjellë. Sidoqoftë,

Bashkësia Fetare Islame dhe pjestarët e saj nuk janë të gatshëm t'i flijojnë këto vlera përpara një vale të pakontrolluar të primitivizmit e të shovenizmit. Jemi të bindur se këtë qëndrim e mendim e ka edhe pjesa më e madhe e kësaj shoqërie. Islamofobët po vijnë. Bujrum.

KOMUNIKATË PËR OPINION

Lidhur me Burmalin Xhaminë në Shkup, Bashkësia Fetare Islame e RM informon opinionin se me kontinuitet ka kërkuar ndërtimin e saj në themelet ekzistuese të saj. Pra, në vazhdimësi ka kërkuar ndryshimin e Planit gjeneral urbanistik dhe Planit detal urbanistik. Kërkesat e këtilla janë parashtruar që nga fundi i shekullit të kaluar, e në veçnati gjatë viteve nëntëdhjeta.

Kërkesa e fundit për

ndërtimin e Burmalin Xhamisë, deri te organet përkatëse është parashtruar në prill të vitit 2007 dhe atë disa muaj para se Qeveria të del me vendim për ndërtim të kishës në Sheshin e Shkupit, që do të thotë se kërkesa e BFI-së për ndërtimin e Burmalin Xhamisë nuk është rezultat, apo reagim i vendimit në fjalë të Qeverisë. Po ashtu, informojmë opinionin se BFI-ja lidhur me këtë Xhami dhe xhamitë tjera disa herë ka komu-

nikuar dhe komunikuar me Qeverinë dhe në këto kontakte vjen në shprehje vullneti i mirë i zgjidhjen e çështjeve të hapura.

Këshilli Iniciativ për ndërtimin e Burmalin Xhamisë pranë Muftinisë së BFI-së Shkup është në pritje të konstituimit të Këshillit të Komunës Qendër që edhe njëherë udhëheqësisë së re të kësaj Komuna t'ua paraqes kërkesën për ndryshim të Planit urbanistik dhe në të parashifet

edhe ndërtimi i Xhamisë.

BFI-ja si organizatë e cila merret me oregonizimin e jetës fetaro-islame, garanton besimtarët se ata, për çështjet fetare asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë jetim dhe se lidhur me ecurinë e aktiviteteve dhe hapat që duhet ndërmarr lidhur me Xhaminë Burmalin, me kohë do të informohen.

Shërbimi Informativ i BFI-së

KUSH PO E FALSIFIKON TRASHËGIMINË KULTURORE TË BFIM?

Deklarata e Kryetarit të Kongresit gjithë maqedonas se xhamitë nuk janë pronë e BFIM, janë të paargumentuara dhe me prapavijë politike, e cila kryekëput është në shërbim të politikës ditore.

Me këtë që thamë në fillim, se ju, jo vetëm që nuk i respektoni të drejtat fetare por ato në bazë të deklaratave të kryetarit të këtij Kongresi në medime dhe shtyp del në mënyrë të paargumentuar kundër pasurive të patundshme të BFIM, e cila historikisht është shumë më e vjetër se shteti maqedonas.

Ky Kongres dhe kryetari i saj, para opinionit deklarojnë se xhamitë dhe pasuritë e vakëfeve nga periudha Osmane nuk janë pasuri e BFIM, e si e tillë, ajo as që ka të drejtë trashëgimie mbi këto pasuri fetare. Po ashtu, ky Kongres kur e arsyeton historikun e xhamive nga periudha Osmane deklarën se ato janë monumente të kulturës "maqedonase" dhe se këto monumente i kanë ndërtuar maqedonasit ortodoksë, si haraç, gjatë kohës së robërisë, por jo turqit ose shqiptarët myslimanë.

Si duket ky Kongres nuk e ka të qartë se në këto troje kurë nuk ka pasur as maqedonas, as shtet të Maqedonisë, por kjo ka qenë

(Reagim ndaj deklaratave të z. Todor Petrov lidhur me pronat e BFIM)

krahinë e banuar me shumicë nga shqiptarë, pastaj grekë dhe vllahë. Ky Kongres deklarën se shteti mund t'i jep të drejtë që të shfrytëzojë disa xhami për lutje fetare nga periudha osmane, ose nga ndonjë besim tjetër nga Islami në Maqedoni. Udhëheqësit e këtij kongresi harrojnë se Islami në këto troje etnike shqiptare është shumë më i vjetër se sa shteti maqedonas i themeluar me marrëveshje politike nga Kominterni. Prandaj jemi të bindur thëllë se ky kongres nuk ka të drejtë morale, juridike dhe historike të përzihet në punët e brendshme të Bashkësisë Islame në Maqedoni.

Ky Kongres i ashtuquajtur "Kongres i të gjithë maqedonasve" është në lajthitje kur deklarën se "Bashkësia Islame në Maqedoni nuk guxon të harrojë se xhamitë e kohës së Perandorisë Osmane janë të ndërtuara mbi themelet e kishave sllave-ortodokse maqedonase dhe askush nuk ka kërkuar ripërtëritjen e tyre. Ky konstatim është fare i pa bazë, pasi pushteti maqedonas me të madhe ka prishur xhami dhe kisha shqiptare, nga ardhja e pushtetit okupues serb në këto troje etnike shqiptare, nga 26 tetori

1912, kur serbet për herë të parë e pushtojnë kryeqytetin e shqiptarëve - Shkupin. Po ashtu, e përkujtojmë këtë Kongres sllavomaqedonas se para ardhjes së tyre në drejtim të Selanikut dhe shumë vonë drejtë Shkupit, pas shekullit VII, në këto troje ka dominuar kisha ortodokse Bizantine, me qendër në Stamboll.

Ju i përvetësuar këto kisha ortodokse Bizantine, bashkë me ato edhe kishat e shqiptarëve ortodoksë, që sot i shfrytëzoni me të madhe dhe para opinionit ndërkombëtar shtireni kinse ju i keni ndërtuar. Po ashtu në këtë deklaratë të këtij far Kongresi vërehet një sugjerim jo i sinqertë ndaj të gjithë myslimanëve që jetojnë në trojet e veta etnike: si shqiptarëve, turqve dhe myslimanëve të tjerë që ju me të padrejtë i quani "makedonski muslimani".

Pasi ju "e përkujtoni qeverinë dhe ministrinë që t'i ndërpresë vendimet për denacionalizimin e xhamive dhe pasuritë e vakëfeve të ndërtuara para vitit 1944", me arsyetimin se ato nuk janë trashëgimi e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, mund ta theksojmë se ky është

konstatim shumë i saktë, pasi deri në këtë vit kurrë nuk ka pasur shtet të Maqedonasve. Ky shtet artificial u krijua nga komunistët e Titos, më 2 gusht të vitit 1944. Ky Kongres në elaboratin e vet i mbështetur në paragjykime "pse nuk duhet të rindërtohen këto xhami", në veçanti kur bëhet fjalë për "Burmali Xhaminë" në sheshin "Maqedonia", në Shkup, ose ndonjë tjetër nga periudha osmane në Maqedoni. Pra, këto paragjykime flasin qartë se ku po shkon pseudoshkenca sllave, sa është e helmuar me nacionalshovinizëm, pasi ajo sot e kësaj dite tenton të falsifikojë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve dhe të myslimanëve në përgjithësi.

Pasi në këtë shtet të themeluar pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Maqedonisë janë shumë më të vjetër se sllavët dhe popullatë autoktone, pasi shqiptarët e kanë ndërtuar Shkupin me duart e tyre dhe e kanë mbrojtur si kryeqytet gjatë gjithë historisë së vet kombëtare.

Sot emigrantët, si Todor Petrovi dhe bashkëvendimtarët e tij tentojnë të mohojnë etninë e shqiptarëve dhe të myslimanëve në trojet e tyre etnike në Maqedoni.

Ibrahim Shabani,
Mufti i Muftinisë së BFI - Shkup



REIS UL ULEMA H. SULEJMAN EF. REXHEPI KUJTON MOMENTET E RRUGË-
TIMIT PËR NJOHJEN E PAVARËSISË NGA VENDET ARABE

Arabia Saudite njohu Shtetin e Kosovës

Nga Agron VOJNIKA

Në kohën më të rëndësishme, kur Kosova dhe Serbia kanë hyrë në një betejë ligjore ndërkom-bëtare në Tribunalin e Hagës, për atë se a ka apo jo të drejtë të mëvetësohet shteti i Kosovës, vjen një lajm i shumë pritur nga gadishulli Arab.

Një nga vendet me ndikim të madh në botën arabe, pra Arabia Saudite, e ka njohur pavarësinë e Kosovës. "Në vijën e lidhjeve ekzistuese fetare dhe kulturore me popullin e Kosovës dhe duke respektuar vullnetin e popullit të Kosovës për ta fituar pavarësinë, mbretëria e Arabisë Saudite shpall njohjen e Republikës së Kosovës", thuhet në komunikatën e ministrisë së Jashtme. Ministria tha se shpreson që ky zhvillim "do të kontribuojë pozitivisht në zgjerimin e shtyllave të sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe vendet fqinje të saj".

Emiratet e Bashkuara Arabe, ishin vendi i parë që e njohu pavarësinë e Kosovës, ndërsa Arabia Saudite është vendi i dytë i Gjirit që njeh shtetin më të ri të Evropës. Me vendimin e saj, Arabia Saudite u bë vendi i 58-të që ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe në periudhën në vijim, shumë shpejt mund të pritet që këtë rrugë ta ndjekin edhe shtet si: Bahreini, Katari, Jordania dhe Kuvajti.

PRESIDENTI SEJDIU FALËNDERON ARABINË SAUDITE

Presidenti Fatmir Sejdiu përshëndeti Arabinë Saudite për vendimin e saj për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ai vlerësoi se kjo është një nxitje e veçantë për Gjirin e Arabisë Saudite dhe vendet e Konferencës Islamike.

Sejdiu ka shprehur bindjen se tani do të shtohet numri i njohjeve për Kosovën.

Njohjen nga Arabia Saudite presidenti Fatmir Sejdiu e ka cilësuar edhe si një shans të mirë për ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve të Kosovës me atë pjesë të botës.

Arabia Saudite është shtet me ndikim më të madh në botën arabe dhe kjo i ka hapur rrugë edhe vendeve tjera arabe ta njohin

“

Ishte një moment shumë emocionues rasti kur Madhëria e tij Mbreti Abdullah mbante në dorë "një copë" nga toka e Kosovës dhe kur bëri premtimin e Tij para nesh. Atëherë, në atë moment pata nderin ta dëgjoj nga goja e tij Mbretin, i cili tha: "Me dëshirën e Allahut të Plotfuqishëm, këtë dhuratë e pranova dhe do të bëj çmos që ta respektoj vullnetin e popullit shqiptar nga Kosova dhe kjo do të ndodhë shumë shpejtë"



Kosovën.

Ndërkaq, Ministria e Jashtme e Kosovës ka marrë konfirmimin zyrtar për njohjen nga Arabia Saudite. Ministri Skënder Hyseni tha se njoftimi ka arritur dhe ditët e ardhshme dy ministritë e dy vendeve do të këmbëjnë notat për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Kjo njohje, tha shefi i diplomacisë kosovare, është shumë e rëndësishme për Kosovën, ndërsa së shpejti priten njohje të reja.

REIS UL ULEMA H. SULEJMAN EF. REXHEPI KUJTON MOMENTET E KËTIJ RRUGËTIMI

Pas këtij pranimi, reagimet në politikën dhe në ambientet shqiptare ishin shumë pozitive, si nga popullata, politikanët ashtu edhe nga krerët e Bashkësisë Fetare Islame, të Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Në lidhje me rrugëtimin e këtij pranimi, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi në një prononcim ekskluziv për revistën "Hëna e Re" kujton momentin kyç kur filloi procesi i njohjes dhe takimin me Mbretin e Mbretërisë së Arabisë Saudite - Madhërinë e Tij Mbretin Abdullah Ibn Abdulaziz.

"Me rastin e Konferencës Islame që u mbajt në Meka, tema boshte e së cilës ishte Sefaja dhe principet e saja, Kosovën e përfaqësonte Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame Dr. Rexhep Boja, i cili në atë Konferencë kishte sjellë edhe një dhuratë simbolike nga dheu i Kosovës, në emër të popullit të Kosovës dhe Presidentit të saj Dr. Fatmir Sejdiu", thotë H. Sulejmën ef. Rexhepi.

"Pas mbarimit të Konferencës, bashkë me Dr. Bojen, me një aeroplan special enkas për ne, udhëtuan nga Meka në Riad, për tu takuar me Madhërinë e Tij.

Në atë takim duke qenë sëbashku me Dr. Rexhep Bojen, pata nderin që të dëgjoj dhe ta përjetoj atë moment duke ja dorëzuar dhuratën Madhërisë së Tij - Mbretit Abdullah ne emër të Presidentit të Kosovës dr. Fatmir Sejdiut. Dhurata ishte shumë simbolike, një gur i çmueshëm në formë suvenir i nxjerrë nga toka e Kosovës - miniera e Treçës.

Dr. Rexhep Boja i cili ishte autorizuar enkas nga Presidenti Sejdiu, me atë rast i tha Mbretit që ky simbol i tokës kosovare tu përkujtojë kërkesat dhe dëshirat e popullit shqiptar nga Kosova të cilët nga ekselencia Juaj kërkojnë që sa më shpejtë të pranoni pavarësinë e Kosovës, ndërsa ky akt do të ishte respekt i madh ndaj popullit shqiptar dhe ndaj islamit në Evropë, e konkretisht në Ballkan, pra në zemrën e Ballkanit ashtu siç është sot Kosova e Pavarur".

Në vazhdim të kësaj teme, Reis Ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi me plot emocion përshkruan momentin kur në duart e Madhërisë së Tij Mbretit Abdullah u gjend guri i çmueshëm i Kosovës, i cili kishte rëndësinë e një vendimi të madh për ardhmërinë e shtetit më të ri në Evropë.

"Ishte një moment shumë emocionues rasti kur Madhëria e Tij Mbreti Abdullah mbante në dorë një copë nga toka e Kosovës dhe kur bëri premtimin e Tij para nesh. Atëherë, në atë moment pata nderin ta dëgjoj nga goja e Tij Mbretin, i cili tha: 'Me dëshirën e Allahut të Plotfuqishëm, këtë dhuratë e pranova dhe do të bëj çmos që ta respektoj vullnetin e popullit shqiptar nga Kosova dhe kjo do të ndodhë shumë shpejt, kur ne (Arabia Saudite) do ta pranojmë pavarësinë e Kosovës, sepse ai është vullnet i popullit kosovar, a njëherit është solidarizim i fuqishëm shpirtëror i një vendi, ku mbi 90 përqind e popullatës i përkasin besimit islam".

Gjithashtu, në lidhje me këtë rrugëtim të suksesshëm për pranimin e pavarësisë së Kosovës nga Arabia Saudite, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi shpreh kënaqësinë e tij dhe besimin se tanimë mund të pasojnë njohje të tjera nga vende të Lindjes së Mesme.

"Akti i Arabisë Saudite do të jetë me ndikim të madh që një numër i madh i shteteve arabe, e sidomos të Gjirit Arab, ta pranojnë Kosovën si shtet i pavarur, a njëherit do të jetë një provokim dhe stimul i fuqishëm për të gjitha shtetet anëtare të Konferencës Islamike, që ta ndjekin këtë veprim.

Perspektivën e Kosovës drejt suksesit, nuk ka më forcë në Botë që ta pengon dhe në këtë moment, lutem që Allahu i Plotfuqishëm ta bekojë Kosovën dhe popullin e saj", thotë H. Sulejman ef. Rexhepi në prononcimin e tij.

PREPOTENCA PA POTENCË E REAGIMIT SERB

Shefi i diplomacisë serbe, duke dashur të shpreh zhgënjimin e madh për vendimin e Arabisë Saudite për njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës, i shpëtoi një lapsus për pritshmërinë ndaj njohjeve në të ardhmen.

"Kur flasim për vendimin e Arabisë Saudite, ky është një vendim tepër zhgënjyes i cili dëshmon përbuzje edhe ndaj Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila ia nisi zyrtarisht punës mbi çështjen e ligjshmërisë të aktit të ndarjes nga shqiptarët e Kosovës. Kjo çështje tani është në Gjykatë dhe unë nuk e di sa kohë do të marrë por unë shpresoj se jo shumë vende, më falni, që me shpresë asnjë vend pas Arabisë Saudite të mos tregojnë përbuzje ndaj drejtë-

sisë ligjore ndërkombëtare", shtoi Jeremiç.

Sipas Vuk Jeremiçit, megjithëse vendimi i Arabisë Saudite vjen në një moment jo të favorshëm, kjo nuk do ta ndryshojë betejën, siç u shpreh ai, paqësore të Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Por rasti më i çuditshëm ishte kur Ministri i punëve të jashtme të Serbisë, Vuk Jeremiç deklaroi në Bruksel se vendi i tij nuk do t'a njohë kurrë Kosovën, në asnjë rrethanë, edhe nëse Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësisë vendos në favor të pavarësisë së Kosovës.

Sipas kësaj i bie që Serbia kërkon drejtësinë Ndërkombëtare, por nuk do të pajtohet nëse nuk ka zgjidhje në interes të saj.

KOSOVA - KUSHTI EVROPIAN PËR SERBINË

Sidoqoftë, Parlamenti Evropian së shpejti do të miratojë një rezolutë pozitive për Ballkanin Perëndimor, në të cilën do të kërkojë nga shtetet anëtare të BE-së që të mos frenojnë vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të integriteteve evropiane.

Në rezolutë nga vendet e këtij rajoni njëkohësisht do të kërkohej që t'i zgjidhin kontestet bilaterale, para se të nisin negociatat për anëtarësim në BE. Një qëndrim i tillë mund të ketë edhe rrjedhoja direkte në rrugën evropiane të Serbisë, meqenëse kjo do të thotë që çështja e Kosovës duhet të zgjidhet shumë më shpejt se sa mendohej deri më tash.

Në draftin e versionit të konsoliduar të rezolutës së Parlamentit Evropian për Ballkanin Perëndimor e cila do të miratohet të enjten thuhet se "Ballkani Perëndimor në mënyrë të pamohueshme është pjesë e Evropës dhe se e ardhmja e të gjitha vendeve në rajon është integriteti në BE".

Në tekstin e rezolutës së Parlamentit Evropian paralajmërohen shtetet e Ballkanit Perëndimor se nuk do të mund të fusin në BE problemet e tyre bilaterale dhe të shfrytëzojnë BE-në për zgjidhjen e tyre.

Kjo praktikisht do thotë, se edhe Serbia nuk do të mund të hyjë në BE dhe që pastaj të bllokohet hyrjen e fqinjëve të saj, në mesin e të cilave (është qëndrim i shumicës së europarlamentarëve) hyn edhe Kosova".

Gjithashtu thuhet se një rrethanë shtesë e pavolitshme për Beogradin zyrtar është ajo se në rezolutën e Parlamentit Evropian kërkohej që problemet të zgjidhen para se vendet të nisin negociatat për anëtarësim. Kjo do të thotë se njëfarë "modus vivendi" me Kosovën duhet të gjendet para fillimit të negociatave para vitit 2012.

AMBASADORË TË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT VIZITOJNË BFI

Ta njohin mëvetësin e Kosovës e gjithë bota arabe

Më 03.04.2009, në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi ishte nikoqir i ambasadores nga Ministria e Punëve të Jashtme, znj. Safije Ibrahim Amin dhe ambasadores së Egjiptit në Bullgari znj. Hiba el-Mirasi.

Në këtë takim Reis ul Ulema njohi për veprimtarinë institucionale që është duke e realizuar BFI në shumë sfera dhe dimensionet, nevojën e zhvillimit të jetës fetare në RM dhe me problemet me të cilat ballafaqohet institucioni në realizimin e qëllimeve.

Në këtë takim me theks të veçantë u bisedua rreth tri problematikave apo më mirë thënë mbi tri çështje: Eksprencën e fituar nga Kongreset mbarëbotërore Islame të organizuar nga shteti Egjiptian në kryeqendrën e saj në Kairo. Bashkëpunimin që e kemi në mes të BFI dhe Universitetit më të vjetër në botë Al-Azher në Egjipt. Njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet arabo-islame.

Kongresi i fundit i realizuar nën patronatin e kryetarit të Egjiptit, ekselencës së tij z. Muhammed Husni Mubarek me temë kryesore: "Ripërtëritja e mendimit Islam" ishte edhe një dëshmi për kapacitetin dhe nivelin e lartë organizativ të organizatorit të këtij kongresi. Reis ul Ulema lidhur me këtë Kongres shprehi eksprencën që kishte fituar nga këto kongrese dhe reflektimin pozitiv që patën tek mendimtarët dhe ulematë në gjithë botën islame.

Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga bota arabe theksoi se njohja sa më e shpejtë nga ana e Republikës Arabe të Egjiptit do të ishte një hap që do të ndikonte që ky shtet i ri të njihet edhe nga shumë shtete të tjera arabo-islame, kjo duke theksuar pozitën që ky shtet e mban në mesin e tyre.

Musafiret shprehën kënaqësi për mikëpritjen nga kreu i BFI dhe vlerësuan lartë veprimtarinë e realizuar deri më tani të këtij institucioni fetar dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtejshëm në sfera të interesit të përbashkët dhe në dobi të besimtarëve tanë në vend dhe më gjërë.

DIALOGU OBJEKTIV ME PAPËN E VATIKANIT

Prof. Dr. Mahmur Hamdi Zakzuk

Pardon! Prifti Suprem

Më dymbëdhjetë shtator 2006 Kazakstani, shtet ky musliman, ishte nikoqir i konferencës së dytë ndërkombëtare të liderëve të feve botërore dhe tradicionale për thellimin e dialogut, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes gjithë feve, çështje kjo e cila dëshmon nivelin e tolerancës islame dhe komunikimin me gjitha fetë.

Është nga paradokset e çuditshme se pikërisht atë ditë Papa i Vatikanit Benedikt XVI ligjëroi në Universitetin e Regensburgut ku atakoi Islamit, atakim i cili gjithandej në opinionin e përgjithshëm Islam u prit në mënyrë shokuese.

Nëse njeriu mendon lidhur me këtë ligjëratë, do të parashtronte pyetjen: Përse Papa në ligjëratën e tij lidhur me relacionin mes besimit dhe logjikës në krishterizëm, atakon islamit?

Padyshim se kjo metodë e atakut një feje nga më të mëdhatë që e njuh njerëzimi - e përquafuar nga një e pesta e banorëve të botës - nuk mund t'i shërben qëllimeve të dialogut në të cilin edhe vet Papa thirri në fund të ligjëratës së tij.

Mos ndoshta Papa ka dashur ta shfrytëzonte këtë rast për të atakuar Islamit një ditë pas përkujtimit të ngjarjeve të 11 shtatorit për ta lidhur atë me terrorizmin, si përkrahje ndaj opinionit mbretëruar në mediumet perëndimore rreth lidhshmërisë së Islamit me terrorizmin si dhe duke u ndërlidhur me seritë e pikturave të karikaturave në Danimarkë? Apo deshi të argumentonte epërsi të Krishterimit ndaj Islamit?

Një çështje e cila vlen të theksohet është se Papa në atakimin e tij kundër Islamit është mbështetur në një libër të prof. Adil Teodor Huri. Papa gjatë ligjëratës së tij disa herë citoi fjalët e prof. Hurit i cili është me origjinë libaneze e që ka punuar si profesor i teologjisë në Universitetin e Munsterit në Gjermani. Prof. Hurin e njoh mirë, diku afër njëzet vite dhe me të shumë herë kemi qenë pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare për dialog ndërfejar. Ai ka libra të shumta të shkruara mbi Islamit në gjuhën gjermane, mirëpo mendimet e tija dhe perspektivat e tija mbi Islamit shpeshherë nuk pajtohen me ato të muslimanëve.

Mbështetja e Papës në librin e

Hurit na kujton në filozofin francez Paskal i cili për Islamit kishte lexuar vetëm një libër të një orientalisti mbi të cilin mbështeti atakimin e tij të paarsyeshëm kundër Islamit.

Çdo konsideratë dhe respekt ndaj Papës Benedikt XVI, por në vazhdim do të doja të sjellë disa vërejtje lidhur me ligjëratën e tij:

1. Papa Benedikt XVI nga Huri citoi dialogun që kishte ndodhur në dimër të vitit 1391 mes perandorit bizantin Manuel II dhe një muslimani të urtë.

Në njërin nga këto dialogje, Manuel II diskuton lidhur me xhihadin ose "luftën e shenjtë". Pasiqë ai e përmendi në fjalimin e tij, ai ka qenë i vetëdijshëm për ajetin e sures - kaptinës El Bekare që thotë:

"Nuk ka shtrëngim në fe." (el Bekare:256)

Në lidhje me këtë ajet thonë se është i një sure të periudhës së hershme, kur Muhamedi ishte i pafuqishëm, i kërcënuar. Gjithsesi se perandori ka pasur njohuri edhe me suret e mëvonshme që sjellin dispozita lidhur me xhihadin. Perandori bashkëbiseduesin e tij e pyet për lidhshmërinë mes fesë dhe dhunës: "Më trego çkemi të re nga ajo që ka ardhur Muhamedi? Nuk do të gjesh pos nga punët e këqija dhe jonjerëzore, sikurse angazhimi i tij për përhapjen e fesë të cilën e predikonte përmes tehut të shpatës... Kjo punë është në kundërshtim me natyrën e Zotit dhe me natyrën e shpirtit."

Çështja esenciale këtu ka të bëjë me imponimin e fesë përmes dhunës dhe se mosveprimi sipas arsyes kundërshton natyrën hyjnore.

Huri vazhdon duke thënë: "Sipas besimit Islam Allahu është absolut. Vullneti i tij nuk është i lidhur me asnjërin nga kategoritë madje as me atë të mendjes." Këtu Huri citon veprën e një orientalisti tjetër R. Arnaldez i cili nënvizon se Ibën Hazmi ka pohuar se Allahu nuk është i lidhur as me fjalën e Tij, Ai nuk është i detyruar të na e shpallë të vërtetën dhe se sikur të donte, njeriu do ta bënte adhurues të idhujve. Është krejtësisht e qartë se Papa pajtohet me gjithë këtë, madje e ka pranuar sikur kjo të ishte e padiskutueshme.

Nga ana tjetër, Ibën Hazmi i cili është një nga drejtuesit e medhebit - drejtimit dhahiri që

mohon arsyen dhe logjikën - nuk është autoritet mbi të cilin mbështeten muslimanët. Mendimet e tija janë refuzuar nga akaidologët islam të drejtimeve të ndryshme. Besimi i muslimanëve nuk merret pos nga Kur'ani Fisnik dhe Sunneti pejgamberik autentik, çdo gjë jashtë kësaj konsiderohet për vështrime dhe ixhtihade të cilat mund të jenë të gabueshme ose të sakta. Allahu e mëshiroftë Imam Shafiun i cili ka thënë: "Opinionin ynë është i saktë por ka mundësi të jetë i gabueshëm, opinionin e tjerëve është i gabueshëm por ka mundësi të jetë i saktë."

2. Perandori bizantin në fjalimin e tij mbi islamit nuk paraqet burim shkencor mbi të cilin mund të bazohet. Fjalimi i tij konsiderohet i llojit të kampanjës kundër fesë së armikut para se ai të paraqes ndonjë fjalim fetar ose shkencor. Pastaj, fjalimi i tij nuk del jashtë paragjyqimeve të shtrembëruara mbi Islamit në Evropën mesjetare. Në fakt ajo ishte edhe burim i njohurive të tija mbi Islamit. Nga këtu, nga aspekti objektiv nuk mund që të mbështetemi në fjalën e këtij perandori dhe të argumentohet diçka me opinionin e tij. Sëkëndejmi, u çudita, edhe bota islame gjithashtu, nga citimi i Papës - e ai është profesor universitar - në sjelljen e citateve të atilla dhe mbështetjen në të njëjtat.

3. Dialogun të cilin e shfaqti perandori me të menduarit e tij të çuditshëm mbi Islamit, pala tjetër ishte një intelektual musliman. E lfar tha ky musliman lidhur me fjalët e perandorit?

A nuk do të ishte e drejtë dhe shkencërisht e pastër që të prezantohet në mënyrë të plotë, që çështjet të qartësohen para njerëzve? Nëse bëhet një prezantim i tërësishëm, kjo do të bënte të përmirësohen çështjet, të sqarohen qëndrimet dhe e vërteta të dalë në shesh.

4. Pohimi se vullneti hyjnor në islam është i ndarë nga arsyeja dhe se veprat e Allahut nuk i nënshtrohen arsyes dhe logjikës, është një çështje që nuk ka mbështetje në realitetin kur'anor e as në atë të besimit Islam. Allahu na ka urdhëruar në vlera të cilat pajtohen me arsyen dhe logjikën. Islami respekton arsyen njerëzore dhe e ka vendosur atë në piedestalin më



"Çështje e cila nuk guxon të mungojë nga mendjet është se nuk mund të ketë paqe në botë, pa pasur paqe mes feve dhe nuk mund të ketë paqe mes feve, pa pasur dialog të vërtetë mes feve. Kështu parandalohet mospërfillja dhe nënçmimi i çështjeve të shenjta të një feje".

të lartë, kurse njeriun i cili nuk e shfrytëzon arsyen e vet e konsideron për të atillë që ka hequr dorë nga njerëzia e tij. Mosshfrytëzimin e arsyes, Islami e konsideron si një mëkat të madh për të cilin merret në përgjegjësi ditën e kijametit.

Allahu xh.sh. në Kur'anin Fisnik na ka sqaruar se ai ka krijuar çdo gjë sipas masës dhe se çdo gjë në qiej dhe në tokë qëndron në pajtueshmëri me ligjin e universit. Kur'ani Fisnik thërret njeriun në vështrim në univers dhe studimin e tij, në të medituarit në argumentet e Allahut në botë dhe në njerëzit. Fakti që vullneti i Allahut, dija e Tij dhe urtësia e Tij se nuk mund të kufizohen, është një çështje e logjikshme, ngase Ai vet është krijuesi. Mirëpo muslimani nga kjo nuk kupton se veprimi i Allahut nuk pajtohet me arsyen dhe logjikën.

Në dritën e këtyre mësimëve kuranore ishin dijetarët musliman, huxhetul islam Gazaliu thotë: "Arsyeja është shembull i nurit të Allahut." Kurse Xhahidhi thotë: "Arsyeja është përfaqësues i Allahut te njeriu." Sikurse pajtohen studiuesit musliman se vështrimi i arsyes konsiderohet si obligim i parë në çështjet e besimit.

Muslimanët kishin njohuri edhe mbi filozofinë e vjetra, sikurse ajo greke dhe atë e kanë diskutuar me arsye duke e mbrojtur atë nga zhdukja. Evropa e njohu filozofinë

greke për herë të parë përmes përkthimeve arabe nga dijetarët musliman.

Evropa është mbështetur në opinionet e filozofit të madh Ibën Ruzhd në formë të veçantë në përkrahje të racionalizmit që përgatiti rrugën e renesancës evropiane.

Edhe me këtë konsideratë mbi arsyen dhe logjikën muslimanët nuk harruan se Allahu është Krijuesi i Madhërishtëm, Sundues i Jdo sendi dhe se Ai është që dhuroi mendjen, por me të Ai nuk e privoi njeriun nga dëshira, vetëm se e ngarkoi me përgjegjësi duke e bërë njeriun zëvendësues të tij në tokë, për ta ndërtuar atë me dituri, e nuk ka dituri pa pasur mend.

5. Kur'ani Fisnik kategorikisht refuzon armiqësinë ndaj të tjerëve derisa ata nuk dëmtojnë muslimanët. Ai kërkon nga muslimanët të koeporojnë me ta në bazë të bashkëjetesës pozitive me mirësi dhe drejtësi. Ajetet e Kur'anit Fisnik në këtë drejtim për çdo hulumtues objektiv janë të qarta.

Kur'ani Fisnik vërtetohet me një mënyrë fikse qëllimin e daves-thirrjes islame me fjalët ligjëruar Pejgamberit a.s.:

"E Ne të dërguam ty vetëm mëshirë për botërat." (el Enbija: 107)

Mëshira është adresa e Islamit, kurse Islam është e rrënjës së njëjtë të fjalës selam - paqë, pra Islami është fe e paqes.

Islami nuk njeh të ashtuquajturën "luftë e shenjtë", xhihadi në Islam është i ligjshëm vetëm për t'u përgjigjur armiqësisë, siç thotë Kur'ani:

"Luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju luftojnë, por mos kaloni kufirin." (el Bekare:190)

Xhihadi më i madh është xhihadi i nefsit - përpjekja për ta mbrojtur veten, ashtu siç është edhe xhihadi me nefsën në raste armiqësie kundër muslimanëve. Xhihadi gjithashtu është edhe përmes detyrës, pasurisë dhe përmes çdo veprë që dëbon zullumin, që vendos baraspeshën e drejtësisë, që nxit në vlera dhe që ndalon apo largon nga të ligat. Andaj, interpretimi i xhihadit në luftë kundër të tjerëve për ta përhapur fenë përmes shpatës, është një interpretim i gabuar i këtij koncepti.

Përhapja e Islamit nuk bëhet pos përmes bindjes, argumentimit dhe dëshmisë. Islami nuk është përhapur përmes shpatës -siç thuhet- por përmes vet fuqisë së tij. Shembulli më i mirë në këtë është përhapja e Islamit në lindje të Azisë dhe Kinë përmes tregtarëve musliman të cilët nuk ishin të armatosur për t'i shtërnguar njerëzit në përqafim të Islamit. E njëjta ishte edhe në shtetet perëndimore të Afrikës ku Islami u përhap përmes sufive, pa detyrim



dhe dhunë. Vlen të përmendet se muslimanët kur e çliruan Egjiptin askënd nga populli i saj nuk detyruan për të kaluar në Islam. Kështu, muslimanët në Egjipt për dy shekuj kohorë ishin pakicë. Andaj, çdo tejkallim dhe devijim nga kjo vijë e qartë e Islamit, në asnjë mënyrë nuk lejohet t'i vishet atij.

Disa shkrimtarë perëndimor mohojnë Islami të jetë përhapur përmes shpatës, ndër ta është edhe orientalisti i njohur Tomas Arnold në librin e tij "The call to Islam" (Thirrja në Islam).

Vet Kur'ani Fisnik e cakton metodën e thirrjes në islam me fjalët:

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe diskuto me ata me atë që është më e mira..." (en Nahël:125)

Nga letrat e të Dërguarit Muhamedit a.s. popullit të Jemenit është: "Kush është në fenë hebraike ose krishtere të mos shtrëngohet të heq dorë nga ajo."

Islami është feja e vetme që vendosi lirinë e besimit kur thotë:

"Nuk ka shtrëngim në Fe." (el Bekare:256)

Sureja el Bekare në të cilën gjendet ky ajet nuk është nga suret e hershme - siç është thënë - por ajo është nga suret medinase të mëvonshme. Islami bëri që çështja e besimit të jetë në vullnetin e lirë të

njeriut, kjo bazuar në fjalët e të Lartëmadhërishtit:

"Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë." (el Kehf:29)

6. Nëse ligjërata ka dashur Islamit ti bën akuzën e dhunës, është e drejtë të pyesim:

Vallë luftërat e kryqëzatave nuk ishin dhunë, terror, armiqësi e hapur kundër popujve në siguri në regjionin arab të asaj kohe?

A nuk ishte Vatikanit që ndihmonte, nxite dhe mbështeste këtë luftë, sakrificë të së cilës ishin mijëra musliman?

A nuk ishte kjo luftë në kundërshtim me arsyen dhe natyrën Hyjnore?

Përkundër gjithë kësaj, muslimanët ngurruan që luftërat e kryqëzatave ti emërtojnë si të tilla, kështu historianët e emërtuan me "Luftëra perëndimore", pra me këtë duke mohuar lidhshmërinë mes saj dhe krishterimit për të cilën muslimanët besojnë se ajo është një fe e paqes dhe dashurisë.

7. Kurse sa i përket lidhjes së Allahut me njeriun, në Islam ajo është më e thellë se sa mund ta paramendojë njeriu. Mjafton që këtu të sinjalizojmë përmes ajeteve nga Kur'ani Fisnik. Allahu xh.sh. thotë:

"Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem." (Gafir:60)

"E kur robët e Mi të pyesin ty

për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet." (el Bekare:186)

"Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij." (Kaf:16)

"Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtet, Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!" (Zumer:53)

Këto ajete dhe ajete të tjera në Kuranin Fisnik janë vetvetiu të qarta dhe nuk kanë nevojë për koment.

8. U pata gëzuar takimit me Papën Xhon Palin II në vitin 1987 me rastin e tubimit të parë fetar në organizim të institucionit St. Egidio. I ndjeri Papa fqimisht ishte mbështetës i dialogut mes feve, atë e pat pritur Ez-heri diku rreth pesë viteve me çdo mirëseardhje dhe konsideratë. Në kohën e tij u realizua dhe nënshkrimi i marrëveshjes për dialog fetar mes Ez-herit dhe Vatikanit.

Neve përgëzuar me pasardhësin e tij Papën aktual Benedikt XVI duke shpresuar që të vazhdon sipas metodës së paraardhësit të tij, për më shumë kooperim dhe mbështetje dialogut, mirëkuptimit reciprok për realizimin e shpresës njerëzore në paqe dhe stabilitet.

Mirëpo, bota islame në tërësi është goditur me një shok të lartë nga deklaratat e Priftit Suprem, Papa i ri i Vatikanit. Vallë hirësia e tij sheh se ajo që doli nga ai në dëm të Islamit mund të mbështes raportet e mira mes muslimanëve dhe botës katolike? Fjalët e Papës mbi Islamin shkaktuan plagë të rëndë në zemrat e muslimanëve të cilat nuk mund të harrojnë pos pas një kohe të gjatë dhe pas një faljeje të qartë muslimanëve të cilët përbëjnë një të pestën e numrit të përgjithshëm të banorëve të botës. Krahas kësaj fjale e Papës shpjegon atë që ka gjetur vend në konceptin perëndimor mbi islamin me plot keqkuptime dhe paragjykime dhe koncepte të ngatërruara, jo vetëm në shtresa të përgjithshme por edhe në mesin e intelektualëve. Kjo d.m.th. domosdoshmëri e dialogut për përmirësimin e opinionëve të gabuara dhe çrënjësosjen e paragjykimeve.

Bota sot vërtetë po jeton në një fshat të vogël global, e nëse dëshirojmë të jetojmë bashkërisht në paqe, doemos të ketë mirëkuptim reciprok dhe afërsi mes feve, kjo për shkak paqes së kësaj bote e cila është botë e të gjithëve. Çështje e cila nuk guxon të mungojë nga mendjet është se nuk mund të ketë paqe në botë, pa pasur paqe mes feve dhe nuk mund të ketë paqe mes feve, pa pasur dialog të vërtetë mes feve. Kështu parandalohet mospërfillja dhe nënçmimi i çështjeve të shenjta të një feje.

Përktheu: Afrim Tahiri

Besimi ndjenjë e paralindur

Ajni Sinani

Shpirtrat e njerëzve kanë ardhur në ekzistencë para zbritjes së tyre në këtë botë. Në mbretërinë qiellore ata janë paraqitur në formën që ka dëshiruar All-llahu dhe Ai ka kërkuar prej tyre që të dëshmojnë për hyjninë e Tij. Sipas Kur'anit, All-llahu pasi e krijoi Ademin, mori premtimin e tij. Më pas, Ai nxori nga kryqet e tij pasardhësit që do të lindnin deri në fund të botës, gjeneratë pas gjeneratë dhe i vendosi para Tij për t'ua marrë edhe atyre premtimin, duke u thënë: "A nuk jam Unë Zoti juaj?" dhe shpirtrat u përgjigjën: "Po, dëshmojmë se Ti je".

All-llahu e bëri këtë me qëllim që njerëzit të mos kishin kurrfarë justifikimi në Ditën e Ringjalljes: "Të mos thoni në Ditën e Kiametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur", apo të mos arsyetoheshin duke thënë: "Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës?" (El A'raf: 172-173).

Këtë dëshmi njerëzimi e ka bërë para ekzistencës tokësore, në botën e urdhrave dhe të fjalëve, ku shpirtrat tanë janë takuar dhe janë njohur mes tyre. Disa janë afruar e disa janë larguar: "Shpirtrat janë si ushtarët që rrinë grupe-grupe. Ata që njihen në mes vete shoqërohen, ata që s'njihen ndahen." (Hadith, transmeton Buhari). Që atëherë, secili njeri është i obliguar për besëlidhjen që ka lidhur me All-llahun. Allahu i Plotfuqishëm u ndau shpirtrave të njerëzve misionin e bartjes së amanetit (Ina aradna el emanete) dhe ata fituan të drejtën e realizimit të tij me zbritjen nga bota e "urdhrave" në botën tokësore fenomenale.

Pranimi që njerëzimi bëri para All-llahut (KALU BELA), duke e pranuar për Zot të vetin, është vulosur në shpirtin e çdo njeriu dhe si i tillë është i pandashëm nga natyra njerëzore. Prandaj njeriu duhet të vazhdojë ta njohë dhe ta pranojë Krijuesin e tij në gjithë jetën e tij tokësore. Kjo ndjenjë e natyrshme në gjuhën arabe quhet 'fitretullah' - krijim i All-llahut, 'Fitretul Ilahijje' - krijim hyjnor dhe 'fitretul selime' - krijim i



pastër, që nuk mund të ndryshohet: "Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fenë, larg prej çdo të kote, (e ajo fe), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Er Rum: 30).

NATYRSHMËRIA ISLAME-FITRA

Imani buron nga thellësia e zemrës së njeriut dhe është i ngulitur në shpirtin e tij. Si rrjedhim, çdo foshnje që lind e bart me vete këtë besim të natyrshëm të Zotit: "Çdo foshnje lind me natyrë të pastër (natyrshmëri islame)." (Hadith). Fitra është natyra e parakrijuar e njeriut, e orientuar ka njëshmëria e Zotit (tevhid), që ka qenë thelbi dhe esenca e gjithë shpalljeve hyjnore. Dijetarët e shkencave shoqërore dhe të shkencave të natyrës janë të mendimit se ndjenja e besimit të njeriu është diçka e natyrshme dhe e bashkëlindur (fitri). Ata vlerësojnë se fëmijët janë të prirë dhe të parapërgatitur ta besojnë botën si krijim të Zotit. Në qoftë se fëmija lihet vetëm, ai do të rritet me dijen se ka vetëm një Zot. Sapo fëmija fillon të kuptojë normalisht, duke shqyrtuar shkaku dhe përbërjen e sendeve dhe dukurive që sheh, ai do të nisë të bëjë pyetje.

Ibn Hazmi (994- 1064), në veprën e tij El-Fasl, e ka shtjelluar mjaft bukur konceptin e parimeve të para të quajtura: [Fillimet e arsyes] (evailul akl), të pranuar edhe prej shkencëtarëve të kohës sonë, ku tregohet se parimet e para fillojnë të formohen te fëmija qysh në moshën dyvjeçare. Fëmija, midis moshës tre deri pesëvjeçare, duke mos pasur asnjë nxitje, fillon të kuptojë parimin e shkakësisë, të ndajë veten prej tjerëve, madje të pyesë: "Kush më ka bërë mua, zogjtë, lodrat...?"

Dr. Justin Barrett, shkencëtar në Qendrën për Antropologji dhe Vetëdije të Universitetit të Oksfordit, deklaroi për radio programin BBC4, të emittuar më 24 nëntor 2008, se fëmijët e vegjël kanë predispozita që të besojnë në një Krijues Suprem, sepse instink-

tivisht supozojnë se gjithçka që është krijuar në tokë i shërben një qëllimi të caktuar: "Argumentet shkencore në dhjetë vitet e fundit tregojnë se fëmija vjen në këtë botë me më shumë nga ato që ne i kemi konsideruar si rastësi, përfshirë edhe predispozitën se ai e sheh natyrën në formën se pas saj qëndron një Qenie Inteligjente".

Njeriu, aftësinë dhe ndjenjën për ta njohur Krijuesin, e ka të lindur dhe e sjell me vete në këtë botë dhe, nëse nuk do ta kishte këtë shkëndijë, ai kurrë nuk do të mund të vinte tek ideja e ekzistencës së Zotit.

Këtë e ka përshkruar, para qindra vjetësh, filozofi andaluzian Ibn Tuffejli (1105- 1185) në librin e tij: "Hajj in Jakdhan" përmes një njeriu që rritet i vetmuar në një ishull, që duke medituar arriti ta kuptojë dhe ta besojë Krijuesin me mendjen e tij. Prandaj, feja dhe besimi nuk janë kategori historike që janë zhvilluar me njeriun kinse nën presionin e frikës nga dukuri të ndryshme natyrore. Përkundrazi, besimi është një dhuratë hyjnore që nga lindja, një gjendje e natyrshme në të cilën lind çdo njeri, (fitreh/sensus communis), që është e përbashkët për të gjithë.

Dr. Barrett thotë se fëmijët e vegjël besojnë në Zot, edhe nëse këtë nuk e kanë mësuar nga prindërit e tyre dhe në shkollë, dhe vazhdon duke pohuar se edhe ata që do të rriteshin në një ujdhesë të vetmuar do ta besonin Zotin: "Nëse do të izoloni disa fëmijë në një ujdhesë të vetmuar dhe nëse ata do të rriteshin larg çdo ndikimi, mendoj se do ta besonin Zotin".

Deri në fazën e pjekurisë, fëmijët nuk janë në gjendje që të mendojnë dhe të kuptojnë në masën e duhur, por influencohen nga familja, i imitojnë ata dhe nuk mund t'i rezistojnë ndikimit të prindërve të tyre. Feja që fëmija merr në këtë moshë është feja që pasojnë prindërit e tij. Prandaj All-llahu nuk i kërkon llogari asnjë fëmije që lind në një familje jomuslimane dhe nuk i dënon ata për besimet e pavërteta që pasojnë.

Por kur fëmija rritet dhe hyn në fazën e pubertetit, nëse ai është normal në aspektin mendor, nga ai

kërkohet që të pasojë besimin e vërtetë, besimin që është skalitur në shpirtin e tij dhe që pajtohet me arsyen e shëndoshë. Në këtë periudhë lind vetëdija mbi botën, mbi vetveten, mbi kohën, dhe në kokën e tij vërtiten pyetje të ndryshme që kërkojnë përgjigje.

Në konstruktin e mendjes së njeriut ekziston veçoria për ta kërkuar Krijuesin, gjë që e ka ngritur atë mbi të gjitha krijesat. Njeriu për nga natyra e tij është adhurues dhe nuk ka njeri që nuk adhuron. Dallimi ndërmjet tyre qëndron në atë se çfarë adhurojnë.

Disa besojnë drejt kurse të tjerë jepen pas besimeve të kota .

Prandaj, djajtë përipiqen që ta nxisin atë që të qëndrojnë në atë gjendje që është apo të zhytet edhe më thellë në humbjen e tij. Duke ia zburuar të pavërtetën, ata mundohen që t'ia pamundësojnë njeriut që të arrijë të kuptojë të vërtetën. Në një hadith kudsi, All-llahu i Madhërishtëm thotë: "Unë i krijova robërit e Mi në fenë e drejtë, por shejtanët i bëjnë ata që të humbasin rrugën."

Por, nëse njeriu është i vendosur dhe nuk bie pre e pasionit dhe ëndjeve të kota nën cytjen e djalit dhe e kërkon të vërtetën sinqerisht, atëherë ai do të ketë ndihmën e Krijuesit. Madje, sa më shumë që njeriu arrin ta ruajë fitren e tij të pastër dhe atë që është shkruar në pllakën e shpirtit të tij, aq më pak pengesa do të ketë për ta pranuar rrugën e drejtë islame.

“

Në mbretërinë qiellore, njerëzit në formë shpirt trash kanë dëshmuar para All-llahut njëshmërinë dhe hyjninë e Tij. Prandaj, çdo njeri vjen në këtë botë i pajisur me një ndjenjë të tillë. Ky është thelbi i dëshmisë islame "S"ka Zot tjetër përveç All-llahut", që është konfirmim i pohimit të parë në gjendjen shpirtërore. Ndjenja e pastër kongjenitale mund të harrohet duke u dhënë pas kësaj bote, por kur largohen pengesat mashtruese njeriu i kthehet natyrës së tij burimore.

Misioni i pejgambereve Meqë njohja e transcendentës hyjnore është diçka e lindur te njeriu, devijimi dhe shmangia nga kjo normë shkaktohet nga harresa. Këtë kongjenitalitet njerëzor e asfiksojnë botëkuptimet e dështuara, epshet dhe kënaqësitë e kësaj bote. Prandaj, misioni i të gjithë pejgamberëve ka qenë që t'i rikujtonin dhe t'i ftonin njerëzit që t'i ktheheshin zotimit (mithakut), nëpërmjet të cilit njeriu i është dhënë jo vetëm funksioni i të qenit shërbëtor i All-llahut, por edhe mëkëmbës i Tij mbi tokë.

Historia tregon se të gjithë njerëzit e botës, gjatë epokave të ndryshme, kanë besuar në ekzistencën e Krijuesit. Abas El Akad thotë se njeriu është koshtentë dhe i vetëdihshëm për Zotin. Ai është i bindur vetvetiu se Ai ekziston. Njeriu qëndron i magjepsur përballë madhësisë dhe harmonisë së universit. Kjo magjepsje është e shprehur në mënyrë sipërfaqësore te njeriu i zakonshëm, kurse te shkencëtari në mënyrë të thellë. Çdo mendje mrekullohet dhe kërkon autorin e universit. Në këtë kërkim, ndodh që njeriu ta gjejë Krijuesin ose të gabojë dhe të shmanget nga natyra e tij e pastër origjinale.

Ka njerëz që nuk besojnë ose që thonë se nuk besojnë. Shumica e atyre që e kanë mohuar ekzistimin e Zotit janë pushtuar nga pasionet e tyre. Një deformim i tillë ndodh ngase këta njerëz nuk kanë mundur ta ruajnë natyrshmërinë e

tyre të pastër e të vërtetë, nën influencën e ndikimeve negative të ardhura nga mashtrimet e jashtme të shoqërisë, arsimit, rrymave mohuese apo presionit të brendshëm sikurse janë dëshirat egoiste, foddullëku, mendjemadhësia, popullariteti, hipokrizia etj. Kjo rezultoi me larjen e trurit dhe sëmurjen e zemrës për shkak të mëkateve, pakujdesisë dhe pavëmendshmërisë së njeriut ndaj argumenteve dhe shenjave të Zotit. Prandaj edhe pse ekzistenca e All-llahut është një e vërtetë e padyshimtë, ka edhe të tillë që nuk e pranojnë këtë të vërtetë: (El Hixhr: 14-15).

Ashtu sikurse trupi i nënshtrohet ligjeve që ka vendosur Krijuesi në natyrë, po ashtu edhe shpirti duhet t'i nënshtrohet faktit se All-llahu është Zoti dhe Krijuesi. Fitra, kthimi në normë, është baza e Islamit, prandaj, duke praktikuar Islamit, veprat e jashtme të njeriut harmonizohen me natyrën me të cilën All-llahu e krijoi qenien e tij.

Në shpirtin e tij ekziston ndjenja e mbështetjes dhe strehimit të një Qenie e lartë, dhe e fuqishme. Njeriu, vetëm duke iu kthyer zotimit burimor ndërmjet tij dhe Krijuesit, mund të jetë plotësisht vetvetja. Njerëzimi ka lindur dhe ka ardhur me besim (iman) në këtë botë dhe me këtë besim/iman duhet të ndahet dhe të largohet prej saj. "Kush ka pranuar me kënaqësi All-llahun për Zot, Islamit për fe dhe Muhammedin a.s. për pejgamber, ka shijuar ëmbëlsinë e besimit-imanit". (Hadith).



NGA DIASPORA

Bashkësia Islame Shqiptare "Hëna e Re" në Kreuzlingen të Zvicrës

Qyteti i Kreuzlingenit shtrihet në verilindje të Zvicrës, në kufi me Gjermaninë, buzë liqenit Bodan, dhe bashkë me qytetin gjerman të Konstanzës përbën një aglomerat prej afro 100'000 banorësh. Nga aspekti administrativ Kreuzlingeni bën pjesë në kantonin Thurgau (TG), njëri prej 26 kantoneve sa ka krejt Zvicra. Është formuar me njësimin e vendbanimeve Kreuzlingen-Egelshofen me Kurzrikenbachun (1927) dhe me Emmishofen (1928). Në vitin 1947 Kreuzlingeni bëhet qytet (me mbi 10'000 banorë). Në fund të janarit 2005 Kreuzlingeni ka numëruar 17'565 banorë, 44.7 % e të cilëve (7'858) janë me origjinë të huaj, kryesisht gjermanë (çdo i shtati banor [2'590 persona] posedon pasaportë gjermane). Qyteti ka një sipërfaqe prej 11.79 km² (më tepër: www.kreuzlingen.ch).

Xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen (fillimisht Shoqata "Hëna e Re") bën pjesë ndër xhamitë e para shqiptare që janë hapur në Zvicër. Zyrtarisht është hapur më 1 janar 1993, fillimisht në një hapësirë prej afro 82 m² në një sallë të ndërtesës së Vëllezërve Hager në Kirchstrasse 5 f. Brenda të njëjtit vit, bashkë me faltoren, me përpjekjet dhe flijimet më të mëdha të xhematit të kësaj Xhamie akomodohet edhe një hapësirë prej afro 32 m² si çajtoare e Xhamisë, e cila asokohe ka pasur edhe zyrën e saj prej 8 m². Në mesin e nënshkruesve të kontratës së parë të qirasë së këtij objekti figuronjë emrat e z. Servet Qazimit - kryetar, z. Imer Mislimit dhe z. Besir Ziberit - anëtarë kryesie.

Në krye të dy viteve kjo hapësirë fillon të mos i plotësojë nevojat e xhematit, pas çka ngjitas me këtë objekt, merret me qira edhe një pjesë e konsiderueshme prej afro 100 m², brenda së cilës krijohet edhe klasa për mësimin fetar të fëmijëve shqiptarë, me çka kjo xhami ka fituar një hapësirë prej afro 215 m².

Në mars të vitit 2007 është blerë një objekt i ri për xhami në Romanshornerstrasse 16 po në Kreuzlingen. Pas gjashtë muajve nga nënshkrimi i kontratës, pikërisht më 1 tetor 2008 filluan punimet për renovimin dhe përshtatjen e brendshme të objektit për nevojat e kësaj qendre. Në krye të gjashtë muajve mbaruan punët në këtë drejtim dhe pikërisht më 2 mars 2008 xhami i kësaj xhamie e përjetoi një ditë feste e gëzimi, kalimin nga objekti i vjetër i



xhamisë që gjendej në Kirchstrasse 5 f në këtë objekt të ri, i cili përpos faltores për burra prej afro 180 m², ka edhe pjesën e ndarë enkas për femrat me një madhësi prej afro 30 m². Pastaj ka kafenenë, zyrën e kryesisë e të imamit si dhe klasën për mësimin fetar që gjithsej kap një hapësirë prej mbi 300 m². Objekti në fjalë ka edhe një hapësirë të gjerë për parkimin e veturave si dhe dy banesa përmbi faltoren. Shkurt, për momentin ky objekt në mënyrë optimale i plotëson nevojat e kësaj bashkësie islame shqiptare këtu në Kreuzlingen dhe xhami është i kënaqur me punën që ka bërë dhe me vetë objektin e përshtatur sipas shijes së më të bukurës. Më 12 prill 2008 u bë hapja solemne e xhamisë së re ku morën pjesë Reisul-Ulemaja i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Sulejman ef. Rexhepi, Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, muftiu i Tetovës Alifekri ef. Esati, muftiu i Gostivarit Shaqir ef. Fetahu, përgjegjësi për shtyp pranë Bashkësisë Islame të Kosovës Ahmet ef. Sadriu, perfekti i komunës së Kreuzlingenit z. Andreas Netzle, prifti katolik Matthias Loretan, hoxhallarë nga Zvicra e Gjermania si dhe shumë besimtarë muslimanë nga këto troje.

Kryetari i BFI të R. së Maqedonisë Sulejman ef. Rexhepi

me këtë rast ndër të tjera theksoi: "E vërtetë e madhe e pamohueshme të cilën e dëshmon Kurani Famëlartë është ajo se xhamitë i ndërtojnë, xhamitë i meremetojnë dhe i riparojnë vetëm ata që kanë iman të paluhatsëm në Allahun Fuqiptotë, ata të cilët me dinjitet të plotë i kanë besuar dhe i besojnë Muhamedit a.s., ata të cilët fare nuk kanë pozicion dyshimi në shpirtin e tyre për çështjen e besimit në jetën e përhershme... Ne si bashkësi Islame në Republikën e Maqedonisë dhe institucionet fetare i janë mirënjohës Qeverisë Zvicerane dhe regjimit demokratik të këtij vendi, por kam bindje se edhe ju gjithashtu i jeni mirënjohës..."

Ndërkaq kryetari i BI të R. së Kosovës pasi ua uroi të pranishmëve shpalljen e pavarësisë së R. së Kosovës si dhe hapjen e kësaj xhamie, u shpreh: "Ju keni bërë një mesazh paqeje, afrie e bashkëpunimi edhe me pjesëtarët e besimeve të tjera, ngase islami është fe solidariteti dhe asgjë nuk ka të përbashkët me ekstremizmin e dhunën... Kur shoh se në këtë shtet janë plotësuar kërkesat tuaja, mua më mbetet vetëm t'i falënderoj ata për këtë angazhim si dhe për përkrahjen e vazhdueshme për pavarësinë e Kosovës..."

Sot ky institucion fetar quhet Bashkësia Islame Shqiptare "Hëna e Re" dhe ka Statutin e saj,

kryesinë e xhematit prej shtatë anëtarësh, imamin e rregullt, mr. Rejhan Nezirin si dhe një numër prej 240 anëtarësh të rregullt. Struktura aktuale e kryesisë së kësaj xhamie është si vijon: Faredin Xhaferi - kryetar, Bekim Ismaili - nënkryetar, Afet Sallai - sekretar, Abdilamit Amiti - arkëtar, Pajazit Kasami e Asim Dauti - ndihmësarkëtarë dhe Abdurrezel Aziri - bibliotekar.

Në kuadër të kësaj qendre është themeluar dhe sot e kësaj dite vepron edhe Forumi i të rinjve muslimanë në Kreuzlingen, të cilin më 17 shkurt 2007 e themeluan një grup të rinjsh muslimanë nga Kreuzlingeni e rrethina në prani të kryetarit dhe të imamit të xhamisë. Synim kryesor i këtij forumi është organizimi më i mirë i jetës dhe i aktiviteteve të të rinjve muslimanë këtu, në mënyrë që më mirë ta njohin e ta prezantojnë fenë dhe kulturën islame karshi vendasve dhe të huajve të tjerë që jetojnë në këtë mjedis. Ndër aktivitetet kryesore të këtij forumi deri më tani mund të përmendim pjesëmarrjen aktive me punë fizike, falë zanateve që i kanë përvetësuar këtu, në ndërtimin dhe përshtatjet tjera të objektit të ri të xhamisë; pjesëmarrjen në turnirë futbollit për të rritur; pjesëmarrje aktive në angazhimin për ruajtjen e pastërtisë së ambientit në bashkëpunim me forumet tjera të të rinjve në Kreuzlingen si dhe

organizimi i kuizit të diturisë për të rinj që u zhvillua më 21 mars 2009 në qendrën kulturore e sportive "Dreisnitz" të Kreuzlingenit, ku morën pjesë 14 garues shqiptarë e turq nga Zvicra lindore. Ky ishte kuizi i parë i këtij lloji në Zvicër, sepse ishte i destinuar për të rinjtë e sidomos për nxënës të shkollave të mesme e studentë të fakulteteve të ndryshme dhe se u zhvillua në gjuhën gjermane. Vitin e ardhshëm këtë kuiz ky forum mëton ta organizojë në shkallë më të gjerë mbarëzvicerane.

Juridikisht, por jo edhe financiarisht, kjo Bashkësi, përmes Këshillit Koordinues të Bashkësive Islame të vendlindjes me seli në Zürich, vepron në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë dhe kultivon marrëdhënie të ngushta me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ajo, në të njëjtën kohë është edhe anëtare e Lidhjes së Bashkësive Islame të Zvicrës Lindore dhe Principatës së Lihtenshtajnit, shkurt e njohur me emrin DIGO (www.digo.ch), kryetar i së cilës është mjeku palestinez Dr. Hisham Maizar. Natyrisht kjo bashkësi i nënshtrohet edhe të drejtës civile zvicerane për rregullimin e statusit juridik të shoqatave të ndryshme fetare, kulturore, sportive etj. (Kodi Civil Zviceran, nenet 60-79). Si pikësnyime bazë të saj kjo bashkësi islame ka: mundësimin e ushtrimit të parimeve të fesë islame në këtë rreth; zhvillimin e arsimit fetar e kulturor për fëmijët e të rinjtë muslimanë; avancimin e bashkëjetesës, të mirëkuptimit të ndërsjellë e të tolerancës në mesin e ndjekësve të feve të ndryshme këtu në Kreuzlingen e rrethinë; nxitjen dhe përkrahjen e dialogut ndërfaqetor si dhe të aktiviteteve të përbashkëta fetare. Për të arritur një përmirësim të komunikimit të ndërsjellë dhe të këmbimit të lirë të ideve, kjo bashkësi apo qendër islame merr një qëndrim të qartë të së mesmes në Islam, duke kundërshtuar kështu çdo formë të ekstremizmit fetar, kombëtar, kulturor e ideor. Ajo angazhohet fuqishëm për integrimin e shëndoshë të muslimanëve në këtë qytet dhe në shoqërinë më të gjerë zvicerane.

AKTIVITETET

Përpos 5 namazeve ditore, xhumasë e bajrameve, në këtë xhami mbahen edhe një sërë ligjëratash e takimesh me xhemate të moshave të ndryshme. Pos ligjëratës së zakonit që mbahet para namazit të xhumasë; të shtunave mbas namazit të jacisë mbahen takime me të rinjtë ku diskutohen tema fetare të cilat zgjidhen sipas kërkesës së vetë të rinjve; të dielave pas namazit të drekës sërish vijojnë ligjëratat



fetare për të rritur. Dy ditë brenda javës, zakonisht pas namazit të akshamit ose jacisë, zhvillohet mësim fetar për të rritur, ku mësohet leximi i Kur'anit në gjuhën arabe. Një herë në muaj, të dielave pas namazit të drekës, mbahet nga një ligjëratë enkas për gratë nga mual-limja Ibadet Neziri. E njëjta zhvillon mësimin e Kur'anit për gratë muslimane të martave e të dielave në klasën e xhamisë. Mësimi fetar për fëmijët mbahet në klasën e xhamisë (www.el-hikmeh.net/mektebi) ditëve të mërkura pas dite dhe të shtunave e të dielave para dite. Momentalisht këtë mësim janë duke e ndjekur afro 80 nxënës, djem dhe vajza. Ata janë të ndarë në gjashtë grupe, sipas gjinisë dhe moshës së tyre. Në shkallën e parë ata mësojnë duatë (lutjet) kryesore, mënyrën praktike të faljes së namazit si dhe parimet bazë të fesë islame. Në shkallën e dytë mësojnë shkronjat arabe dhe në të tretën këndimin e Kur'anit në gjuhën arabe. Në çdo të dytën të diel nxënësve u jepet nga një leksion mbi kulturën fetare të shkruar në gjuhën shqipe, me një fjalorth shqip-gjermanisht si dhe me pyetjet si detyrë shtëpie, me çka mëtohet që fëmijëve t'u përcillen njohuritë më të gjera rreth Islamit dhe atë në gjuhën shqipe. Nxënësit e kësaj xhamie marrin pjesë rregullisht edhe nëpër manifestime e programe të veçanta për ta që organizohen nga xhamitë e rajonit, si pjesëmarrja në turnirin e futbollit për djemtë, pjesëmarrja në kuizin e diturisë etj. Xhamia "Hëna e Re" mundohet që vazhdimisht t'i shënojë më denjësisht e solemnisht edhe festat fetare, netët e ditët e mëdha që kanë peshë e rëndësi të veçantë në bagazhin e madh fetar e kulturor islam.

IMAMI

Imami i kësaj qendre është mr. Rejhan Neziri, i lindur në vitin 1972 në f. Tearcë të Tetovës, ku e kryen shkollën fillore. Medresenë e kryen në Shkup (1991) kurse fakultetin teologjik në Bursa të Turqisë ku edhe magjistron në lëmin e sociologjisë së religjionit. Në vitin akademik 2001/2002 ligjëron historinë e filozofisë dhe historinë e filozofisë islame në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Që nga nëntori i vitit 2002 shërben si imam në Kreuzlingen. Është i martuar dhe baba i 3 fëmijëve.

Punimet shkencore:

1. Bilal Hasanović, ILMUDDINI, përkthim nga boshnjakishtja, botoi: SHB "Furkan", Shkup, 2000;

1. Nexhib Fazëll Kësakyrek, TE KRIJOJ NJE NJERI (BIR ADAM YARATMAK), dramë, përkthim nga turqishtja, botoi: SHB "Logos-A", Shkup, 2003;

3. Ahmed Hurshid, ISLAMI - Parimet dhe veçoritë kryesore (ISLAM - Basic Principles and Characteristics), përkthim nga

anglishtja, botoi: BISH "Hëna e re", Kreuzlingen, Zvicër, 2003; 4. Rejhan Neziri, JETA FETARE NE TETOVE DHE RRETHINE, pjesa e katërt e punimit të magjistraturës, botoi: BISH "Hëna e re", Kreuzlingen, Zvicër, 2003; 5. Yakup Ustün, PEJGAMBERI YNE - MUHAMMEDI A.S. (MUHAMMAD, THE PROPHET), nga anglishtja: Ali Pajaziti dhe Rejhan Neziri, botoi: BISH "Hëna e re", Kreuzlingen, Zvicër, 2003;

6. Rejhan Neziri, ISLAMI DHE MUSLIMANET NE PERENDIM / ZVICER, Përmbledhje artikujsh, botoi: BISH "Hëna e re", Kreuzlingen, Zvicër, 2004; 7. Ismail Raxhi el-Faruki, TEWHIDI - Implikimet e tij mbi mendimin dhe jetën (AL-TAWHID: Its Implications for Thought and Life), përkthim nga anglishtja, botoi: SHB "Logos-A", Shkup, 2003;

8. Artikuj të ndryshëm nëpër revista e gazeta...

9. Përkujdesës i web faqes sonë dhe i nënfaqeve të saj: www.el-hikmeh.net



PROMINENCA AKLIMATIZUESE E SISTEMIT ISLAM DHE MODELET POLITIKE TË AKROPOLIT EUROPERENDIMORË (1)

Historia dhe praktika e pegamberëve na rrëfen se sistemi i tyre udhëheqës ka qenë saktësia dhe minucioziteti i komentimit të gjendjes në kohën në të cilën kan vepruar . Ata nuk jan shfaqur si rebelues ndaj fuqive ekzistuese siç dëshiron dikush të i përshkruaj, por ata kan bërë explorimin e fuqive ekzistuese, anomalitë dhe të metat e këtyre fuqive i kan afruar më afër syve dhe kuptimit të popullit.

Taxhudin Hamidi

Tendenca e kuranit është që sistemi dhe modelet e veprimtarisë politike të zhvillojn ndërtimin dhe konstruktimin historik të sistemit dhe modelit të varur nga urdhri obligativ i fuqisë absolute të Allahut xh.sh. e cila gjat jetës politike është përfaqësuar në mënyrë autentike përmes të dërguarve të tij, dhe për bashkëkohanikët e tyre të mbetet prototip dhe parekselans i vlerave shpirtore.


Islami garanton se kurani është shpallur që të shkurtoj rrugën drejt prosperitetit, që njerzimit në këtë botë të u ndihmoj të gjejnë sistemin më të sufistikuar përmes shprehjeve ideale që i promovon Kurani përmes mësimave në mënyrë konstante dhe pa limonti.

Hermeneutika dhe egzegeza kuranore dukshëm shkurton humbjen e kohës, dhe shkurton rrugën e gjatë. Drejt gjetjes së rrugës me perspektivë të dëshmuar dhe të sigurt. Majfton më që njerzimi të luftoj në mes veti se cili do të përpiqet ligje më të avansuara për lirinë dhe të drejtat e njerzëve. Por pandërprerë të njohtojm rrethet shkencore e politike se ligji për një jetese të qetë dhe koegzistencë me kohabitacion multikonfesional dhe multietnik është i gatshëm vetëm kërkohet të përfillen vlerat nga prominencia islame.

Në modelin politik të Islamit nuk mund të gjindet programe skeptike, projekte të cilat ofrojn elemente me afat dhe karakter palijativ e të përkohshëm . Lirshëm mund të konfirmojmë faktin se modeli i sistemit politik Islam meriton të jetë udhëheqës në procesin udhëheqës të karavaneve politike konvencionale në botë, burim i mendimit paqësorë dhe i vetmi sistem i cili siguron mundësinë e menaxhimit dhe organizimit në jetën politike në mënyrë të përkryer.

Gjat zhvillimeve historike në shoqërinë e njerzimit kurani i riparaqet njerzimit fotografi të hapur në të cilën gjithsesi haptas reflektohen shenjat dhe reperi i kacafitjeve, averzionit, diskrepancës dhe kolizionit - e mira dhe keqja (el-hajr we sh-sher) dhe - dëshira e Allahut dhe e njerzëve.

Nga kjo dua të kuptoj se pozita



e politikës në shtetin Islam nuk është e verbër, daltoniste dhe nuk qëndron shtrirë përdhe pa jetë e pa lëvizur si një pikturë. Duke qenë dëshmitarë të politikës botrore e cila me shum mund dhe investime maramendëse nuk arinë të qetsoj dhe siguroj politikën ditore monstruozë, kretene e kanibaliste në vendet jo të zhvilluara në juglindje të europës. Politika ndërkombëtare është viktimë e oportuhizmit, demagogjisë, shantazhmeve të ndryshme, fushatat me shprehje plastike, skepticizmi legjendarë dhe përshkrimi i politikës si një mit.

Sepse kur potencohen vlerat e sistemit politik Islam në formë të pushtetit, studimi i mendimit politik europerendimor velet e flashket dhe anatemon islamit dhe cilson atë me parametrat larg studimeve shkencore politike. Nga ana e perendimorve Islami demodifikohet si stereotip dhe detronizohet gjoja për shkak të insuficiencës industriale dhe për paternalizëm. Nga ky definim Islami duhet të përfundoj në apotet rrëzë Taigetit.

Mirpo kur kritikohet sistemi europerendimor kjo sharjesondazhë vlersohet si sakrilegj dhe mizologji-opskurantizëm, nga orakulli i kryeqitet, europian. Sikur dëshirohet për xhdo përsëritje të vlerave europerendimore njerzitet dashje e pa dashje të ndjehen se gjoja po lindë Harilaosi - gëzimi i popullit.

Andaj askush nuk nuk mund të avancoj një teori nëse nuk mund ta shoqeroj ate me fakte. Asnjë sistem politik nuk arin dot të krijoj lumturinë me dëshira narcisoide.

Ndoshta kishte të drejt kryetari iranian Mahmud Ahmadinezhad më 2005 duke folur gjatë një vizite në juglindje të iranit tha se: „nëse dikush vë në pikpyetje Zotin, atëherë asnjë nuk thotë ndonjë gjë, por nëse dikush vë në pikpyetje holokaustin, atëherë ata fillojn të bërtasin, sepse ata paguhen nga sionistët.

Gjatë historisë është dëshmuar se askush nuk ka aritur të vë në pah të mirat e superstrukturës ose duke shtytur një kulturë me mercenar dhe me cicerona eklektik, suplent e subverziv.

Historia dhe praktika e pegamberëve na rrëfen se sistemi i

tyre udhëheqës ka qenë saktësia dhe minucioziteti i komentimit të gjendjes në kohën në të cilën kan vepruar . Ata nuk jan shfaqur si rebelues ndaj fuqive ekzistuese siç dëshiron dikush të i përshkruaj, por ata kan bërë explorimin e fuqive ekzistuese, anomalitë dhe të metat e këtyre fuqive i kan afruar më afër syve dhe kuptimit të popullit.

Duhet përmendur se nuk mund të zbrasin mësimet e tiranëve, despotëve dhe armiqëve, po qe se do të jemi gjithnjë të thjeshtë dhe askush nuk do të përpiqet të dal mbi të tjerët.

Ne lashtësi kan besuar se: „nuk është pa mure ai qytet që është i rrethuar me burra e jo me tulla,,. Harilau, nipi i Likurgut, kur e pyetën pse i ungji i kishte nxjerë aq pak ligje, u përgjigj: „atyre që flasin pak, pak ligje u duhen,,. Është e vërtetë se për deri sa nuk dimë se çduam, ne nuk do të dijmë se çduhet të bëjm. Prandaj pejkamberi i Islamit kurrë nuk e ndau jetën e tij në dy pjesë, me çrast, njëra pjesë do ti kushtohej veprim-it, ndërsa pjesa tjetër të folurit. Prandaj detyrë jonë e parë është që ta njohim fenë tonë, sepse Islami është qe t,i japë kahje ardhmërisë së njerzimit dhe njëkohsisht si suplement dhe komplemen të gjurmojm dhe gërmofilizojm ënët e mira e të këqia të sistemeve dhe vlerave europerendimore të cilat infiltrohen nëpërmjet developmentit apologetik të avantazhit apokaliptik.

Andaj, ne duhet të qëndrojm në këmbët tona. Ne duhet të ushqehemi nga pasuritë tona kulturore dhe burimore. Duhet të dalim nga gjendja e hutisë, në të cilën kemi hyrë nga vlerat dhe modelet e shablonizuara të perendimit. Vetë perendimorët kan filluar të trishohen nga kultura e tyre e udhëhequr nga elita e rokfelerëve dhe politikëneve. Më sipër përkujtuam sesi hortativa dhe akribia në misionin e pejkamberëve vuri në desk pune fuqitë ekzistuese për çlirimin e popullit nga mësimet degjeneruese, retrograde dhe së fund eksploatuuese. Si për shembull, posa u paraqit Ibrahim, ai filloi të thyejë idhujt njërin pas tjetrit. Ai e goditi idhullin (ikonoklast) më të madh dhe e shpalli kundërshtimin e tij ndaj

politeizmit - (ikonolatër). Gjejë e parë, të cilën e bëri Musai. i veshur si bari me shkop në dorë, ishte hyrja në oborin e faraonit dhe shpallja e kundërshtimit ndaj tij në dobi të bashkimit të njerëzve. Isai filloi me përlëshjen e tij me fuqinë ekzistuese të klerit hebreit, sepse kleri ishte i lidhur dhe pranonte politikën kolonizuese të Romës.

Ndërsa hapja e periudhës së re te Muhammedi në shtetin e ri Islam ka qenë agjenda e eksproprijacionit. Konstituimi i shtetit të po sa formuar në plan të parë ka pasur alfa-omega problemin e konfiskimit të pasurisë së muhaxhirëve pikërisht apropiacioni.

Muhammedi s.a. filloi përlëshjen me aristokracinë sklavopronarët pronarët e tokës së taifit dhe me tregtarët kurejshë. Përpyqje e vazhdueshme grandioze dhe imponante të sistemit të po sa formuar Islam ishin liria dhe të drejtë e njeriut. Andaj reformatori turk Seid Nursi, thoshte: „Unë jetoj pa ushqim, por nuk jetoj dot pa (hurijet) liri,..”

Kështu bediuzzemani pjesën e dytë të jetës së tij e filloi me devizën dhe lutjen (eudhubillai-mineshejtani ve es-sijase).

„O zot unë mbrohem me ty prej djallit dhe politikës (rendit të keq politik).

Për të justifikuar se liria ka qenë masa voluminoze e përpjekjeve të të dërguarit Islam, lehtë arihet deri te vrojtimit dhe kondrimi i kësaj çështje, sepse Muhammedi s.a. në përhapjen e fesë Islame iniciativat e para i mori me personalitet e pa mbrojtura, që nuk kishin peshe politike dhe ekonomike në shoqëri. Njerëz me të drejta të thyera dhe apsolutisht të kufizuara.

Nga rrëfimet e Muhammedit s.a. zbulojm se avancimi i të drejtave u zgjerua edhe tek kafshët dhe shtazët. Sepse Muhammedi s.a. deklaroi se vrasja e një trumcakut ose dënimi i kafshës për shkak të infrastrukturës së dobët rrëzë brigjeve të Irakut, do të kulmoj me ndëshkim në ahiret, do të thotë që pushtetmbajtësi në shtetin Islam konsiderohet përgjegjes para Allahut dhe para ligjit, jo vetëm për lirinë dhe të drejtat e njeriut, por gjithsesi duk mos e anashkalluar edhe mbrojtjen e kafshëve dhe shtazëve. Për arsye se ai është i obliguar të zbatoj ligjin e jo të krijoj ligje sipas idiosinkracionit të spikatur politik.

Vazhdon...

LEXIMI I KUR'ANIT MREKULLI E VEÇANTË

"E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur u përmendet Allahu u rrënoqthen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e tij u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te zoti i tyre". (El Enfal-2)

Rexhep Ziberi

Pa dyshim se Kurani është mrekullia më e madhe e të gjitha kohërave, misteret e Tij dita ditës shtohen e shumëzohen, ata nuk kanë të mbaruar asnjëherë. Ai posedon mrekulli të shumë anëshme, një ndër mrekullitë e shumta që posedon Kur'ani është vetë të lexuarit e tij.

Kurani është Libri më i lexuar në botë, është Libri që mësohet më së shumti përmendësh nga miliona njerëz të vendeve të ndryshme në botë, është Libri që ka ndikim më të madh në jetën e përditshme të besimtarëve musliman.

Nuk ekziston vepër më e dashur për besimtarin musliman se sa leximi i fjalëve të Krijuesit Apsolut, fjalë të cilat sado që ti lexon njeriu nuk ngopet asnjëherë me ta, pamvarsisht nga ajo se nuk i kupton.

Do të ishte e palogjikshme që një njeri i cili nuk dinë asnjë fjalë të gjuhës Frengje të merr dhe të lexon të përditshmen frans-pres mëngjes për mënjgjesi duke mos kuptuar asnjë fjalë të saj! Vallë a do t'a kishte bërë këtë njeriu i mençur? Madje, a do ta lexonte frans-presin e një dite tërë jetën e tij!? Asnjëherë.

Për dallim nga kjo me miliona njerëz në rruzullin tokësorë edhe pse nuk e njohin gjuhën Arabe, Librin e Allahut f.p që e zbriti në gjuhën Arabe e lexojnë disa herë në ditë dhe assesi t'iu bëhet monoton, madje ç'është më rëndësi sa herë që e lexojnë ndjenë edhe aq më tepër nevojë për rileximin e Tij! A thua ç'ndodhë me këtë Libër?! Kush është ajo që e lidhë zemrën e njeriut me leximin Librit të cilin ai fare nuk e kupton?!

Kjo është natyrshmëria e njeriut e lidhur ngushtë me fjalët e Atij që

krijoi këtë natyrë njerëzore.

DETAJET E KUR'ANIT

Dijetarët e rruzullit aq shumë u interesuan për këtë Libër sa që na treguan edhe detajet më të vogla që përmban ky Libër duke u nisur nga shkronjat fjalët dhe fjalit e tij.

Kurani famëlartë përmban gjithësejtë: 381.121 shkronjë, 73.412 fjalë, 6.219 fjali, 114 kaptina dhe 30 pjesëza të ndara me nga 20 faqe. Ai është i përkryer në çdo shkronje të Tij. Ai është larg ndryshimeve, është i ruajtur dhe i mbrojtur nga çdo ndryshim, që nga zbritja e tij e deri në ditën e gjykimit nuk do të pësoj asnjë ndryshim qoftë edhe të një shkronje. Ky është Libri i cili përmbanë fjalë të cilat ia kënaqin shpirtin njeriut, fjalë të cilat janë të ngulitura në brendin me të thellë të zemrën së besimtarit musliman, fjalë që nuk plaken asnjëherë, fjalë me të cilat njeriu nuk ngopet në asnjë mënyrë. Këto janë fjalët e Kuranit famëlartë, që është i pamposhtur dhe i pavdekshëm deri në ditën e katalizmës së përgjithshme po edhe pas saj!

Kur'ani është Libër i përjetshëm që nuk është i krijuar, Ai është libri i librave, madhështia e Kur'anit mahnit masën e thjeshtë, si dhe rrafshin intelektual, për këtë poeti i madh Rus Pushkin në letrën që ia shkroi të vëllait në vitin 1828 thotë: "Jam duke e lexuar Kurantin e mashërishëm." Kurse në vjershën e tij ai shkruan: "Në shpellën e fshehtë, ditën e ndjekjes, duke lexuar Kur'anin e ëmbël"

Kur'ani posedon muzikalitet fascinaues, simfoni të mrekulluar, tingujt e Kur'anit i shtynë dëgjuesit deri në derdhjen e lotëve, kumbimi dhe jehona e zërit Kur'anor dridhë kodra e male, ai dëgjohej kudo në botë.

Leximi i Kuranit asnjëherë nuk sjell mëzë te besimtarët, përkundrazi gjatë rileximit, dashuria ndaj tij shtohet edhe më shumë. Vargjet Kur'anore janë ata që e bëjnë për vete shpirtin dhe zemrën e besimtarit.

ELOKUENCA E KUR'ANIT

Tingujt e tij posedojnë bukuri

magjepse dhe pushtuese, Ai posedon një elokuencë të përkryer, para stilit të pastër gjuhësor të Kur'anit u gjuhëzuan edhe linguistët më të mëdhenjë botërorë.

Për nga aspekti letrar ata Kur'anin e konsideruan si kryevepër me karakter botërorë.

Për stilin e Tij të përkryer dhe të mrekullueshëm folën edhe dijetarët që nuk i takojnë konfesionit Islam.

Përkthyesi i Kuranit në gjuhën Angleze Arthur Arberry thotë: "Sa herë që e dëgjoj leximin e Kuranit më duket sikur degjoj muzikë, melodia e së cilës përcillet me të rrahura të përhershme të lodrave, dhe kjo më krijon emocione të fuqishme sikur më pëlçet zemra ime".

Studiuesi francez J.S. Restler thotë: "Meqë bukuria e Kur'anit qëndron në stilin e tij të mrekullueshëm, Ai ka zbritur për t'u lexuar ose për t'u kënduar me zë të lartë dhe asnjë përkthim nuk mund ta shpreh dallimin preciz dhe përplot ndjeshmëri orientale. Duhet ta lexosh në gjuhën e tij (arabe) në të cilën është shkruar, që të arrish të ndiesh gjuhën e Tij, fuqin shprehëse dhe madhështinë e formës së Tij. Muzikaliteti dhe rima e Tij sajojnë ndikim magjik në shpirtë, ku shndrisin mendimet me fuqinë e tyre dhe pamjet me shkëlqimin e vet. Askush s'mund të mohoj se ritmi i Tij mahnitës dhe spirtualiteti i Tij i shkëlqyer ndikojnë në ndijimin tonë, dhe në atë se Muhamedi (a.s) është i frymëzuar nga mashëria dhe madhështia e Allahut (xh.sh.)".

Për nga aspekti arsimor në Kur'an hasim begatitë më të mëdha intelektualë që ua tejkalonë të gjithë dijetarëve më të mëdhenjë botërorë, pamvarsisht se cilës lëmi i përkasin ata.

Për ne muslimanët Kur'ani është fjalë e gjallë në zemrat tona, është gjëja më e shejtë që ne e posedojmë.

Kurani është libër i besimit, është libër i legjislacionit, është pikënisje e shumë shkencave dhe diturive, është libër i gjuhës dhe letërsisë, është libër i etikës dhe moralit është dritë nga dija e Allahut xh.sh..



MËSIM-BESIMI FETAR NËPËR SHKOLLA SHTETËRORE PO OSE JO

Shaban SULEJMANI

Sipas konceptit të rregullativës ligjore të Maqedonisë shteti duhet të jetë neutral për sa i përket bashkësive fetare, gjegjësisht të funksionojë ndaras nga platformat e bashkësive fetare që funksionojnë në RM. Njëherësh dhe një nga parimet e rëndësishme kushtetuese të shtetit e cila në mënyrë shumë eksplicite është e proklamuar Kushtetuta e RM. së, dhe atë në nenin 19, ku thuhet se feja është e ndarë nga shteti. Një parim i këtillë nuk është veçori e Maqedonisë, por, që nga revolucionin Francez kur dhe lindi ky parim, përshkoi edhe shumë shtete të botës të cilat jo dhe aq gjatë qëndruan në fuqi ashtu siç po kuptohet dhe interpretohet sot te ne. Shprehja e cila përdoret, si në përditshmëri gjatë komunikimit si në komunikim të lirë dhe në literaturë, paraqet njëherësh një specifikë me një shprehje franceze laicite. Me këtë shprehje që nënkuptohej atëherë, e që a e ka po të njëjtin kuptim dhe për atë qëllim a përdoret edhe sot, apo thjesht vetëm përqendrohet në të nënkuptuarit e ndarjes së shtetit nga feja që po ashtu shumë ngushtë është e lidhur me termin shtet sekular, është një dilemë e cila kërkon një qasje serioze për ta hulumtuar atë në mënyrë shumë objektive dhe shkencore.

NDARJA E SHTETIT DHE FESË

Një koncept të ndarjes së shtetit nga feja e ka marrë një numër i madh i shteteve evropiane bashkëkohore. Pra, ka dhe shtete të tilla, edhe pse pak në numër por megjithatë prezent, proklamojnë religjionin shtetëror të tyre. Të sqarojmë faktin se këto shtete nuk bëjnë, apo së paku nuk i duhet të bëjnë, diskriminimin e bashkësive tjera fetare jo shtetërore, e cila nuk është në një lidhshmëri dhe afërsi si me atë të cilën e proklamon. Mund të hasim gjithashtu edhe aso shtete ku sistemi juridik i tyre parashihet ndarjen e shtetit nga feja e nuk nënkupton shpëputje të plotë të shtetit nga feja, sidomos kur kryhen punë dhe funksione të përbashkëta. Mirëpo, si duket një

mentalitet të vjetër komunist të cilin e kemi pasur për gjysmë shekulli në këto vende tona të rajonit, e veçanërisht në Maqedoni nuk është edhe më i tejkaluar që pikërisht teza se "feja është opium i popullit", edhe më në kokat e disa njerëzve e "intelektualëve" nuk ka të ndaluar ajo "eho", e cila që herët është krijuar në shpirtrat e mendjet e tyre. Pikërisht duke u nisur nga një fakt i këtillë mendohet se ato mes vete nuk mund të bashkëprojnë, nuk mund të realizojnë punë të përbashkëta, asgjësend që paraqet funksion shtetëror feja nuk ka mundësi as që të përmendet e të jep kontributin e sajë. Një logjikë të këtillë neutraliteti gjegjësisht ndarja e shtetit nga feja nuk ka këtë kuptim edhe te shumë shtete të cilat sistemi i tyre ligjor proklamon këtë princip. Këtë realitet që po e cekim e ilustruam me faktin që shteti më sekular në botë si SHBA-të edhe pse proklamojnë ndarjen e plotë të shtetit nga feja ajo nuk ka një kuptim ashtu siç është evident te ne. Duke filluar nga motoja e tyre nacionale "Në Zot ne shpresojmë", e cila është e 'gdhendur' në parandë e këtij shteti që nga viti 1865, sa që edhe në vet himnin nacional të saj, si simbol shtetëror, ku me fjalën Zot mbaron ajo, janë argumente të mjaftueshme për kuptimin ndryshe nga ajo që ne e

akceptojmë mbi ndarjen e shtetit nga feja. Mu për këtë arsye teoricientët modern më të spikatur të së drejtës eklezialiste me të madhe theksojnë se sot në Unionin Evropian, por edhe në përgjithësi në të drejtën evropiane krahasues, parimisht mund të dallojmë tre sisteme për sa i përket relacionit fe shtet:

- Sistem i shteteve të cilat në mënyrë shumë të ngushtë kanë relacione të ndërsjella me njëra-tjetrën, fe dhe shtet, si : Greqia, Anglia, Danimarka, Suedia, Finlanda, Norvegjia

- Sistem i shteteve të cilat në mënyrë të rreptë e kanë ndarë shtetin nga feja si Franca, Irlanda, dhe gjer diku Holanda

- Sistem i cili kohëve të fundit është shumë i përhapur e që njihet me emrin sistemi i bashkëpunimit, kooperimit të ndarë. Te shtetet me sistem të këtillë edhe pse parimisht ato janë të ndarë, megjithatë shteti dhe bashkësitë fetare ndërmarrin disa punë të cilat janë me interes të përbashkët për t'i kryer, e të cilat pa një bashkëpunim të ndërsjellë nuk do të mund të realizoheshin në atë mënyrë të dëshiruar. Këtë sistem e hasim te shtetet si : Belgjika, Spanja, Italia, Portugalia, Gjermania, Austria, etj.

Edhe përkundër gjitha këtyre fakteve që i cekëm në të drejtën

“

Në mesin e dilemave të cilët do të paraqiteshin dyshimin në lidhje me lejueshmërinë e mësim-besimit nëpër shkolla shtetërore publike do të ishte arsyetimi se vihet në pikëpyetje laiciteti i shtetit, gjegjësisht ndarja e shtetit nga feja, duke iu referuar kështu kornizës së brendshme ligjore të R. M.-së..

ekleziastike krahasues mund të hasë një proces gradual i konvertimit në sistemin e kishës gjegjësisht fesë shtetërore "përzierja e njërës në punët e tjetrës sa vije e zvogëlohet, e si shembull tipik mund të cekim Anglinë ku kohëve të fundit një ndarje e këtillë shumë qartë mund të vërehet. Në fakt, kompetencat kanë filluar shumë



prerazi të janë të definuar, dhe ato po respektohen edhe për kundër faktit se kisha Anglikane-si kishë shtetërore në krye të së cilës qëndron mbretëresha, njëzet e pesë vendet në Dhomën e Lordëve pikërisht janë të rezervuara për priftërinjtë e kishës në fjalë. Praktikisht nuk ekziston një e drejtë e brendshme e kishës Anglikane edhe përkundër asaj se ligjet e saja i sjell Parlamenti anglez me propozim të Sinodit të Përgjithshëm të kishës. Megjithatë, shumë shpesh Sinodit të Përgjithshëm i barten autorizimet për sjelljen e ndonjë aktit të veçantë juridik, veprime këto që gradualisht po ndahet e drejta kishtare nga ajo shtetërore. Pos kësaj mënyre të ndarjes së shtetit nga feja ka nga shtetet të cilat kanë ardhur gjer te ndarja formale dhe ruajtja e lidhshmërisë mes shtetit dhe kishës, gjegjësisht fesë si p.sh. Suedia. Në shtetet si Franca, ku ndarja mes shtetit dhe kishës është e theksuar, ajo ndarje sa vije e bëhet më pak strikte. Si duket në këtë shtet ndarja e theksuar aq shumë mes shtetit dhe fesë realisht vije e më shumë po shndërrohet në përzierje, gjegjësisht kompetencat edhe pse janë të ndara në realizimin e funksioneve të rëndësishme shoqërore ajo vije e gërshetohet edhe më. Mund të theksojmë me këtë rast financimin nga buxheti i shtetit për renovimin e kishave, sa dhe haset dhe mbajtjen e mësimit fetar në shkolla shtetërore në disa pjesë të saja. Prandaj, për këtë dhe fakte të tjera të shumta mund të thuhet se sot në shumë sisteme juridike evropiane ideja dominante është ajo e ndarjes së shtetit nga feja por e atillë e cila nënkupton bashkëpunimin mes tyre. Në përgjithësi Në Unionin Evropian bashkëpunimi mes shtetit dhe fesë është bërë rregull. Kooperimi sot është nga kuptimet kyçe në relacionin mes fesë dhe shtetit në kuadër të shteteve të UE-së. Me rënien definitive të sistemit komunist më në tërë Evropën ky bashkëpunim gati se ka përfshirë të gjitha shtetet e UE-së. Thënë shkurt, ndarja e shtetit nga feja shikuar teoritë bashkëkohore dhe përvujtjen e legjislacionit evropian nuk e shohin këtë çështje të kundërshtuar, si një formë e injorimit të shtetit ndaj kishës dhe gjithë asaj që ndërlihet me religionin, por se si një imperativ për bashkëpunim për çështjet me interes të përbashkët. Njëra nga fushat në të cilat një bashkëpunim mes shtetit dhe fesë më së shumti vije në shprehje organizimi e financimi i mësimit në shkollat shtetërore. Me vet faktin se në shumë shtete evropiane nëpër shkolla ekziston lënda e mësimit nëpër shkollat shtetërore. Me vet faktin se në shumë shtete evropiane nëpër shkollat ekziston lënda e mësimit nëpër shkollat shtetërore. Me vet faktin se në shumë shtete evropiane nëpër shkollat ekziston lënda e mësimit nëpër shkollat shtetërore.

të me të mësuarit e lëndës së mësimit në shkollat shtetërore. Përgjithësisht edhe sistemi juridik i Francës që konsiderohet shembull i sekularizimit dhe laicizmit që promovon ky shtet nuk e trajton mësimin e lëndës së mësimit nëpër shkolla shtetërore si veprim antikushtetues dhe antiligjor gjegjësisht jo ligjorë. Vet shtetit Francez organizon mësimin fetar, jo në tërë territorin por në disa pjesë të tij.

PASQYRIM JURIDIKO KRAHASUES I LEGJISLACIONIT EVROPIAN

Sistemet e drejtësisë në botë janë neutral, ashtu siç është dhe shteti ynë i cili në drejtën për secilin individ për t'u deklaruar apo jo për bindjen e tyre fetare, ndalesa për imponim të një bindje fetare, që njëherazi janë vetëm disa nga principet e Kushtetutës së shtetit tonë. Edhe përkundër këtyre principeve të sistemeve të drejtësisë që i kanë shtetet Evropiane, sipas disa legjislacioneve të tyre, në përgjithësi mund të vërejmë se parashiheshin disa forma të mësimit fetar në shkollat publike shtetërore. Dallimet eventuale që mund të vërehen ka mundësi të përqendrohen në disa kritere, të cilët po i përmendim në vazhdim, dhe atë:

- Në bazë të përmbajtjes së lëndës së mësimit-besimit fetar në shtetet në të cilat ajo zhvillohet dallohet disa modele shikuar aspektin e sajë konfesional. Të tilla shtete mund t'i përmendim Gjermaninë, Austrinë, Bullgarinë, Kroacinë, Republikën Serpska, Kroaci, Itali, Poloni, Rumani, Belgjikë, Luksemburg, Spanjë, Irlandë, Danimarkë. Në një numër të caktuar të legjislacioneve të shteteve Evropiane parashihet një qasje multikonfesionale siç janë Britania e Madhe, Norvegjia, Finlanda, Portugalia, etj. Në disa shtete pos këtyre mënyrave të qasjes së mësimit nëpër shkolla shtetërore njihet edhe modeli jo konfesional i lëndës në fjalë, si një model i kulturës së përgjithshme, siç është Suedia, Rusia, Çekia, Estonia, etj.

- Në bazë të financimit për realizimin kësaj lënde gjer më tani njihen dy lloje mundësish. Njëra ku shteti do ta financonte apo për zhvillimin e sajë të bie mbi buxhetin e bashkësive përkatëse fetare, zakonisht në ato shtete ku njihet i ashtuquajturit tatimi ndaj kishës siç është rasti me Zvicrën. E njëherësh ekzistojnë raste ku vihet re një sistem i përzier, participin pos shtetit edhe bashkësitë fetare.

- Sipas obligimit të ndjekjes së kësaj lënde parimisht njihen katër modele.

Ekzistojnë shtete të shumta ku lënda e mësimit-besimit fetar parimisht është obligative për secilin

nxënës, siç mund të përmendim shtetet skandinave që janë pishtarë dhe vërtet shtete demokratike që e dëshmojnë atë dhe në praktikë. Duke cekur fillimisht Suedinë, ku ajo lëndë paraqitet si lëndë e kulturës së përgjithshme për qytetarët, pastaj Norvegjinë ku nga viti 1969 lënda e mësimit-besimit si multikonfesionale është e obligueshme gjatë shkollimit, edhe pse nga vit 1995 nëpër shkolla vazhdon të mësohet kjo lëndë me emrin Mësimi fetarë dhe kultura etika. Njashtu as Finlanda nuk ngelet mbrapa kësaj lënde që të mësohet nëpër të gjitha shkolla shtetërore pa përjashtim. Në fakt në këtë shtet nxënësit, të cilët nuk i përkasin dy feve shtetërore, si ajo evangjelist, luteriane dhe krishtere ortodokse, të cilat i njeh ky shtet, mund që ata ta zëvendësojnë me kurse për kulturë të përgjithshme mbi religjionin dhe filozofinë. Danimarka që nga viti. 1969 ka sjell ligj me anë të së cilit e ka bërë lëndën e mësimit fetarë si të obligueshme në të gjitha shkollat e mesme shtetërore, të cilësuar si 'edukimi krishterë'. Vetëm pas gati njëzet viteve në këtë shtet vërehet se mësimit-besimit fetar humb karakterin e tij si lëndë obligative dhe ngel si lëndë e kulturës së përgjithshme. Shtete që ndodhen në afërsinë tonë si Austria p.sh. mësimit fetarë nëpër shkolla është i obligueshëm dhe ajo financohet nga ana e buxhetit të shtetit austriak. Ndërsa fqiu ynë Greqia mësimit-besimit fetar e llogarit si lëndë obligative në të gjitha shkollat për nxënësit ortodoks dhe atë duke filluar nga klasa e tretë e shkollës fillore. Grupin e dytë të shteteve të cilat nëpër shkolla shtetërore e njohin sistemin që nxënësi do të ketë të obliguar o lëndën e mësimit-besimit fetar o një lëndë tjetër alternative, siç ishte e paraparë te ne në Maqedoni, apo siç njihet në Gjermani lënda etikë apo moral si lëndë alternative. Mirëpo në këtë shtet demokratik ku laiciteti i shtetit nuk rrezikohet edhe pse organizohet mësimit-besimit fetar nëpër shkolla jo vetëm për të krishterët por edhe për nxënësit myslimanë. Në Belgjikë mësimit-besimit fetar që nga viti 1959 është stimuluar edhe në Kushtetutën e këtij shteti ku lënda e mësimit-besimit apo etikës parashihet si lëndë obligative.

Në shtetet e ish bashkësisë të shtetit të quajtur Jugosllavi si: Bosnja dhe Hercegovina në fillim lënda e mësimit-besimit fetar ka qenë fakultative. Me organizimin kantonal të këtij shteti, disa kantone këtë lëndë e bënë të obliguar e disa si Kantoni i Sarajevës kjo lëndë organizohet si lëndë obligativo-alternative me tendencë që asaj me kalimin e kohës po vërehet se i vihet aksenti më shumë si lëndë e historisë së religjioneve. Grupi i tretë i tipave të shteteve llogariten ato shtete ku lënda e mësimit-besimit është lëndë zgjedhore, si lëndë jo

obligative. Nga ish shtetet e Jugosllavisë si tip të këtilla mund të numërojmë Kroacinë e cila këtë e njeh për nxënësit në shkollat fillore, pastaj shtete e rajonit si Çekia, Bullgaria, Hungaria, etj. Për fat të keq në grupin e katër të shteteve që pas rrëzimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë të ligjit për zhvillimin e lëndës së mësimit-besimit nëpër shkolla publike shtetërore është njëra nga shtetet të cilat nuk njeh mundësinë e zhvillimit të lëndës së mësimit-besimit nëpër shkolla shtetërore. Shtetit tonë në këtë 'mohim të së drejtës elementare natyrore' të besimtarëve i bashkëngjitet Shqipëria dhe Sllovenia nga ish shtetet Jugosllave. Pjesërisht në këtë grup të shteteve me këtë tip numërohet edhe Franca. Themi pjesërisht ngase megjithatë në disa pjesë të territorit të sajë zhvillohet mësimit-besimi edhe nëpër shkolla shtetërore si në territorin e Alzasë.

Së fundi, gjersa R. Maqedonisë për këto shtatëmbëdhjetë vite të pavarësisë nga 'bashkësia e gjerë ateiste' Jugosllave ku nuk kishte mësimit-besimit nëpër shkolla publike, na del që me inkuadrimin e mësimit fetar rrezikohet koncepti teistik i shtetit e si duket me këtë veprim të gjykatës dëshirohet të mbrohet bindja ateiste se sa rreziku nga implikimi i fesë në shtet. Praktika gjer para një viti, gjegjësisht nga shtatori i vitit të kaluar kur filluan hoxhallarët dhe priftërinjtë të jenë pjesë e procesit të arsimit nëpër shkolla publike shtetërore, rënd që mund të arsyetohet se nuk ka qenë e drejtë dhe e ligjshme. Mohimi i një të drejte, a sidomos i një të drejte me anë të së cilës manifestohet njëra nga të drejtat themelore të njeriut siç është e drejta për liri fetare, nga ana e një shtetit demokratik siç mëton të paraqitet Maqedonia nuk do të mund të llogaritet veprim demokratik. Nëse prona (pasuria) e nacionalizuar në shtetin tonë Maqedoni me ligj u kërkuar që, një veprim i padrejtë i pushtetit të mëhershëm të përmirësohet, me anë të kthimit të saj pronarëve të tyre apo trashëgimtarëve legjitim u vlerësua i ligjshëm, a thua vallë një e drejtë jo materiale që padrejtësisht iu mohua për më se gjysmë shekulli, si e drejta e lirisë fetare të kultivohet në shkolla publike pse të mos ketë të njëjtën zgjidhje ligjore edhe sot. Të theksojmë se futja e mësimit-besimit nëpër shkolla nuk futet tash në mësimin publik por se ajo kthehet në sistemin ligjorë, me çka pra sërish riafirmohet një e drejtë e cila është marrë dhunshëm nga popullata.

Përmbyllim këtë shkrim me fjalën se Maqedonia ka kaluar një periudhë shumë të shkurtë si shtet i pavarur, e që për një afat shumë të shkurtër kohorë të ketë mundësi të krijon dhe të vë një praktikë të re historike dhe kulturore.

Njerëzimi i përma-lluar për dashuri

Shkruar nga Fethullah Gülen

Sot, si njerëzim, kemi rënë në një pozitë të tillë aq sa kemi harruar të sillemi si njerëz. Gjendemi tepër larg së shprehuri veçoritë tona në mesin e krijesave. Megjithë aftësitë tona të mrekullueshme që bën edhe engjëjt të na kenë zili, bëjmë vepra që turpërojnë edhe shpirtrat e ndyrë. Jetojmë çdo çast me mëri e urrejtje, turfullojmë me inat dhe e shikojmë njëri-tjetrin vetëm me ndjenja hakmarrjeje. Shpirtrat tanë janë të zbrazur nga dashuria, mjegulla e tymi i armiqësisë na ka mbrujtur të gjitha ndjenjat dhe prej vitesh jetojmë larg prej ndikimit të magjepsshëm të dashurisë. Mendjet tona s'reshtin së prodhuari ndjesi dashakeqe.

Të djegësh e të shkatërrosh çka përreth, të përngjasësh gjithçka me veten dhe të poshtërosh me dhunë atë që e konsiderojmë "tjetër", janë bërë situata të zakonshme. Pjesa jonë dërrmuese jetojmë nën diktatin e ndjenjave pavarësisht arsyes e logjikës. T'i shtypësh ata që s'mendojnë si ne e t'u mbyllësh gojë atyre, është prej cilësive tona më dalluese. Duke mos menduar asesi se mund të ketë shumë rrugëzgjdhje për shumë probleme, veprimje sipas asaj që dimë dhe në rrugën e ndërtimit, bëhemi shkas i sa e sa shkatërrimeve. Të hysh në zemrat e sho-shoqit dhe të shprehim vetët tona me gjuhën e shpirtit e me fjalë zemre, ka mbetur si një metodë e prapambetur demode...

DHUNË E EGËRSI

Jetojmë çdo çast me pështjelimin e të përballurit me shumë mendime antagoniste të prodhuara prej egoizmit tonë dhe të përfaqësuesve të tyre. Zemërohemi vazhdimisht, turfullojmë me urrejtje dhe po të kemi mundësi i hidhemi përsipër të tjerëve. Shtypim me këmbë ato që kemi mundësi t'i shtypim, e, me ata që s'na mjafton forca, luajmë me nderin e dinjitetin e tyre dhe po të kemi forcë e mundësi mediatike, i përplasim sa në një cep në tjetrin, duke i lënë në vuajtje më të këqija se vdekja.

Përpara gjithë këtyre situatave negative, ajo çka dëgjohet është ose ngërdheshja e tiranëve, ose rënkimi i të dhunuarve. Prej vitesh disa shtete shtypen e dhunohen vazhdimisht duke rënkuar të tërë si popull. Mendjet janë të shtangura, ndjenjat dhe emocionet të fikura, shumica është tëhuajësuar ndaj



vlerave të veta dhe gjithkush është bërë ujku i njëri-tjetrit. Mendimet dhe botëkuptimet ndryshe konsiderohen si mosmarrëveshje dhe përçarje në këto lloj shoqërisht, dalin në pah shfaqje të dhunshme të pamundura për t'u ndalur dhe njerëzit nxiten në luftë kundër njëri-tjetrit. Njëri i nxjerr syrin tjetrit dhe e vret; tjetri i drejtohet me bomba në trup ose me makina të ngarkuara me bombë. Kudo përjetohet tjetër dhunë e egërsi po aq sa edhe egërsia e tyre, ndoshta edhe më tepër.

Tek fëmijët s'ka mbetur asnjë gjurmë shpirti njerëzor.. janë shndërruar si mekanizma ndërjegjeje të paralizuar: Vullnetet janë vënë pas planeve kriminale; mendjet që konsiderohen si observatorë të njohjes së Zotit, u janë dorëzuar ndjenjave të liga; bota e ndjenjave që është burim i kulluar i dashurisë, është shndërruar në fole intrigash; zemra që si potencë është konsideruar si dritare e vështrimit të Zotit, është shndërruar në një skutë të pandriçuar dhe të gjitha sistemet njerëzore kanë rënë në një kurbet të pashteg, në kundërshti me qëllimin e ekzistencës.

Në fakt, në përsëritjen e historisë gjithmonë kemi përjetuar fenomene negative të ngjashme me këto, por shkatërrimet dhe ligësia, kësaj radhe qenë akoma më të veçanta dhe rrëqethëse, paksa të mbështetur edhe nga globalizimi i botës dhe teknologjia gjithmonë e në zhvillim. Tërë ditën e Zotit, tekta ndjekim ekranet e televizioneve dhe internetit, tekta shfletojmë gazetatat dhe revistat rrëqethemi me ankh dhe shpeshherë kthejmë fytyrën në

tjetër anë. Edhe nëse i mbyllim sytë e veshët, pa qenë në dorën tonë, disa ligësi që hyjnë në kokë na ngulen në gjoks si fuzhnjë, duke na hapur në zemër dhe shpirt plagë të pashërueshme. Nganjëherë i ndjemë përnjëherësh ligësitë e mbledhura parg, dridhemi së bashku me ata që dridhen në gjak e lot dhe rrënohemi bashkë me qytetërimet që janë rrënuar njësh me tokën. Kudo fryn sikur të ishte vjeshtë.. njerëzit janë tharë e rrëzuar si gjethe.. Siç thotë edhe Mehmet Akifi: "Qytetet rrënuar, shtetet përtokë, popujt pa krye/ urat të prishura, kanalet të shembura, rrugët pa udhëtarë / banesat të braktisura, fshatrat panjeri, çatitë të shembura / ditët nga munda privuar, mbrëmjet ide për të nesërmen s'kanë!.." Gjërat që na vërshojnë përbrenda kthehen në kuja dhe mjaftohemi duke rënkuar në pamundësi për të reaguar.

THIRRJA UNIVERSALE

Ndërkohë që gjithkush dhe gjithçka pret që t'i zgjatet një dorë; pret, por shemben përtokë me dëshpërim përballë indiferentizmit dhe pamundësisë sonë.. shemben përballë pandjeshmërisë dhe mosveprimit tonë duke mos gjetur përgjigje karshi britmave të tyre. Edhe pse pak, ka nga ata që i dëgjojnë e i ndjejnë këto, por dhe ata janë të pamund e të pafuqishëm.

Përballë gjithë këtyre situatave njeriu përfshihet nga zhgënjime dhe i vjen të thotë nga thellësia e zemrës se "Tashmë turmat do të kollofitin njëra-tjetrën, grupimet do të fërko-



Përderisa të gjithë jemi njerëz, do të thotë se në genet tona ekzistojnë genet e Ademit dhe në thelb kemi shpirtin e të Vërtetave Muhamedane; atëherë ejani, t'i ngremë krye të gjitha cytjeve djallëzore dhe të bërtasim me aq fuqi sa të tronditim botën se jemi mëkëmbësit e faqes së tokës

hen më egërsisht mes tyre.. askush s'do dojë askënd me zemër.. njerëzit s'do mendojnë për të tjerët.. askush s'do t'i zgjasë dorën e ndihmës nevojtarit.. askush s'do ledhatojë kokën e të shtypurit.. individët s'do t'i hapin zemrën njëri-tjetrit.. askush s'do ndihet i sigurt aty ku jeton.. fatin e botës do ta kenë në dorë njerëz që mendojnë vetëm për gjak.. që pështijnë gjak e që derdhin gjak.. dhe epoka do të shndërrohet edhe një herë në epokën e tiranëve.." Kjo gjendje s'mund të vazhdojë më kështu; vazhdimi i kësaj gjendjeje do të thotë vdekje për njerëzimin dhe vlerat njerëzore.


Ejani atëherë, në këto ditë ku udhët tona janë të ndara, t'i vëmë veshin thirrjeve universale hyjnore që jehon nga zëri i Junus Emreve dhe Mevlanave dhe të themi "dashuri" dhe "vëllazëri"! Ejani, t'ia tregojmë edhe njëherë botës me ngjyrën dhe dizenjon e saj veçantinë e të qenit njeri! Ejani, të themi edhe njëherë me gjithë sinqeritetin tonë dashuri dhe dialog në këto ditë ku urrejtjet, mëritë, inatet dhe mlllefet kanë nxirë faqen e botës. Ejani, ta zgjerojmë shpirtin sipas gjerësisë së mëshirës hyjnore dhe t'ia hapim zemrën çdokujt! Ejani, të heqim dorë së shikuari vetët tona si pika uji të destinuar për t'u tharë e për t'u zhdukur e të përzihemi me përrënjtë e të vrapojmë drejt së qenit oqean! Përderisa të gjithë jemi njerëz, do të thotë se në genet tona ekzistojnë genet e Ademit dhe në thelb kemi shpirtin e të Vërtetave Muhamedane; atëherë ejani, t'i ngremë krye të gjitha cytjeve djallëzore dhe të bërtasim me aq fuqi sa të tronditim botën se jemi mëkëmbësit e faqes së tokës, se jemi të denjë për të arritur majat e qiellit dhe t'ia bëjmë të ditur edhe njëherë engjëjve veçantinë e të qenit njeri! Ejani, t'i shndërrojme udhët ku ecim në një rrugënajë dhe t'i drejtohem Zotit duar e zemërbashkuar.

"Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen".

KËNAQËSIA DHE HIDHËRIMI I ZOTIT

Shaban TAIRI, viti i III-të;

Kjo temë është si kundër-përgjigje ndaj një pamflete e cila ka qenë në qarkullim një kohë, e shpërndarë nga disa ekstremistë, me titull "Disa gabime në besimin Islam" me të cilën zotërinjtë duan të sqarojnë besim të pastër, kurse vet bien në gabim. Sipas tyre, kishte qenë shirk të këndohet mevludi, me të cilën i kundërshtojnë 90% të dijetarëve. Problematikë tjetër është çështja e qëndrimit të Zotit mbi Arsh, me të cilën ata thonë se kush nuk e pranon "Qëndrimin" siç e kuptojnë ato, ka bërë shirk. Ata ajetet në të cilat thuhet se Zoti është mbi Arsh i komentojnë shkronjë për shkronjë, saqë thuan se Zoti është ulur mbi Arsh, si dhe sipas disave, Arshi ka formë, se Zoti zbret prej saj dhe kërcen në të, I pastër është Zoti nga kjo! Nëse themi se Zoti ka nevojë për Arsh, atëherë ku ishte ulur Zoti kur nuk ishte ende i krijuar Arshi?! Arshi duhet të jetë më i madh se Zoti që Ai të ulët në të, e kjo është cilësi e cila nuk lejohet t'i përshkruhet Zotit. Zotin nuk e përfshin vendi dhe koha, këto janë dy vëllime me të cilët nuk mund të masim Zotin, Zoti ekziston pa vend dhe pa kohë, ashtu ka qenë para se ti krijoj vendin dhe kohën, dhe Ai ende ashtu është edhe pas krijimit të kohës dhe vendit, ende nuk ka as kohë e as vend. Nuk mund ta komentojmë shkronjë për shkronjë hadithin i cili thotë se "në pjesën e tretë të natës zbret Zoti në katin e parë të qiellit...", nëse e komentojmë kështu, atëherë si mund që në Maqedoni kur të jetë pjesa e tretë e naotës, Zoti është në katin e parë, por në vendet ku është ditë p.sh. në Amerikë, atje në cilin kat është Zoti?! Pra, nuk komentohet gjërat ashtu siç lexohen. Allahu xh.sh. nuk ka zbritje, Atij nuk i përket ndryshimi, sepse zbritja nga lartë poshtë nënkupton ndryshimin e pozitës, kjo për Allahun është e pa vlefshme, kurse hadithi komentohet duke thënë se zbritja e Allahut të madhëruar në hadith, absolutisht nuk ka të bëjë me zbritje çfarë njeriut mund t'i sillt nëpër kokë. Zbritja e Tij është jashtë çdo përngjasimi, e jo se Zoti transferohet prej një vendi në vendin tjetër, pasi një në kontradiktë me vetveten, nëse



themi se Ai transferohet, ne i përshkruajmë vend e Ai ndryshon gjendje, e kjo është larg Zotit.

Po ashtu, tradicionalistët ekstremist i cekin hadithet muteshabih (të dykuptimta) të cilat edhe vet nuk i kanë kuptuar, siç janë hadithet ku ceket të qeshurit e Zotit me personin i cili i fundit do të hyn në xhenet, mahnitja e Zotit, apo të habitet ku ka hadith ku thotë se Zoti është mahnit (habit) me një sahabij i cili mori te shtëpia e tij një musafir dhe kur filluan të hanë ai i fiku dritat që të ngopet mysafiri, për këtë të nesërmen i Dërguari a.s. i tha se mbrëmë Zoti është mahnit me sjelljen tënde mbrëmë! Këto hadithe nuk kuptohen kështu, është e pamundshme që Zoti të ndjejë dhembje dhe kënaqësi, ngase dhembja nënkupton ndryshimin e gjendjes apo disponimit nga e mira në të keq, ndërsa kënaqësia nënkupton po ashtu ndryshimin e gjendjes apo disponimit nga e mira

në të keqe. Ai që nuk mund të ketë natyrë trupore nuk mund të përjetojë një gjë të tillë. Sikur të ndjente kënaqësi do të duhej të kërkonte diçka me të cilën kënaqet dhe nëse mund të gjente një gjë të tillë, do të ishte i kënaqur përherë e nëse nuk mund të gjente një gjë të tillë, atëherë, përherë do të ishte i pikëlluar nga dhembjet, e kjo është absurde. Raziu thotë: "Kënaqësia dhe dhembja varen nga disponimi dhe një gjë të tillë e përjeton vetëm trupi, ngase është i dobët. Në raste të tilla nuk mohohet shkaku. Nëse kënaqësia është e përhershme do të duhej ta kishte gjetur gjësendin që e ka kënaqur, dhe nxitja për ta gjetur atë ka ekzistuar më parë. Gjetja e gjësendit para krijimit të tij është e pamundshme, e nëse gjësendi është i krijuar, atëherë duhet të jetë pjesë e krijesave".

Tusi ka thënë: "Kënaqësia dhe dhembja janë fryt i disponimit dhe nuk ka dyshim se nuk mund të aplikohen në Zotin e Madhëruar". Deklarata e Raziut se nëse kënaqësia është e përhershme, duhet të ketë gjetur gjësendin me të cilin kënaqet, nënkupton se nxitja e kënaqësisë ka ndikuar në gjetjen e gjësendit me të cilin kënaqet dhe kështu ky proces ripërtërihet varësisht nga nxitja e kënaqësisë, ose nxitja e krijimit është e përhershme por nuk ka fuqi krijimi përpos pas ekzistimit të gjësendit me të cilin kënaqet. Nëse vetë nxitësi është krijues, atëherë do të ndodhte e kundërta.

Do të cekim edhe në fjalë të vlefshme të Xhemaludin El Gaznevijut, i cili thotë: "Allahu xh.sh. nuk ka zbritje e as ngritje, nuk ka nevojë, nuk ka epsh, nuk flenë, nuk ka gëzim e as pikëllim, nuk ka kënaqësi e as hidhërim në kuptim të ndryshimit në Qenien e Tij, Ai nuk ka shpresë e as lakmi, nuk ka zili, as han e as pinë, për Të nuk ka qëndrim në këmbë e as ulje apo shtrirje, as ecje as vrapim, nuk qëndron në shpinë e as mbështetur, Ai nuk qesh as nuk buzëqesh, nuk ka të majtë e as të djathtë... sepse të gjitha këto janë prej simptomave të krijesave, ndërsa Ai është i përhershëm, i Pastër nga të gjitha të krijuarat dhe nga të ndryshuarit e Tij prej një gjendje në tjetrën". Hitabiju thotë: "Të qeshurit i cili

përmendet në hadithe është njoftim për kënaqësinë e Tij dhe rezultatit e mirë ndaj robit të Tij, dhe si e tillë është alegori e mirë". Edhe të qeshurit edhe të hidhëruarit të Zotit nuk janë sikur të qeshurit dhe të hidhëruarit e njeriut. Kur Allahu dëshiron apo hidhërohet, Ai edhe atëherë nuk ndryshon fare gjendjen në Qenien e Tij, sikur që ndryshon njeriu apo krijesat, sepse njeriu është trup dhe materie, e kënaqësia, hidhërimi, qeshja janë veti të materies, e jo të Zotit. Po ashtu edhe hadithi Kudsij ku thotë Allahu, "nëse robi më vjen duke ecur, Unë i shkoj duke vrapuar", kuptimi i tij është në kuptim të afërsisë, e jo të kuptohet me vrapimin e njerëzve në gara. Bejhakiu thotë: Afërsia e Allahut ndaj krijesave është në saje të afërsisë së tyre përmes zbatimit të obligimeve ndaj Tij. Kështu edhe perceptimi i shprehjes vrapim, lajmëron për përshpejtimin e pranimit të veprës e jo vrapimin fizik të Zotit".

Në ajetet dhe hadithet muteshabih, nuk duhet të lëshohet çdonjëri në komentim, pasi është një fushë e cila është shumë e rëndë si për nga ana e kuptimit, po ashtu edhe nga ana e shpjegimit, prandaj mos u jepet kah ajeteve muteshabih por të lexojmë ajetet konkrete ku Zoti thotë: Asgjë nuk i përngjan Atij". Për këto ajete, prof. Sejid Kutbi thotë: Me anë të kësaj metodologjie favorizuese për shfaqjen e domethënies abstrakte përmes binarëve të saj u zhvillua metodika kur'anore, derisa edhe në çështjet më të ndjeshme dhe më delikate të cilat kërkojnë zhveshje dhe pastrim të plotë nga çdo e metë, siç është rasti me ajetet muteshabih, ku rreth këtyre ajeteve u nxit dhe u ngjall një polemikë e rreptë, atëherë kur polemika u shndërrua në mjeshtri kurse fjala në mjet zburues...Këto ajete janë metodologji në Kuran për ilustrim, ashtu siç është edhe ilustrimi bazë kryesore në shprehjen Kur'anore".

Pra, kuptimin e këtyre ajeteve nuk e din askush përpos Allahut, as dijetarët nuk e dinë, e si do ta dinë disa injorantë të cilët nuk mund të dallojnë ajetin prej hadithi, ai ka arritur të komentojë këto tekste!!! Të lumët ne kush na kanë ardhur prej Arabie dhe "na japin mend".

Të adhurojmë Allahun siç meriton Ai

Artikullin tim të rradhës po e fillojmë me një ajet të nxjerrur nga Libri i qartë, ku Allahu xh.sh. thotë:

"Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet". (Nisa, 36)

Një ajet i vetëm nga Kur'ani dhe ti ke mundësi ta reformosh individin, familjen, shoqërimin madje edhe tërë botën. Adhurimi (robëria) përcakton që njeriu të mos veprojë asgjë përveç se me lejen e zotërit të tij, të mos dal prej shtëpisë pa lejen e tij, të mos shkoje në tregje pa lejen e tij, të mos bëjë këtë e atë, ndërsa ti, bazuar në këtë, a mendon se je rob i Allahut?

O Allahu ynë! Na e bën të mundur realizimin e pozitës së adhurimit!

Shokët e Pejgamberit, a.s me këtë adhurim dhe me bereqetin e besimit, shoqërimin dhe dashurisë së tyre për Muhammedin, a.s, arritën me lejen e Allahut xh.sh të bëhen zotërinj të botes.

Shiko në veten tende: A je rob i Allahut apo rob i djallit? Nëse je rob i Allahut, dije se Zotëriu merr përsipër gjërat e robit të vet, qofshin rroba, ushqim, pije, banim apo çka do tjetër. Nëse dikush i bën padrejtësi, zotëriu mbron robin e vet. Ndodhë që të jesh rob i Allahut por krahas Tij adhuron edhe ndonjë "zot" tjetër. Thotë Allahu:

"A e ke parë ti atë, që për zot e çmon epshin e vet". (Furkan, 43)

Nëse je rob i Allahut dhe je hidhëruar, dije se e ke obligim të bësh ashtu siç Allahu të ka mësuar: "dhe që e frenojnë mllëfin". (Ali Imran, 134) Ndoshta e fsheh në veten hidhërimin dhe vendos diç të keqe por: "që ua falin (të keqen) njerëzve". (Ali Imran, 134), dhe së fundi: "e All-llahu i do bamirësit". (Ali Imran, 134)

TAKIMI ME ALLAHUN

Kur'anin "Atë nuk e prek kush, vetëm të pastrit". (Vakia, 79)

Kur'anin e prekin ata që kanë pastruar zemrat e tyre nga errësira e neglizhencës ndaj Allahut të Madhëruar, nga errësira e mëkateve, kështu që si rezultat zemrat e tyre rreshtohen drejtë në rrugën e Allahut, asnjëri prej tyre nuk hidhërohet përveç se për Allahun, nuk

do askënd përveçse për Allahun, del nga shtëpia për ta kërkuar kënaqësinë e Allahut, dhe këtë gjatë tërë jetës se tij e praktikon.

Kur t'i vie posta këtij besimtari prej qiellit se ai duhet ta lëshojë këtë botë në këtë ditë dhe këtë orë, ai nuk do të mërzhitet fare dhe nuk do të bezdiset aspak. Për të kjo dalje është shumë e dëshiruar dhe e ëmbël ngase Allahu i Madhëruar thotë:

"E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni". (Fussilet, 30)

Sa çast i ëmbël është ky! Derisa je ne agonitë e vdekjes të vijnë melaiket që të sigurojnë për atë që të pret pas vdekjes, që të mos pikëlloshesh për këta, prej të cilëve ndahesh ngase ajo që të pret është më e mirë, "keni myzhdë xhennetin që u premtohej". (Fussilet, 30),

"(u thonë) Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, kudo që të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkon. Pritje e nderuar prej Atij që falë mëkatet dhe që është mëshirues! E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llaut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve?". (Fussilet, 31-33)

Jeta dhe mendimi i tij përherë janë në shërbim të fesë së Allahut.

Jeta nuk mbetet, rinia nuk vazhdon, pasuria harxhohet. A e merr këtë pasuri me vete?! Edhe nëse e merr në varrë, a mund t'i japësh mito Munkirit dhe Nekirit?

Këto janë fjalë Kur'anore, janë këshilla prej Allahut të Madhëruar, i Cili është më i Mëshirshëm për ju sesa nëna për fëmijun, përveç të cilit nuk ka tjetër. Apo më i mëshirshëm se nëna dhe babai për fëmijën. Imagjoni se sa shumë e duan prindërit këtë fëmijë, e pastaj mëso se Allahu të do edhe më shumë, Allahu është edhe më i Mëshirshëm për ty se sa këta prindër me këtë fëmijë edhe më tepër se kjo.

E lusim Allahun që të na bekoje, që Ai i do dhe të na bëjë prej atyre që kuptojnë Kur'anin:

"Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre". (Zumer, 18)

SINQERITETI ME ALLAHUN

"Dhe ngutuni (me punë që meritonin) në falje mëkatesh nga Zoti juaj". (Ali Imran, 133)

Shpejtoni në vepra të mira, shpejtoni në pendim të sinqertë që t'iu

falen mëkatet ngase: "Nuk ka dyshim se Unë e falë atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqëndrohet për në rrugën e drejtë". (Taha, 82),

"e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve)". (A'raf, 156)

Mëshira e Allahut nuk është e lire, falja e Tij nuk vjen pa e kërkuar, edhe pse mirësia dhe fisnikëria e Tij është e pafund. E mbjell një kokërr gruri në tokë mbijnë shtatë kallinj, ku secili ka nga 100 kokrra. Mbijell një pipth ndërsa prej tij behet një peme e madhe. Kjo është dhunti e Allahut dhe kjo është si rezultat i sinqeritetit me Allahun.

Tregohet se një njeri bëhej gati për të shkuar në xhami për ta falur namazin javor, namazin e xhumasë, por koha ishte e ftohtë dhe në shtëpi nuk kishte buke. Ai duhej ta sillte nga mulliri drithin e bluar. Mendo në vete: A të shkoj në xhami apo ta sjell atë? Ai zgjodhi kënaqësinë e Allahut dhe shkoi në xhami. Pak para se të shkonte gruaja e kapi për dore dhe i tha: Si po shkon kur fëmijët janë te uritur dhe në shtëpi nuk kemi aspak miell? Mos ke dert, Allahu i mbikëqyre ata! - iu përgjigj njeriu. Me duhet patjetër ta fali namazin e xhumasë- u arsyetua njeriu.

Nuk do ta hapi derën kur te kthehesh - iu kërcënua gruaja.

Pasi që e kreu namazin u kthye në shtëpi, trokiti në derë, gruaja shpejt e shpejt ia hapi derën dhe i dëshiroi mirëseardhje.

Hajr inshaAllah! Çfarë ka ndodhur?!

Kur shkove në xhami, fqiu ynë shkoi të bluante, gabimisht ka sjellur edhe të bluarit miellin tonë - iu përgjigj e gëzuar gruaja.

MUSLIMANËT DJE DHE SOT

Muslimanët sot janë vërtet në gjendje të vështirë. Po të ishe p.sh. në Irak dhe të është shkatërruar shtëpia, të janë mbytur fëmijët, ke humbur gruan dhe pasurinë, ke mbetur pa kulm mbi koke, çfarë do të bëjë?

Po kështu edhe vëllezërit tanë në Palestinë. Neve duhet të pendo kemi tek Allahu sinqerisht, të kryejmë obligimet tona, të punojmë në drejtim të përmirësimit të vetes, fëmijëve dhe grave tona. Fqiu me fqiu, shoku me shokë, në mënyrë që të marrin titullin e doktoratës hyjnore, e cila është: Adhurimi për All-llahun!

Çfarë kanë qenë arabët para ardhjes së Muhammedit a.s?

Muhammedi, a.s , i shkolluar në shkollën hyjnore, në ambientet e shpellës Hira, larg njerëzve, morri planin dhe hartën e rrugës për udhëzimin e njerëzve saqë kurejshët pabesimtarë thonin se: "Muhammedi ka renë në dashuri me Zotin e vet". Po, nëse ti e do Allahun do të jesh i dashur tek Allahu, e si rezultat do të jesh i përmendur në qiej dhe gjithsesi i përkrahur prej Allahut...

Shokët e Pejgamberit, a.s përjetuan maltretime e provokime të shumta por duruan dhe si rezultat, Allahu i shumoi pasi që më pare ishin pak, Allahu i bëri krenar pasi që më parë ishin të shtypur, Allahu i pasuroi pasi që më parë ishin të varfër. Ata ishin barinj para rilindjes së tyre për ta mbushur rruzullin tokësor me qytetërim.

Ndërsa tani çka? Cila është gjendja muslimanëve sot!!!

Allahu thotë për çifutët:

"Atyre (jehudive) u është vënë njollë e nënçmimit kudo që të gjenden,andaj atyre u është shtruar shtypja e mjerimi...". (Ali Imran, 112),

...por ata kanë hequr rrobën e vet të nënçmimit dhe ua kanë veshur muslimanëve në Palestinë. Të gjithë me dëgjojmë e shohim lajmet për "të bëmat" e çifutëve në muslimanë. Kjo është turp për muslimanët në lindje e perëndim.

DOMOSDOSHMERIA PËR THIRRJE NË RRUGËN E ALLAHUT

Dijetaret e kanë obligim që të thërrasin në këtë fe, çdo musliman duhet të urdhëroje për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, dhe te vërtetën e thotë Allahu:

"O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) All-llahun, Ai ju ndihmon juve". (Muhammed, 7)

Çdo njeri prej nesh duhet të ndihet përgjegjës mbrenda kufijve për të cilët kemi mundësi t'i kontrollojmë dhe patjetër duhet të pendo kemi sinqerisht që të gjithë...

Kur mbreti të tubohet me mbretër duhet të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, tregtari me tregtarin, dhe kështu, nëse ne këshillojmë për të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, zbatojmë urdhrat e Allahut në çdo vend dhe me çdo njeri dhe ne përputhje me hartën e Allahut, atëherë Allahu do të jetë me ne siç thotë:

"Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shprehëllim)". (Bekare, 152).

Kuptimi i hadithit që flet për mangesitë e femrës

Semi AJETI viti-III-të

"Hadithi ka për qëllim natyrshëmërinë e gruas të cilën e mbizotërojnë emocionet, kjo nga shkak se i janë ngarkuar disa funksione dhe detyra të ndjeshme, si shtatzania, gjdhënia, rritja, edukimi të cilat nuk kryhen me anë të mendjes por me anë të emocioneve".

Besoj se duke folur rreth një teme të tillë, do të përpiqemi të kurojmë praktikisht një problem tejet të rëndësishëm. Kjo temë mbi të cilën do të flasim, përbën një nga sfidat e shumta me të cilat ballafaqohet gruaja në shoqëritë muslimane. Çdo banorit të perëndimit i është mbjellur në mendje se Islami është shumë përbuzës dhe tiran ndaj gruas. Fatkeqësisht edhe disa muslimanë fanatik kanë rënë në teoritë e perëndimorëve të cilët gruan e konsiderojnë si person i dorës së dytë, duke u arsyetuar se përkrahës i ideve të tyre është Islami.

Ata idetë e tyre i argumentojnë me hadithin e Pejgamberit a.s.:" Gratë janë me mendje dhe besim të mangët"

Hadithi është i vërtetë, mirëpo nëse e marrim pa e analizuar mirë e mirë atëherë do të gabojmë pasi që në Islam si mashkulli ashtu edhe femra janë pjesëtarë dhe anëtarë të sojit njerëzor dhe Kur`ani pandryshueshëm i quan ata ndihmëtarë e shoqërues të njëri-tjetrit. Si të tillë pra të dytë së bashku si qenie njerëzore, burrat dhe gratë janë të barabartë në kamjen e të drejtave dhe obligimeve të njëjta. Sikur të ishte ashtu siç disa të "mençur" e kuptojnë hadithin atëherë padyshim se All-llahu xh.sh do ta dallonte femrën nga mashkulli në shumë sfera, pasi që nuk mund të jetë i njëjtë si i mençuri i marri.

Mirëpo All-llahu xh.sh thotë: "Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyës, i urtë." (Teube, 71) Pra obligime të njëjta si për mashkullin ashtu edhe për femrën.

Pastaj femra është e obliguar me detyrën më të shenjtë, rritjen dhe edukimin e fëmijëve prandaj ajo do duhej që këtë detyrë ta kryejë me përpikshmëri. Vallë sikur të



jetë ashtu siç thotë hadithi, Zoti do ta kishte obliguar femrën me këtë obligim i cili kërkon një aftësi të madhe?

KUPTIMI I HADITHIT

Vërtetë që në hadithet e Pejgamberit a.s fshihen urtësi të shumta, mirëpo jo çdo njeri mund ti kuptojë. I këtuillë është edhe hadithi i lartpërmendur ku Pejgamberi a.s thotë: "Gratë janë me mendje dhe besim të mangët" Ky hadith është i vërtetë dhe transmetohet edhe nga Buhariu edhe nga Muslimi.

Mirëpo mënyra se si është kuptuar ky hadith është gabim, pasi që ky hadith nuk ka për qëllim dobësin e femrës dhe injorimin e saj, por ky hadith na tregon natyrshëmërinë e gruas nga ana e krijimit. Gruaja nga natyra e saj është krijuar që e mbizotërojnë emocionet, kjo nga shkak se Zoti i ka ngarkuar gruas funksione dhe detyra të ndjeshme, si shtatzania, gjdhënia, rritja dhe edukimi i fëmijëve, funksione të cilat nuk kryhen me anë të mendjes por me anë të

emocioneve.

Psilkologu Dr. Fredrik Kohin thotë: "Femra ruan disa karakteristika të fëmijës jo vetëm në trupin e saj, por edhe në natyrën dhe psikikën e saj. Sikur të ndryshonte në shumë aspekte nga fëmija, ajo nuk do të mund të ishte nënë e mirë. Falë ndjenjave të saj fëmijërore, ajo kupton kërkesat e fëmijës, përderisa burri është larg logjikës dhe ambientit të fëmijës për shkak të avancimit të tij mendor. Kurse ajo "mbetet" si fëmija dhe e kupton atë më mirë se burri. Ndjenjat e saja mbizotërojnë logjikën e saj dhe ato janë më të shprehura se sa aktiviteti i saj mendor, ngase ajo është e formuar më shumë të bartë se sa të imponojë, më shumë pranon të nënshtrohet se sa të sundojë. Syri i saj i kujdesit është në mes të burrit dhe fëmijës. Kështu ajo në familje është qendër për të ruajtur harmoninë në mes të anëtarëve të saj të cilët bartin dëshira të ndryshme."

GRATË NË DITURI

Përmes historisë islame,

shohim se gratë muslimane kanë marrë pjesë në ndërtimin e shkencave të ndryshme. Bile gratë muslimane ishin prezente edhe në shkencën më të rëndësishme, në transmetimin e haditheve. Dijetarët nuk kanë refuzuar asnjë hadith si jo korrekt për shkak se tranmetuesi ishte një grua, e padyshim se nëse hadithi i lartpërmendur do të ishte ashtu siç shihet në shikim të parë gruas nuk do të ju lejonte marrja me hadithin dhe transmetimin e tij. Pastaj nuk ka dijetarë që njihet se ka refuzuar një transmetim për shkak se tranmetuesi ishte një grua. Shumë vepra nga suneti u pranuan nga Ummeti musliman nga një grua e vetme nga sahabijet e Profetit. Asnjë nga dijetarët e sunetit nuk mund të mohojë këtë fakt.

Vetë Pejgamberi a.s për shumë çështje u konsultonte me gratë e veta, prej të cilave në të shumtën e rasteve gjente rrugëdalje. Shembull e kemi marrjen e këshillës nga Ummu Selemja në ngjarjen e Hudejbisë. Pasi Profeti a.s e kishte nënshkruar marrëveshjen e Hudejbisë, u kërkoi muslimanëve të thernin kurbanet dhe të rruajnë flokët e kokës, njëlloj sikur ta kishin kryer umren pasi që nuk u lejuan ta kryenin nga ana e mushrikëve. Edhe pse Pejgamberi a.s i urdhëroi, asnjë nga shokët e tij nuk u ngrit. Ishte hera e parë që diçka e tillë ndodhte. Pejgamberi a.s ua përsëriti urdhrin tre herë, por asnjëri nuk u ngrit. I zemëruar, Pejgamberi a.s hyri në çadrën e tij ku ndodhej Umu Seleme. Ai i tha: "Mjerë këta njerëz!" Umu Seleme i tha: "O i dërguar i Allahut! Këtë e kanë bërë nga dashuria që ndajnë për fenë. A të të jap një mendim më të mirë o i dërguar i Allahut?" Profeti a.s i tha: "Po o Umu Seleme." Umu Seleme i tha: "O i dërguar i Allahut! Nëse dëshiron që t'i rruajnë flokët, fillo ti i pari dhe rruaji flokët e tu dhe mos i fol askujt, qoftë dhe një fjalë!"

A është e logjikshme që një grua t'a këshillojë dhe orientojë Profetin a.s si të sillet? Pas kësaj a mund të thuhet se islami e ka diskriminuar dhe ia ka shkelur të drejtat gruas? Kur e dëgjoi sugjerimin e Umu Seleme, Profeti a.s i tha: "Më ke dhënë një këshillë të vyer o Umu Seleme."

Pra gruaja në Islam është e vlefshme dhe me dinjitet! E përfaqëson komplet shoqërinë, ngase është gjysma e saj dhe ndërtuesja e gjysmës së tjetër të shoqërisë.

Si na drejtohet djalli?!

O ju të cilët besuat, mos shkoni gjurmëve të djallit, pse kush ndjek gjurmët e djallit ai urdhëron për të shëmtuara e të irituara, e sikur të mos ishte mirësia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush prej jush nuk do të pastrohej kurrë (prej mëkateve), por All-llahu e pastron atë që do Ai. All-llahu dëgjon e di. (Nur: 21)

Anisa Tairi viti i III-të

Të kam parë dje se si i fillove punët e përditshme. U zgjove nga gjumi pa u ndalur për ti kryer lutjet dhe obligimet tjera ndaj Zotit tënd. Në fakt, ti as që u falënderove për ushqimet që i pate ditën e kaluar e as që u fale para se të biesh të flesh. Ti je aq mosnjohës, më pëlqen kjo tek ti. Nuk mund të të tregoj se sa jam i kënaqur që nuk e ke ndryshuar mënyrën e jetës tënde, o i marrë, ti je i imi.

Kujtoj, ti dhe unë vite me radhë jemi duke ecur së bashku, por unë ende s'të dua. Në të vërtetë unë të urrej, sepse unë nuk e dëgjoj urdhrin e Zotin. Ai më ka flakur jashtë Parajsës ndërsa unë do të të shfrytëzoj sa më gjatë që mundem që të marrë hakun nga Ai. O i marrë a je duke kuptuar ZOTI TY TË DO dhe Ai ka plane të gatshme dhe të mrekulueshme për ty. Por ti ma dorëzove jetën tënde dhe unë do të bëj jetën tënde një ferr të vërtetë. Në këtë mënyrë ne do të jemi së bashku dy herë. Kjo me të vërtetë do ta zemëroj Zotin. Dhe unë të falënderoj.

Të gjitha ato kohra të mira që së bashku i kemi kaluar. Filmata e fëlliqur, sharjet, ahengjet, vjedhjet, gënjeshtret, hipokrizia, kënaqja me kurvëri, ngrëniet e tepërta, barsoletat e turpshme, thash e themet dhe përgojimet, fjalët prapa shpine, mosrespektimet e të vjetërve, mosrespektimet daj xhamisë sjelljet e këqija, me siguri se nuk dëshiron të heqësh dorë nga këto. Hajde o i marrë, së bashku të digjemi përgjithmonë. I kam disa plane të nxehta për ne. Kjo është vetëm një letër mirënjohjeje nga unë për ty. Dëshiroj të të them "Faleminderit" që më lejove ta përdori veten tënde për një kohë të gjatë të jetës tënde të pamend.

Je aq symbyllur unë qeshem me ty. Pasi që e bën mëkatin, ia plasësh të qeshurës, e kjo më bën të sëmurem (E thënë me ironi). Mëkati ka filluar ta merr tarifën e saj nga jeta jote. Po dukesh 20 vjet, më i vjetër, e unë kam nevojë për gjak të ri. Tash shko përpara dhe mësoje ndonjë fëmijë se si duhet të mëkatoj.

E tëra që ti duhesh të bësh, janë: pirja e pijeve alkoolike, mashtrimi, bixhozi, thash e themet, amoraliteti etj.

Të gjitha këto praktikoi para fëmijëve, kështu që edhe ata të mësojnë. Fëmijët janë të tillë. Pra o i marrë tani për tani duhet të të lë të shkosh. Do të kthehem pas disa sekondash për të të joshur përsëri. Nëse do të ishe i mençur, do ikje dika, do ti pranoje mëkatet e tua, do ti kërkoje falje Atij, do të jetoje për Zotin, me atë pjesë të vogël të jetës që të ka mbe-tur. Karakteri im nuk më lejon që askënd ta këshilloj, por mosha jote dhe mëkatet që ende je duke i bërë, po bëhen paksa qesharake. Mos më keqkupto, unë ende të urrej...

Pra mbaje mend se një ditë do ta dëgjosh këtë:

"E pasi të kryhet çështja (të hyjnë ata të xhennetit dhe të xhenneminit në të, xhennemlinjve) djalli (u mban ligjëratën e shëmtuar), dhe u thotë: "Vërtet, All-llahu ju pat premtuar premtim të vërtetë, e unë ju pata premtuar dhe, qe, nuk e zbatova premtimin ndaj jush. Po unë nuk pata kurrrfarë pushteti ndaj jush (që t'ju detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m'u përgjigjet; atëherë pra mos më qortoni mua, po qortojeni veten. Unë nuk mund t'ju shpëtoj juve, e as ju nuk mund të më shpëtoni mua. Unë mohoj shoqërimin tuaj që ma bëtë mua më parë (më adhuruat në vend të Zotit)". S'ka dyshim, jobesimtarët kanë dënim të dhembshëm." (Ibrahim 22)

VESVESJA apo FIKSIMI



Mixhit Osmani viti i III-të

Janë dy terme të cilat kur i ndëgjon njeriu i rrënjëqethet e gjithë trupi. Andaj për këtë, fatëkeqsisht ne jemi në një periudhë ku përballohem me probleme të shumta të përditshme dhe të cilat janë radikale ku ato probleme pikë burimi e kanë vesvesen, të dyshuarit, fiksimin, mosbesimin në vete etj, dhe neve na vjen në ndihmë hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. "Vesvesja janë prej shejtanit". Vesvesja, mund të themi se është një ide të cilën njeriu e shpikë në sistemin e tij të logjikuarit. Shqetësimi, mund të pranohet deri në një shkallë normale ku pas saj qëndron vesvesja pra të dyshuarit në çdo gjë. Ndikimi i të dyshuarit fillon nga një pikë shumë e vogël dhe arrinë deri në atë shkallë sa që të pengon të mendojsh kah pozitivja mos më keqë të shtynë të mendojsh kah negativja. Me të paraqiturit e saj ajo zhvillohet dhe bëhet një ide e ngulitur në trurin e njeriut, e shqetëson atë me të përsëriturit e mendimeve negative dhe të fuqishme jep rezultate të vërshtira, ndryshe me thënë ajo është një smundje e cila nuk është organike por psikologjike.

Në çdo kulturë dhe civilizim i jepet rëndësi të madhe qëndrimit "të jemi të pastër dhe të jetojmë të pastër" njëherit kjo është edhe parim fetarë por deri në një shkallë, sepse nëse i jepet shumë, tepër rëndësi asaj ajo mund të vijë deri në një smundje dhe të ndikoj negativisht në jetën e njeriut. Sidomos këtë mund ta shohim tek gjinia femrore (ashtu siç pohojnë shkencetarët) se tek ata pastërtija e tepëruar, të jetuarit shumë preciz, kujdesshmëria e paskajshme dhe shumë aktivitete tjera që ndërlihen si këto, të cilëve nëse u kalohet kufiri japin smundje psikike. Normal se ne duhet të jemi të pastër, preciz, të kujdesshmë por deri në një shkallë e jo të shëndrohen në smundje.

Nëse parashtrrohet pyetja se ku është kufiri i saj? Përgjigjen mund ta gjejmë në këtë mënyrë: "Në sistemin nervorë ekziston një pjesë e cila e mbanë në harmoni të sistematizuar baraspeshën e atyre çështjeve se ne sa duhet apo nevojitemi të jemi preciz, të kujdesshmë etj. Kjo baraspeshë ndryshon prej personit person, tek dikush është më e zhvilluar tek të tjerët më pak e zhvilluar edhe ate duke e supozuar secili se "e imja është më e mirë". Sidomos kjo dukuri është e paraqitur (shtu siç e theksuam më lartë) tek gjinia femrore me një baraspeshë që përplasat me rezultate fatale qofshin ata

të shkallës pozitive ose negative.

Pas kësaj skene qëndron procesi i vazhdimtë të saj ku në logjikën e vet paraqiten ide dhe mendime të shumta, e cila është e vetëdijshme se ato ide janë të dëmshëm për psikologjinë e vet po përsëri nuk ka fuqi të anashkalon ata dhe ky proces quhet "fiksim". Në kulturën tonë kjo gjendja njihet me emrin "vesvese", dhe të thënitur e hadithit të Pejgamberit s.a.v.s. "vesvesja është prej shejtanit", tipik ky hadith ka të bëjë me ata persona të cilët janë në këtë gjendje dhe të cilëve u rekomandohen shërim sa më të shpejt ku shpëtim i vetëm për ta mbështetja në All-llahun xh.sh. të cilën e mbështesim në ajetin 159 të sures Ali Imran ku Allahu xh.sh. thotë: "...mbështetju Allahut se Allahu i donë ata që mbështetnë".

E kemi të patëjetërsueshëm ta themi se çdo fiksim nuk është smundje. Pra, ka fiksim pa të cilët nuk mund të jetohej me fjalë tjera ato janë motive për të jetuar por duhet të kemi kujdes se sot jeta është më dinamike se në të kaluarën dhe mund të kemi probleme familjare, me njeriun më të afërt, në shoqëri, në vendin e punës etj, duke mos arritë të zërthejmë ata një nga një, të gjitha këto probleme kur na fiksohen në kokë pa qëllim zërthimi atëherë ky fiksim do të na merrë kohën më të rëndësishëm në momentet e të logjikuarit dhe do të paraqiten probleme psikologjike.

Veçanrisht sipas zbulimeve të fundit shkencetarët kanë ardhë deri në një konkluzë të përbashkët për këto probleme se si paraqiten e ajo është: "Të prishurit e baraspeshës hormonale në sistemin nervorë dhe të humburit e vakumit të saj në trurë thonë se njihen si shkaqe amë për këto smundje".

Po prej nga rrjedhë "fiksimi"?

Fiksimi më shpesh ose ka mundësi më shpejt të paraqitet tek këta persona; tek ai i cili mbanë përgjegjësi të tepërta emocionale, i cili dyshon shpejtë, i cili është agresiv, i cili e mbanë të fshehtë çdo gjë pra nuk bisedon me të tjerët për shumë tema që i nevojiten atij, i cili mundohet të jetë "përsosur", i cili ka dëshirë të dinë të gjitha imtësitrat për të cilat nuk është i obliguar ai...etj.

Faktorët gjenetike dhe sociale janë dy shkaqet më të rëndësishëm për çdo smundje po ashtu edhe për "fiksimin". Andaj si konkluzë e fundit do të ishte se "çdo send që do ta bëjmë, ta bëjmë në masë të duhur e jo të tepëruar, se pas saj paraqiten probleme psikike" se nga ajo lindin dyshimet ku kurtha e saj është vesvesja apo fiksimi.

Qëllimi i Arsimit Islam

Sipas një thënieje të shumëpërhapur (e cila shpesh i njihet Profetit), "Dijetarët janë trashëguesit e profetëve." "Ulematë janë, fjalë për fjalë, "ata që kanë dituri" dhe ekzistojnë lloje të ndryshme 'ulemashë, në varësi të llojit të diturisë që kanë trashëguar nga profetët.

William C. Chittick

Nocionet e 'arsimit' janë të gdhendura në vlerat dhe qëllimet e shoqërisë moderne. Individët njerëzorë kuptohen sipas roleve të tyre shoqërore dhe qëllimet njerëzore përkufizohen në terma ideologjike. Me 'ideologji' nënkuptoj skema të përmirësimit të gjendjes njerëzore mbështetur në hamendjet e mendimit modern të zhvilluar në shekullin XVIII, pra periudhës së njohur si Iluminizëm.

Stili i ri i të menduarit që u shfaq gjatë Iluminizmit i kundërshtoi të gjitha nocionet tradicionale të së vërtetës, autoritetit, hierarkisë dhe natyrës njerëzore. Ai u shtroi terrenin sistemeve të ndryshme të vëna në jetë gjatë periudhës moderne, në përpjekje për ta trajtësuar shoqërinë sipas idealeve humaniste - si demokracia, socializmi e marksizmi, me të gjitha larmitë dhe degëzimet e tyre. Ndër më të spikaturat e këtyre janë lëvizjet moderne islamiste, që janë një lloj sikurse sistemet e tjera ideologjike në orvatjen për të imponuar një sistem abstrakt, të bërë nga njeriu, mbi shoqërinë.

Çdo ideologji fillon me presupozime të caktuara mbi natyrën njerëzore, të cilat nuk bashkëndahen nga mendimi paramodern. Qeniet njerëzore kuptohen në

terma të gjetjeve të shkencës moderne, të cilat përjashtojnë de jure, çdo mundësi transhendence, çdo nocion profetësie e shpalljeje dhe çfarëdo konsiderate serioze të jetës së përjetshme. Duke lexuar Iluminizmin në terma islamë, mund të themi se ai përbën një stil të ri mendimi, të mbështetur në kundërshtimin e tre parimeve themelore të mendimit islam. Këto janë Uniteti Hyjnor nubuwwe) dhe Kthimi te Zoti la ilahe il-la'Llah ("nuk ka zot përveçse Zoti"). Kjo formulë është rrokur gjithmonë se nënkupton që e tërë ekzistenca vjen nga Zoti, se i gjithë realiteti mbahet vazhdimisht nga Zoti dhe se të gjitha gjërat përfundimisht kthehen te Zoti. Çdo cilësi pozitive e ndeshur në botë dhe në vetet tona mund të jetë veçse pasqyrim i zbehtë i cilësive të Zotit. Vetëm Zoti është vërtetësisht i mirë, vetëm Zoti është vërtetësisht i bukur, vetëm Zoti është vërtetësisht i fuqishëm, vetëm Zoti është vërtetësisht i pavarur e kështu me radhë në listën e emrave hyjnorë. Shkurt, teuhidi nënkupton se nuk ka asgjë vërtetësisht reale përveçse Zoti.

Fatihaja fillon me pohimin, "Falënderimi i takon Zotit", çka përbën thjesht një pohim të teuhidit: ai do të thotë se askush nuk është i denjë për lavdërime përveç Zotit, sepse nuk ka asgjë vërtetë-

sisht të mirë veç Zotit. Po kështu, teuhidi shprehet edhe në pohimin "Vetëm Ty të shërbejmë, dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë." Nuk ka zot përveçse Zoti, ndaj nuk ka asnjë të denjë për t'i shërbyer dhe asnjë që mund të sigurojë ndihmë të vërtetë veçse Zoti. Vini re se kjo fjali mbahet zakonisht si vendosëse e një ideali: muslimanët. Kjo do të thotë se Zoti udhëzon duke nisur profetë, dhe funksioni i tyre është t'i udhëzojë njerëzit në Rrugën e Drejtë, e cila shpie në lumturi të përjetshme.

Parimi i tretë i mendimit islam është Rikthimi te Zoti. Atë e nënkupton vetë nocioni i Rrugës së Drejtë, es-sir?t. Ata që arrijnë ta kalojnë Urën pa rrëshqitur në Zjarr janë ata që kanë marrë udhëzimin në Rrugën e Drejtë në këtë jetë. Ata që dështojnë s'e kaluar Urën janë ata që nuk e kanë ndjekur Rrugën e Drejtë - në vend të kësaj, siç thotë Fatihaja, ata janë mes atyre që janë shmangur ose atyre ndaj të cilëve Zoti është zemëruar.

ULEMATË

Siç e thashë më lart, fjala "arsim" do të thotë më udhërrëfye. Në latinisht, (nisj?n) dhe "pavëmendshmëri" nxjerrë prej saj - njeriu duhet (h?d?).(ulem?). Sipas një thënieje të shumëpërhapur (e cila

shpesh i njihet Profetit), "Dijetarët janë trashëguesit e profetëve." "Ulematë janë, fjalë për fjalë, "ata që kanë dituri" dhe ekzistojnë lloje të ndryshme 'ulemashë, në varësi të llojit të diturisë që kanë trashëguar nga profetët. Ka tre sfera themelore të diturisë, çdonjëra nga të cilat pëfshihet nga Kur'ani dhe trupëzohet te Profeti. Trashëguesi ideal i Profetit do t'i ketë aktualizuar të trija llojet e diturisë, por shumica e 'ulemave në të vërtetë kufizohen mjaft në dijen e tyre. Sigurisht, asnjë nga 'ulematë nuk mund të jetë udhëzues aq i plotë sa vetë Profeti. Tri llojet bazë të diturisë islame që duhen trupëzuar idealisht nga 'ulematë janë dija e të vepruarit të duhur, dija e Realitetit të Vërtetë dhe dija e përsosmërisë shpirtërore. "Dija e të vepruarit të drejtë" është lëmi i Sher?'atit dhe jurisprudencës. "Dija e Realitetit të Vërtetë" është lëmi i atyre 'ulem?ve që studiojnë kel?min, sufizmin teorik dhe/ose filosofinë. Këta dijetarë shpjegojnë mësimet kur'anore mbi realitetin e Zotit, natyrën e kozmosit, dhe bërjen e vetes njerëzore. Me fjalë të tjera, ky grup i dytë i 'ulem?ve studion metafizikën, teologjinë, kozmologjinë dhe psikologjinë e përshtirshme. Sfera e tretë, "dija e përsosjes shpirtërore" trajton mënyrën e shndërrimit të brend-



shëm dhe përputhjen me normat e vendosura nga Zoti, jo vetëm në të vepruar e të menduar, por edhe në qenien tonë të brendshme. Ky lëm është specialiteti i mjeshtrave sufi.

REALITETI OBJEKTIV

Thashë se arsimit modern është i papërputhshëm me arsimin tradicional musliman. Me arsimin tradicional musliman nënkuptoj "udhëzimin në Rrugën e Drejtë", e cila shpie në të vepruarit e duhur, të kuptuarit e drejtë dhe shndërrimin e duhur të vetes. Me të pikasur që arsimit islam fokusohet në arritjen e përsosmërisë njerëzore sipas normave Hyjnore - e jo normave humaniste të Iluminizmit - mund të kuptojmë lehtë përsë arsimi modern shkatërron bazat mbi të cilat mund të ndërtohet arsimi islam. Më lejoni të tregoj disa pika, ku shfaqet konflikti ndërmjet arsimit islam e atij modern, sidomos në lidhje me parimin themelor të mendimit Islam, teuhidit.

Arsimi modern pretendon se bazohet në "shkencë" dhe e merr autoritetin e vet duke qenë "shkencor". Mendimi shkencor karakterizohet nga fokusi i tij mbi shumësinë dhe studimin empirik të sferës së kapshme nga shqisat, qoftë nëse këto e arrijnë futjen në atë sferë drejtpërsëdrejti apo me anë të instrumenteve. Mendimi shkencor hedh poshtë, në mënyrë implicite ose edhe eksplicite, çdo lloj dijeje që nuk verifikohet dot empirikisht. Ky lloj qasjeje është i dobishëm për të fituar kontroll mbi mjedisin e njerëzit, siç është fare e qartë te mënyra në të cilën ajo përdoret nga qeveritë, ushtria dhe industria. Mirëpo, me të pretenduar se dija shkencore është dituria e vetme e vlefshme dhe e ligjshme, nuk mund të bëhet më fjalë për shkencë, po për "shkencizëm", besimin se vetëm shkenca lejon qasje tek e vërteta. Shkencëtarët janë zakonisht tepër të sofistikuar për të besuar në shkencizëm, sepse ata e kuptojnë se shkencizmi është një qëndrim ideologjik, i cili nuk mund të demonstron empirikisht.

Prapëseprapë, shkencizmi është një përbërës i fuqishëm i botëkuptimit modern. Shumica e njerëzve besojnë në pretendimet për të vërtetën që bën shkenca, më shumë sesa besojnë në pohimet për të vërtetën që bën feja. Ata besojnë se shkenca merret me dijen dhe realitetin objektiv dhe pandehin se feja merret thjesht me sferën subjektive të opinionëve dhe ndjenjave. Besimi në shkencë është thellësisht i papërputhshëm me qasjen e diturisë islame. Në terma islame, e vetmja dituri e vërtetë, e vetma dije absolute dhe e vërtetësisht është teuhidi, fakti se nuk ka asgjë reale përveç Realitetit. Kjo është njohur gjithmonë si e

vërtetë, si fakt e jo si besim. Ajo është "besim" vetëm për njerëzit e thjeshtë, të cilët e pranojnë mbi bazën e autoritetit, por nuk e kuptojnë se çfarë do të thotë. Për çdo person me intelekt të shëndoshë teuhidi. Botëkuptimi islam nisi duke pohuar realitetin e Zotit, Unitetin e Realit të përfundëm, rrënjëzimin e gjithçkaje te Zoti. Kjo nënkuptonte se të kuptuarit e drejtë të gjërave varej nga të kuptuarit e tyre në raport me Zotin - Realitetin e Përfundëm.tekth?r. Teuhidi buron nga fjala Tekh?r buron nga fjala

Shkurt, teuhidi është një vizion që duhet arritur nga çdo qenie njerëzore. Ai përbën detyrën e individëve. Rruga për të arritur atë quhet Udhë e Drejtë. Ata që i çojnë njerëzit në Udhë të drejtë janë parasëgjithash Zoti, pastaj profetët, pastaj trashëguesit e profetëve. Megjithatë, nuk mundemi thjesht të ndjekim mësuesit. Ajo që kupton mësuesi juaj nuk ju ndihmon, përveç nëse e kuptoni edhe ju. Është përgjegjësia e çdo muslimani që të kërkojë dijen e tij dhe të kuptuarit e tij vetjak. "Kërkimi i diturisë është i detyrueshëm për çdo musliman e muslimane" ka thënë Profeti. Dhe ky kërkim zgjat "nga djepi gjer në varr" na tregon ai gjithashtu. Pa ngulmimin për të kuptuar, njerëzit do të mbeten injorantë e harrues, pavarësisht se sa mund të kenë zotëruar shkencën dhe inxhenjerinë, filosofinë dhe sociologjinë, ose cilëndo disiplinë tjetër të rrënjëzuar në tekth?rtekh?ku, që dtth realizimi dhe verifikimi.

Fjala hakk, një emër kur'anor i Zotit, që do të thotë, i vërtetë, real, i duhur, i denjë. Rrjedhimi i këtij emri hyjnor është se vetëm Zoti është e vërteta, realiteti, e drejta dhe e duhura. Mirëpo, Kur'ani na thotë se Zoti krijoi gjithçka me hakk 'alejna, "e drejta mbi ne") njerëzore është që të veprohet ndaj gjithçkaje në përputhje me të vërtetën dhe drejtësishtëmërinë e saj.

Sipas një hadithi të famshëm, Zoti ka një përgjegjësi e parë njerëzore. Hadithi vazhdon e thotë që, nëse njerëzit e përbushin këtë përgjegjësi, është e drejta e tyre ndaj Zotit që t'u jepet lumturi e përjetshme. Me fjalë të tjera, është Tehk?k do të thotë të njohësh hakkun e gjërave dhe të veprosh në përputhje me të. Haku i parë që duhet njohur është ai i Zotit, sepse nuk ka tehk?k do të thotë të jetosh në përputhje me hakkun e Zotit. Fryti i kësaj është shpëtimi. Mënyra e arritjes së tehk?kut parashtruhet nga profetët, specifikisht në Rrugën e Drejtë. E drejta e Zotit ndaj nesh - që të pohojmë Unitetin e Tij - shtron themelet e të gjitha të drejtave të njerëzimit dhe krijimit, sepse Zoti i ka dhënë gjithçkaje hakkun e saj dhe ka sig-

uaruar udhërrëfimin se si të respektohen këto hakke. Kjo do të thotë që e drejta e Zotit ndaj nesh është themeli i të gjitha përgjegjësiëve tona njerëzore.

Nëse ka ndonjë mendim depërtues të traditës muslimane pas teuhidit, ky është se askush nuk mund ta ndjekë Rrugën e Drejtë për ty. Çdo individ thirret të futet vetë në Rrugën e Drejtë, dhe secili do të mbahet përgjegjës për përpjekjet e veta. Kur'ani e thekson këtë pohim në pesë ajete të ndryshme: {Askush nuk bart barrën e një tjetri} (6:164, 17:15, 35:18, 39:7, 53:38). 'Ulematë kanë përgjegjësinë e ofrimit të çfarëdo dijeje që mund të kënë, të tjerëve, por njerëzit kanë përgjegjësinë e kërkimit të asaj diturie. Askush nuk mund të detyrohet të kërkojë të vërtetën dhe askush nuk mund të detyrohet që ta kuptojë atë. Kur'ani thotë Tekl?d do të thotë imitim dhe konsiderohet i përshatshëm vetëm në çështjet e praktikës. Për të qenë musliman i mirë, duhet ndjekur Sunneti dhe emuluar praktikën e Profetit, njohuria për të cilat duhet marrë nga juristët - ekspertët e Sheri'atit.

Mirëpo, teklidi nuk është me vend në teuhid. Nuk mund të thuhet "besoj në njëshmërinë e Zotit sepse mësuesi më ka thënë që duhet të besoj kështu." Ose, më mirë, fitra, mënyrën në të cilën janë krijuar njerëzit. Profetët erdhën me udhërrëfim, dhe udhërrëfimi fillon me "të përkuptuarit" (tedhkire). T'ua kujtosh njerëzve një gjë dtth t'u përmendësh diçka që tashmë e dinë, në mënyrë që ta sjellin ndër mend. Profetët erdhën për të zgjuar fitren njerëzore, për të larguar harresën që ua ka errësuar njerëzve të kuptuarit e teuhidit. Kjo dije është e lindur në çdo inteligjencë të shëndoshë, në çdo njeri. Mirëpo, për të rrokur atë që ajo nënkupton, njerëzve u nevojitet udhëzimi profetik - pra, u nevojitet 'arsimi/edukimi'.

Cilido arsimim i denjë për emrin 'islam' duhet të shpjerë në të kuptuarit e teuhidit dhe të zbatuarit e tij në praktikë. Përndryshe, nuk është udhëzimi, po keqduhëzimi (teklid është thjesht mësim papagalli. Pa dyshim, mbamendja e Kur'anit është meritë e lartë dhe ka shpërblime, por të memorizuarit nuk është një lloj me të kuptuarit. Tehk?ku ose realizimi dtth pikërisht të kuptosh vetë. Do të thotë të njohësh të vërtetën e të drejtën e diçkaje dhe të veprosh në përputhje me të vërtetën e të drejtën.

QËLLIMI I JETËS

Është karakteristike për kohët moderne që cilido diskutim për "arsimimin" sillt rreth nevojave të shteteve e shoqërive. Këto nevoja përkufizohen në terma të perëndive shumë të sundojnë botëkuptimin e tekth?rit. Këta

zota janë të mirënjohur për të gjithë, sepse përcaktojnë orientimin e shoqërive moderne dhe diskutohen vazhdimisht nga politikanët dhe ideologët. Njerëzit pandehin se këta zota janë zota të mirë, dhe nëse i adhurojnë zotat duke i kushtuar përpjekje arritjes së asaj që ata pretendojnë, do të jenë të lumtur. Adhurimi i këtyre zotave është pjesë e etosit modern dhe merret për i mirëqenë, tamam siç ishte teuhidi pjesë e etosit paramodern e merrej për i mirëqenë.

Në shumë kontekste sot, është e rrezikshme të flasësh kundër zotave të tekthirit, sepse adhuruesit e këtyre zotave janë fanatikë që zotërojnë pushtet të madh shoqëror e politik. Megjithatë, duhet të jemi realistë e të pranojmë emrat e zotave sundues të kohës sonë. S'ka ndonjë listë shteruese, sepse ka aq shumë zota. Por këta emra janë përfaqësues: liria, demokracia, shkenca, mjekësia, teknologjia, progresi, zhvillimi, barazia, arsimit.

Njerëzit kanë ardhur në këtë botë për një detyrë, dhe ky është qëllimi i tyre. Nëse nuk e kryejnë atë, nuk do kenë bërë asgjë. {Ne ua ofruam Amanetin qiejve dhe tokës e maleve, por ato refuzuan të merrnin përsipër dhe iu frikësuan; ndërsa njeriu e mori përsipër. S'ka dyshim se ai është treguar i padrejtë, i paditur} (Kur'an, 33:72).

{Ne ua ofruam Amanetin qiejve dhe tokës, por ato s'e pranuan...}. Qiejt, toka dhe malet i bëjnë të gjitha këto gjëra, por është një detyrë të cilën nuk e bëjnë dot. Kjo detyrë e vetme kryhet vetëm nga njeriu... Kur e kryejnë atë detyrë, "padrejtësia" dhe "padituria" do të asgjësohet prej tyre. Nëse thua: "Edhe nëse nuk e kryej atë detyrë, kryej shumë të tjera!" - ti s'je krijuar për ato të tjerat.

Është tamam si të marrësh një shpatë të paçmueshme çeliku indian, si ato që gjenden në thesaret e mbretërve, dhe ta bësh sakicë për mish të kalbur. Pastaj thua: "S'e lë këtë shpatë të rrijë kot, bëj aq shumë gjëra të dobishme me të!" Ose, merr një tas ari dhe gatuan hudhra në të. Kur me një grimcë të vetme të atij ari mund të blesh njëqind tasa! Ose e kthen një kamë të stolisur me xhevahirë, në varëse të pjeprimit të ndarë dhe thua: "Po e përdor mirë, po var pjeprin në të. S'po ia lë tehun të rrijë kot." Ku qëndron urtia e përdorimit të kamës që vlen njëqind dinarë në këtë mënyrë?

Zoti të ka dhënë vlerë të jashtëzakonshme. Ai thotë: {S'ka dyshim se Zoti ka blerë nga besimtarët vetet e tyre dhe pasuritë e tyre që të mund të kenë Parajsën} (9:111)... Mos e shit veten lirë - ti ke çmim tepër të lartë!

KONCEPTI I SUNNETIT NË EDUKIMIN E INDIVIDIT (2)



Nga M-r. Sc. Fahrudin Ebibi

4. KONCEPTI I PRIORITETEVE

Në ndërtimin e personalitetit të myslimanit prioritetet kapin vlerë strategjike në sunnetin e Muhamedit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem. Vlerat fisnike duhet të prodhojnë adhurime të sinqerta. Adhurimet kualitative duhet të ishin si pasojë e bindjes së shëndoshë ashtu që veprimet dhe sjelljet duhet të ishin të ngritura mbi bazën e parimeve që i nënshtrohen principit të prioriteteve. Sa i përket formimit jo në baza të këtilla, sipas sunnetit, është formim arbitrar, i përzier, i thyeshëm jo i ndërtuar mbi themele të qëndrueshme. Prandaj një formim i tillë gjithmonë është objektiv i shembjeve. Pikërisht këtu qëndron pika ndarëse dhe dallimi themelor në mes moralit sipas konceptit të filozofisë materialiste, strategjia dhe koncepti i të cilës është ndërtuar mbi bazën e interesit dhe të leverdisë. Ndërkaq koncepti i formimit të individit sipas sunnetit

para se gjithash mbështetet mbi bazën e besimit dhe bindjes. Kjo metodë është një shpjegim dhe interpretim praktik i kontestit të shpalljes kur'anore, të etapave dhe të horizonteve të tij.

Gjatë tërë periudhës mekase, periudhë kjo e cila ka zgjatur rreth 13 vite. Në mënyrë të vazhdueshme Kur'ani famëlartë është koncentruar në ndërtimin e çështjes së kredos (akides) në atë mënyrë që më pas të gjithë degët e tjera siç janë çështjet që i përkasin adhurimeve dhe udhëzimeve të jurisprudencës islamen të ishin të ngritura në bazë të parimeve solide, në bazë të themeleve parimore të ngulitura të akaidologjisë.

Gjatë ekzaminimit të ajeteve kur'anore që i takojnë natyrës obligative shifet qartë rradhitja solide dhe e vazhdueshme e tyre: "Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositen njëri-tjetritin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetritin të jenë të durueshëm." (Kur'an, 103: 1-3) "E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u

jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Ky është që me te u ushqyem edhe më parë". Ngase, u silltet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë." (Kur'an, 2:25). "Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim dhe robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të devotshmit." (Kur'an, 2:177) "Atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi falje për mëkate dhe shpërblim të madh. (Kur'an, 5:9)

Në këtë mënyrë ajetet e shumta kur'anore kanë bërë radhitjen e prioriteteve obliguese sipas serizitetit të tyre. Më pas do të vijoj sunneti pejgamberik për të interpretuar (shpjeguar) këto standarde përmes mënyrës së sjelljeve të tij

“

Në mënyrë të vazhdueshme Kur'ani famëlartë është koncentruar në ndërtimin e çështjes së kredos (akides) në atë mënyrë që më pas të gjithë degët e tjera siç janë çështjet që i përkasin adhurimeve dhe udhëzimeve të jurisprudencës islamen të ishin të ngritura në bazë të parimeve solide, në bazë të themeleve parimore të ngulitura të akaidologjisë

në planin e ndërtimit të individit. Në pyetjen drejtuar Muhamedit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem se cila do të ishte vepra më e mirë? "Dituria, përkatësisht, njohja e Allahut të madhërishëm", ishte përgjigjja e tij. Në një hadith të vetin i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem do të shprehë: "Jam i urdhëruar që njerëzit t'i luftoj deri sa ata të deklarohen se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Nëse ata deklarohen atëherë janë të mbrojtur nga unë, përkatësisht, kanë të siguruar nga unë gjaqet dhe pasuritë e tyre... Një deklaram i këtillë i Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem flet për një interpretim praktik të ajetit kur'anor: "S'ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh." (Kur'an, 4:48) Nga e gjithë kjo mund të nxirret përfundimi që procesi i formimit duhet të mos ishte vetëm formë, që nuk është i bazuar në bazamente ose e lidhur me etapa që i përkasin prioriteteve. Formimi i personalitetit po të ishte vetëm formë do të ishte në kundërshtim me vetë sunnetin e Pejgamberit të Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, përkatësisht, do të kishte destinacion të gabuar që në fillim të rrugës. Ashtu që pamjet deformuese dhe tmerruese të personalitetit të myslimanit bashkëkohor janë si pasojë e defekteve në zbatimin praktik të sunneteve në çështje parimore, të prioriteteve, që i përkasin fushës së ndërtimit të personalitetit.

Vazhdon...

DITURIA - NJË NGA MEKANIZMAT KRYESORË TË QYTETËRIMIT ISLAM

Behxhet Jashari

E vërtetë është se arsimimi është bazë e çdo qytetërimi e kulture. Proceset arsimore përbëjnë njëri nga çështjet më suptile të zhvillimit të këtyre dyjave. Historia tregoi se për ngritjen ose reformimin e një shoqërie është e nevojshme dituria, që nënkupton organizimin e arsimimit cilësor dhe vetëdijes intelektuale. Kultura e një populli matet edhe me atë se sa ata janë të arsimuar. Natyrisht, dijetarët janë ata të cilët e bartin fatin e shoqërisë mbi supet e tyre, që do të thotë se zhvillimi dhe ngritja arsimore e një populli varet drejtpërdrejtë edhe nga intelektualët.

Qytetërimi islam është i vetmi qytetërim që mbështetjen e vet e ka në bazat Hyjnore, pra në Librin e Fundit - Kur'anin dhe në praktikën Pejgamberike të Muhammedit a.s.

Vendet prej ku filloi qytetërimi islam ishin pothuajse krejtësisht të panjohura dhe jo aq interesante për botën e asaj kohe. Persia dhe Bizanti tanimë ishin në kulmin e qytetërimit të tyre. Grekët me shkollat e tyre filozofike po ashtu e kishin vërsuar njerëzimin me drejtimet e ndryshme filozofike, ndërsa Aleksandria njihet si njëra nga qendrat botërore të diturive dhe arsimimit.

Mekka dhe Medina, prej ku filloi përhapja e kulturës dhe qytetërimit islam, ishin dy vendbanime arabe që bota e atëhershme joarabe nuk tregoi ndonjë interes për to, sepse thjeshtë, atje nuk mbretëronte ndonjë drejtim filozofik, kulturë ose ndonjë renditje e përpiktë shoqërore, pasi që dihet se arabët merreshin pikërisht me dy çështje që tek ata ishin mjaft të zhvilluara: merreshin me poezinë dhe tregtinë...

MUHAMEDI A.S FIGURA MË E SHQUAR E NJERËZIMIT

Me ardhjen e islamit dhe Profetit Muhammed a.s. bota filloi të marrë kahje tjera. Njerëzimi filloi të njihet me një besim, kulturë dhe me një ideologji krejtësisht tjetër nga ato aktualet. Kur'ani bëri që mendjet e njerëzve të zhytur në

“Mësimet kur'anore dhe ato profetike të Muhammedit a.s. shpeshherë stimulonin besimtarët muslimanë që diturinë ta përhapin kudo që është e mundur. Historia tregoi se më pas, shumica nga shokët e Muhammedit a.s. u shndërrua në oazë të vërtetë të diturisë. Pra ata përbënin oazën e jetës kudo në shkretëtirat e errësirës, edhe atë duke pasur për synim përhapjen sa më efektive të diturive...”

errësirën e injorancës, të kthjellohen dhe të orientohen drejt proceseve dhe shtigjeve që do të shkaktojnë ngritjen e një qytetërimi të ri dhe fascinant. Gjithë kjo filloi në "zemrën" e qytetërimit njerëzor-Medine".

Islami është fe që ithtarët e saj i obligoi me dituri. Fenomeni i kësaj (lexo) dhe pasha lapsin janë dy boshte kryesore për ngritjen dhe zhvillimin e qytetërimit islamik.

Profeti Muhammed a.s. thoshte: "All-llahu më ka dërguar mua si mësues". Me këtë del në skenë edhe njëra nga dimensionet e profetësisë. Përmes këtyre fjalëve shprehet njëra nga rolet kryesore të profetësisë së Muhammedit a.s. madje edhe të gjithë profetët e mëparshëm kishin po këtë rol. Detyra kryesore e profetit është edukimi dhe të mësuarit e shoqërisë. Shoqëria është ajo që vazhdimisht ka nevojë për njerëz të arsimuar dhe mendimtarë të cilët do të jetojnë me të (shoqërinë), për mësues që do të jetojnë në vllugun e rrjedhave. Islami nuk njeh mënyrë sipas së cilës dijetari duhet të jetojë në vetmi ose të ikë nga përgjegjësia. I arsimuari (për të cilin shoqëria ka nevojë) është ai që fytyrën duhet ta ketë kthyer pikërisht kah njerëzit, sepse roli i tij i vërtetë dëshmohet në mesin e njerëzve.

Profetët, të urdhëruar nga Zoti, pikërisht ishin të kthyer kah njerëzit. Ata orvateshin që misionin e tyre hyjnor ta zbatonin aty ku ishin të obliguar. Dera e shtëpisë së tyre ishte e kthyer kah njerëzit, kah shoqëria, përballë atyre të cilët edhe ishin të dërguar nga All-llahu. Muhammedi a.s. derën e shtëpisë së tij pikërisht e kishte hapur përballë Darun-nedves. Kjo derë u hap me qëllim që të jetë sa më afër

njerëzve, në mesin e shoqërisë, sepse për një gjë të atillë edhe ishte obliguar përmes Shpalljes. Ai tanimë e kishte ndërprerë vetminë në kodrën Hira, ku disa muaj kishte qëndruar duke medituar dhe lutur për gjendjen e shoqërisë të cilës ai edhe i takonte. Nëse eventualisht ndonjë nga ata të obliguarit (profetët) do të kishte bërë ndonjë hap me qëllim që t'ia kthente shpinën shoqërisë (me këtë edhe misionit pejgamberik), atëherë do të intervenonte Xhibrili a.s. me urdhrin dhe me Shpalljen nga All-llahu i botëve e do ta orientonte për të vazhduar misionin me të cilin ishin detyruar. Kur'ani thekson rastin e Junusit a.s. i cili i mërzhitur nga populli ku ishte dërguar, u largua. Ikja e tij nga shoqëria i kushtoi mjaft Junusit a.s. Ai u pendua, por ku? U pendua në barkun e një balene, nga e cila edhe doli i gjallë... Më pas Junusi a.s. i penduar u kthye në vendin e tij dhe në shoqërinë ku edhe ishte dërguar si profet i All-llahut.

Nga roli i profetëve që patën në popujt ku ishin dërguar, kuptojmë se edhe obligimi i dijetarëve ndaj shoqërisë është me rëndësi të madhe, sepse shoqëria është ajo e cila duhet të shërohet ose së paku t'i vihet një preventivë nga devijimet eventuale. Për çdo sëmundje të shoqërisë fajësohen intelektualët, pra ata të cilët janë pishtarë të arsimimit. Kur'ani Fisnik theksoi se njerëzit janë të klasifikuar sipas diturisë. Nga Kur'ani mësojmë se dituria - me këtë edhe besimi i vërtetë - është një nga kriteret sipas së cilave All-llahu e lartëson njeriun.

"...Atë që duam Ne e lartësojmë shumë në dituri, e mbi secilin të dijshëm ka edhe më të dijshëm".(Jusuf, 76)

Profeti Ibrahim a.s. është ai i cili gjatë ndërtimit të Qabes në Mekkë iu drejtua Zotit duke e lutur që në atë vend dhe në atë popull (mekkas) ta dërgojë një profet i cili do t'ua mësojë atyre urtësinë, dhe do t'i pastrojë nga idhujtarizmi, devijimet ...

"Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t'i pastroj (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S'ka dyshim se Ti je Ngadhënjyesi, i Dijshmi".(Bekare, 129)

"Kështu Ne e shpallëm këtë Kur'an arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose ai (Kur'ani) t'u sjellë atyre përvojë mësimi. I Lartë është All-llahu, Sundues i Vërtetë. Ti mos nxito me Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij të ti, dhe thuaj: "Zoti im, më shto dituri!" (Ta Ha, 113-114)

Nga Kur'ani kuptojmë se arsimimi është njëra nga hallkat më të rëndësishme të zinxhirit të quajtur qytetërim. Vërtetë Kur'ani në shumë vende flet për diturinë si pjesë e jetës së besimtarit, që vazhdimisht edhe nxit në përsiatje, studim, arsimim, madje All-llahu edhe betohet në penën.

"Nun, betohem në penën dhe në atë çka shkruajnë!"(Kalem, 1)

Për çështjet për të cilat njeriu nuk ka dituri ose nuk e ka të qartë, atëherë ai është i detyruar që të pyesë të dijshmit, pra bartësit e përgjegjësisë.

All-llahu në Kur'anin Fisnik thotë:

"Ne as para teje nuk dërguam tjetër, përveç burra, të cilëve u dhamë shpallje. Ju (idhujtarë) pyetni pra dijetarët (e Tevratit e të Inxhilit) nëse ju nuk dini".(Nahl, 43)

Arabët paraislamikë nuk njihnin ndonjë nivel të lartë zhvillimi intelektual e kulturor që ata do t'i bënte të njohur në botë. Ata u ngritën vetëm me Islam. Mësimet kur'anore dhe ato profetike të Muhammedit a.s. shpeshherë stimulonin besimtarët muslimanë që diturinë ta përhapin kudo që është e mundur. Historia tregoi se më pas, shumica nga shokët e

Muhammedit a.s. u shndërrua në oazë të vërtetë të diturisë. Pra ata përbënin oazën e jetës kudo në shkretëtirat e errësirës, edhe atë duke pasur për synim përhapjen sa më efektive të diturive... Një numër jo i vogël prej tyre shkuan nga Gadishulli Arabik vetëm me qëllim që ta bartin mesazhin dhe thesarin islamik deri te popujt e ndryshëm të botës. Ajo gjeneratë e parë muslimane kishte fatin që të bëhet bartëse e freskët e diturive islame, sepse ata ishin që drejtpërdrejt kishin mësuar nga mësuesi dhe edukatori i tyre dhe i të gjithë njerëzimit - Muhammedi a.s.

Vet Muhammedi a.s. gjatë misionit të tij profetik dërgonte njerëz të aftësuar në ato zona ku kishte nevojë për mësues. Madje edhe bënte selektimin e thirrësve duke ua korrigjuar aftësitë profesionale të tyre. Asnjëherë nuk ka ndodhë që të dërgojë në ndonjë vend njeriun i cili nuk ishte i aftë për detyrën e porositur. Pranë diturisë së përsosur, thirrësi duhej të ishte i pajisur edhe me aftësitë retorike, gjë që vazhdimisht e kishte parasysh Muhammedi a.s. Kjo strategji profetike pati sukses të paparë deri më atë kohë, sepse për një periudhë mjaft të shkurtër kohore, dituritë islame, me këtë edhe ato shkencore, u përhapën dhe në pjesët e tjera të botës.

Ekspansioni i muslimanëve nuk u bë vetëm në sferën gjeografike, por ata në botë realizuan edhe një revolucion të dukshëm kulturor dhe qytetëruar. Gjithë ajo arritshmëri u bë me ndikimin e mësimeve kuranore. Kur'ani është ai që nxiti përpjekjet për studim dhe dituri të ndryshme. Muslimanët ishin ata që në rend të parë u përpoqën që me sinqeritet ta përhapin fenë e All-llahut, që thjeshtë nuk ishte fe me një dimension vetëm shpirtëror, por një sistem i qartë jete, që në parimet e saja fundamentale paralajmëroi se shoqëritë mund të ngrihen vetëm përmes dy segmenteve kolerative; besimit dhe arsimit.

RREZJA E QUAJTUR KULTURË ISLAME

Kur muslimanët mbërritën në Spanjë dhe në Sicili, ata me vete sollën qytetërimin e tyre specifik që u reflektua te popujt e tjerë jo muslimanë. Evropianët me kulturën dhe qytetërimin islam u njohën atëherë kur ranë në kontakt me islamit dhe muslimanët.

Shpirti i kulturës islame ishte një kolorit i përbërë nga disa popuj, por asnjëherë nuk ishte i varur nga një racë ose popull të caktuar. Ajo ishte islame. E frymëzuar me elementin islam. Mbështetja ishte në Kur'anin Fisnik dhe në Profetësinë e Muhammedit a.s. Ajo që këtë qytetërim dhe kulturë e bëri me përmasa botërore, që edhe ndikoi në renesancën evropërdimore, ishte fuqia e dëshirës dhe vullnetit



të atyre popujve që i takonin besimit islam, drejt të së vërtetës dhe zhvillimit intelektual. Andaj qytetërimi islam nuk mund të quhet as perëndimor e as lindor, por ai pikërisht ishte qytetërim dhe kulturë islame. Krahas antagonizmeve që në periudha të ndryshme kohore sundonin ndërmjet administratorëve ose kalifëve, në tërë atë shoqëri ekzistoi vetëm një mbështetje ligjore - Kur'ani dhe Sunneti /Praktika Profetike/. Në këtë aspekt nuk kishte kufi, racë ose diçka lindore apo perëndimore. Në Egjipt pati një Kalif nga Horosani, ndërsa në Indi ishte një turk. P.sh. Imam Gazaliu librin e tij kundër disa tezave filozofike e

kishte shkruar në Bagdad, ndërsa me te iu kishte përgjigjur Ibën Rushdit në Andaluzi. Me këtë dëshirojmë të themi se gjatë administrimit të muslimanëve, mbretëronte qytetërimi dhe kultura islame, që nuk njihte vijë kufitare apo racore...

Çështja e ndikimit të kulturës islame në botën joarabe ose në Evropë, shpeshherë është diskutuar ose është shkruar në tubime, ligjërata, libra të ndryshëm etj. Qytetërimi dhe kultura islame në periudhën e kulminacionit të saj paraqiste një etapë të re evolutive të qytetërimin mbarënjëzorë. Ndikimet e diturive islame i përfshinë të gjitha sferat e jetës së asaj

shoqërie ku edhe administruan muslimanët. Kalimi i muslimanëve në truallin evropian në fillim të shekullit VIII kishte një domethënie të madhe kulturo-qytetëruese. Ato ishin ditë fatlume për popujt evropian që kishin qenë të zhytur në errësirat e injorancës. Vlen të përmendim rastin kur një dijetarë e kishte pyetur intelektualen franceze zonjën Nevazie se cila është dita më fatzeze për historinë e Francës, ajo nuk kishte ditur t'i përgjigjet kësaj pyetje, sepse kishte menduar se ajo mund të jetë ndonjë ditë nga ato të Revolucionit Francez! Atëherë dijetari, i cili edhe kishte qenë profesor i historisë, i kishte treguar se ajo ditë ka qenë atëherë kur në vitin 732 ndodhi beteja në Poatje, ditë kur kultura arabo-islame u zmbryps para barbarizmit francez.

Islami që në ditët e para të përhapjes, nga ithtarët e saj kërkoi që ata të themelojnë shkolla ku do të mësojnë për shkencat e ndryshme, siç janë shkrim-leximi i Kur'anit, historia, gjeografia, matematika etj. Gjatë rrugës së përhapjes së islamit themelimi i shkollave u bë përditshmëri, sepse ato edhe e kishin mbështetjen në shkollën e parë të ngritur në Medinë, që u themelua krahas xhamisë.

Kështu lindën edhe shkollat e mëdha që më vonë edhe u shndërruan në universitete, siç është Universiteti Al-Az'har në Kairo, Nizamije në Bagdad, Zejtunije në Tunizi, në Fes, Damask, Kordobë etj. Të gjitha këto universitete u themeluan ndërmjet shekujve VII dhe X.

Sa ishte ndikimi i këtyre universiteteve në vetëdijen evropiane, mund të kuptojmë se në Evropë universitetin e parë e kemi në shekullin XIII...

Ndikimi i diturive islame përfshiu një diapazon shumë të gjerë shkencor, andaj edhe mjaft studiues dhe orientalistë u morën me qartësimin e këtyre çështjeve. Studimet ishin të ndryshme, ato ndonjëherë u përqendruan vetëm në një segment, siç është ndikimi i letërsisë arabo-islame në atë evropiane, që bën pjesë edhe studimi i çështjes së Dantes dhe Komedisë së tij Hyjnore. Pastaj ndikimi i poezisë (muvvashah-ut) arabo-andaluzian në poezinë lirike evropiane ose ndikimi i filozofisë së Ibën Rushdit në atë evropërdimore etj.

Kur e kemi fjalën për ndikimin e kulturës dhe qytetërimin islam në zgjimin apo në renesancën evropërdimore, medoemos të kihet parasysh se shkencëtarët muslimanë pothuajse kontribuuan në të gjitha sferat shkencore. Kontributi i tyre ishte në: letërsi, filozofi, në shkencat natyrore-matematikore, në mjekësi, farmakologji, gjeografi, botanikë, zoologji, astronomi, fizikë, kimi, detari, histori, arkitekturë, muzikë etj.

DITURIA KA MBËSHTETJE NË KUR'AN DHE SUNNET

Falënderimi absolut i takon Allahut të Lartmadhëruar, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi Muhamedin a.s., mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe, ndihma e Allahut qoftë me të gjithë ata që pasojnë Kur'anin dhe Sunnetin.

All-llahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "Thuaj, a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë".

Muhamedi a.s. thotë: "Kush e don këtë botë le t'i përmbahet ditunisë, kush e don botën tjetër (ahiretin) le të i përmbahet ditunis, e kush i don të dyjat përsëri le t'i përmbahet ditunis."

Për hadithin katër imamët e mirënjohur thonë:

Imam Ebu Hanife dhe Imam Shafiu r.a., thonë: "Hadithi autentik për neve është i padiskutueshëm."

Imam Maliku r.a. thotë: "Përpos Pejgamberit a.s. fjala e çdo kujt pranohet por mund edhe të refuzohet."

Imam Ahmedi r.a. thotë: "Ai që refuzon hadithin e Pejgamberit a.s., veç i është ofruar shkatërrimit."

Prandaj, në vazhdim të këtij teksti dhe në kuadër të titullit të tij do t'i shënojmë dhe do të flasim për pesë çështje bazë të cilat janë brum i këtij shkrimi: domosdoshmëria e ditunisë dhe punës; si lexohet Kur'ani Kerimi; vlerat e leximit të Kur'anit Kerimi; vlera e Kur'anit në ndërmjetësim për ithtarin e tij dhe; çfarë është relevante të dijë muslimani.

1. DOMOSDOSHMËRIA E DITUNISË DHE PUNËS

Ditunia pa punë është e qortuar nga ana e Allahut xh.sh., Pejgamberit të Tij dhe muslimanëve. All-llahu xh.sh. thotë: "O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek All-llahu është shumë e urretur ta thoni atë që nuk e punoni!" (Es-Saff, 2-3)

Ebu Hurejre r.a. thotë: "Ditunia sipas së cilës nuk veprohet, i gjasen pasurisë nga e cila nuk jepet për hirë të Allahut." Ndërkaq, Fadli r.a. thotë: "Një dijetar i caktuar vazhdimisht mbetet injorant përgjersa nuk vepron sipas ditunisë që posedon." Njëashtu, Malik Ibn Dinari r.a. thotë: "Një njeri i cili nuk din një shkronjë, edhe veprimi i tij është i pakuptimt."

Për çështjen në fjalë, padiskutim se sahabët janë shembull i shkëlqyeshëm, për të cilët thuhet: "Kur nga Resulullahu mernin dhjetë ajete, nuk kërkonin

edhe dhjetë tjerë, pa mësuar se çfarë bëhet fjalë për dituninë dhe veprimin në dhjetshin e pare, dhe thonin: e kemi përvetsuar dituninë dhe veprimin." Lidhur me fjalën e Allahut xh.sh.: "...të cilët e lexojnë drejtë ashtu si është..." (El-Bekare, 121), komenti i Ibni Abbasi r.a. është: "e pasojnë me përpikni." Njëashtu, Fadli thotë: "Kur'ani ka zbritur për të vepruar sipas tij, andaj, krahas leximit e studimit duhet përmbajtur edhe veprimi sipas tij." Kështu që, muslimani duhet shpejtuar në përgjigje të përmbajtjes së veprimit, meqë, elita e Ummetit një çështje që e mësonin, pa hezitar konkurronin për praktikimin e sajë, duke marë për model fjalën e Resulullahut s.a.v.s., ku thuhet: "Kur t'ju urdhëroj për diç realizone sipas mundësive, e kur t'ju ndaloj për diç lërëne atë." (Transmetojnë, Buhariu dhe Muslimi). Prandaj, hadisi qëndron në lidhshmëri të ngushtë me fjalën e Allahut, në të cilën tërhiqet vërejtja për dënim të dhembshëm: "...prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të dërguarit) se ata do t'i zë ndonjë telashe, ose do t'i godasë dënimin i idhët". (En-Nurë: 63)

Në këtë kontekst, në vazhdim po sjellim edhe këto shembuj:

-Nëna e muslimanëve Ummu Habibe përcjell hadisin: "Ai që gjatë njëzetekatër orëve i falë dymbëdhjetë rekatë, me to ndërtohet një shtëpi në xhennet për të." (Transmeton, Muslimi). Pastaj ajo thotë: "Prej asaj kohe që e kam dëgjuar Resulullahun unë nuk i kam braktisur (vazhdimisht i kam falur dymbëdhjetë rekatë)."

-Ibn Omeri përcjell hadisin: "Për muslimanin obligative është që të bëjë testamentin, mos t'i kalojë dy netë pa e patur testamentin të shkruar".

(Transmeton, Muslimi). Në vazhdim ai thotë: "Prej se e kam dëgjuar Resulullahun ta ketë thënë këtë, nuk më ka kaluar natë e mos ta kem të gatshëm testamentin."

-Imam Ahmedi r.a. thotë: "Nuk kam shkruar ndonjë hadis, pos kam vepruar sipas tij."

E në një rast Pejgamberi e bëri hixhamin dhe aty për aty e pagoi Eba Tiben, edhe unë kur e bëra hixhamin aty për aty e pagova El-Hixhamin."

-Imam Buhariu thotë: "Prej atij momenti që kam mësuar se përgojmë është haram, kurrsesi nuk kam përgojuar. Andaj, shpresoj që ta

takoj Allahun e mos të më mer në përgjegjësi për përgojimin e dikujt."

-Përcillet hadisi: "Ai që pas çdo namazi e lexon ajetul-kursijin nuk ka pengesë për të hyrë në xhennet..." (Transmeton, Nesaiu).

Pas ditunisë, në kuadër të amelit (veprimit) vie në shprehje prirja për në të mirë dhe të komunikuarit e ditunisë tjetrit, në këtë mënyrë muslimani nuk ja pengon vetes shpërblimin e as tjetrit të mirën. Në këtë kontekst, Muhamedi a.s. thotë: "Ai që prinë për të mirë, shpërblimin e ka të barabart me atë që e pason në veprim (dmth. pa i munguar palës tjetër asgjë)." (Transmeton, Muslimi).

Gjithashtu thotë: "Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin, por ja mëson edhe tjetrit." (Transmeton, Buhariu)

Kështu që, muslimani sa më shumë që përhap të mirën, aq më shumë i shtohet shpërblimi dhe i vazhdojnë të mirat gjatë jetës dhe pas vdekës. Muhamedi a.s. thotë: "Kur njeriu vdes, veprimtarja e tij ndërpritet, pos në tre raste: nga lëmosha rrjedhëse, nga ditunia frytdhënëse dhe, nga fëmiu i mir që lutet (bën dua) për prindër." (Transmeton, Ahmedi).

Në përmblyllje të këtij nëntitulli, shënojmë edhe këtë: gjatë njëzetekatër orëve muslimani surem El-Fatiha e lexon më shumë se tridhjetë e dy herë, përmes së cilës kërkon ndihmë (që të mos jetë prej atyre që kundër veti tërhiqen hidhërimin, e sa prej atyre që humbën veten) e pastaj u përngjasojnë atyre në veprimtari. Braktisë mësimin e vepron me injorancë, pra në këtë mënyrë ju përngjanë të krishterëve që e humbën veten; ose mëson por nuk vepron, në këtë mënyrë u gjasen çifutëve, që kundër veti tërhiqen hidhërimin!

2. SI LEXOHEM KUR'ANI KERIMI

Enesi r.a. është pyetur se si Muhammedi a.s. e lexonte Kur'anin, përgjigja e tij ishte: "E bënte zgjatimin kur e lexonte: Bismil-lahirrrahmanirrrahim; e zgjaste: Bismil-lahi, e zgjaste: Err-rrahmani, e zgjaste: Err-rrahimi." (Transmeton, Buhariu).

3. VLERAT E KUR'ANI KERIMIT

Kur'ani është fjalë e Allahut, vlera e tij kundrejtë fjalëve





*Muhammedi a.s. thotë:"
Më i miri prej jush është
ai që Kur'anin e mëson,
e njëherit ja mëson edhe
tjetrit."(Transmeton,
Buhariu).*

tjera është si vlera e All-llahut kundrejtë kreatorës së Tij, leximi më i vlefshëm është ai që gjuhën e vë në lëvizje me të (me Kur'anin).

a) Vlera e mësimin të Kur'anit Kerimit

Për vlerën e mësimin të Kur'anit personalisht dhe të tjetrit, Muhammedi a.s. thotë:" Më i miri prej jush është ai që Kur'anin e mëson, e njëherit ja mëson edhe tjetrit."(Transmeton,Buhariu).

b.) Vlera dhe shpërblimi i shumëfishtë për leximin e Kur'anit.

Çdo kush që lexon Kur'an sinqerisht për hirë të All-llahut xh.sh.ai shpërblehet me dhjetë të mira, por mund të arrijë gjerë në shtatëqind.

Prandaj, muslimani duhet bërë përpjekje maksimale për të gjetur kohë për lexim të Kur'anit, respektivisht ai duhet patur orar ditor dhe t'i përmbahet, pavarsisht nga rrethanat. Por, një duhet ditur se puna në vazhdimësi është ma e dobishme, qoftë edhe e paktë. Ndërkaq, e pa dobishme është kur ajo bëhet me vrull por me ndërprerje. E, nëse të godet pakujdesia ose të mer gjumi bëre zëvendësimin të nesermen. Për këtë që u tha më lartë, shih fjalët e Muhammedit a.s., ku thuhet : "Ai që e lexon një shkronjë nga Libri i All-llahut shpërblimi për të është një, mirëpo një shpërblim është i barabartë me dhjetë."(Transmeton,Tirmidhiu). Hadisi tjetër:" Kush bie në gjum(është fjala për natën) pa lexuar Kur'an, mirëpo atë e zëvendëson (leximin) mes namazit të sabahut dhe të drekës, i evidentohet sikur të kishte lexuar gjatë natës. (Transmeton,Muslimi).

Kështu që, muslimani nuk guxon të largohet prej leximit, të menduarit, leximit të drejtë e të bukur dhe vepërimit sipas Kur'ani Kerimit.

c)Vlera e nxënies përmendësh dhe leximit të drejtë të Kur'ani Kerimit

Për çështjen në fjalë,Muhammedi a.s.thotë:" Për atë që Kur'anin e lexon përmendësh, madhështia qëndron në atë se ai është i shoqëruar nga engjëjt fisnik e

të mirë. Ndërkaq, për atë që Kur'anin e lexon me kujdes dhe përpikshmëri, madhështia qëndron në atë se ai i ka dy shpërblime." (Hadisi është autentik). Poashtu Resulullahu a.s.thotë:" Ithtarit të Kur'anit i thuhet: Lexo dhe vazhdo me leximin e mirë e të drejtë (të Kur'anit) ashtu siç lexoshe mirë e drejtë në botën materiale (dynja), meqë, vendi yt është aty ku mbaron leximi i ajetit të fundit."(Transmeton ,Tirmidhiu)

Hattabiu thotë:" Përcillet nga tradita se numëri i ajeteve të Kur'anit përcaktojnë gradën e xhennetit. Lexuesit të Kur'anit i thuhet:ngjitu në gradën e xhennetit sipas sasisë të leximit të ajeteve të Kur'anit.Kush e lexon tërë Kur'anin ai arrinë gradën më të lartë të xhennetit në Ahiret (në botën e amshueshme). Ai që një pjesë nga Kur'ani e lexon grada e tij në xhennet është në proporcion me këtë, dhe shpërblimi përfundon aty ku përfundon leximi."

c) Vlera e të mësuarit Kur'anin pasardhësve

Për këtë, Muhammedi a.s.thotë:" Ai që e lexon, studion dhe vepron sipas Kur'anit, prindërve të

tij u vëhet nganjë kuror prej nurit (dritës) shkëlqimi i të cilave është si shkëlqimi i diellit. Poashtu, ju vishet nga një pelerinë të cilat në këtë botë nuk i kanë veshur, dhe thonë: Përse na vishen këto? Përgjigjen e marin: Për shkak se ua keni mësuar Kur'anin fëmijëve tuaj."(Transmeton,El-Haqimi).

d) Vlera e leximit dhe studimit të Kur'anit

Muhammedi a.s. thotë:" Kur muslimanët tubohen në ndonjë shtëpi të All-llahut të Lartmadhëruar, e lexojnë dhe studiojnë Librin e Tij, mbi ta zbret qetësia,mëshira, i shoqërojnë melekët dhe, për një çështje të tillë All-llahu bisedon me ata që janë tek Ai."(Transmeton, Ebu Davudi).

dh) Vlera e Kur'anit në ndërmjetësim për ithtarin e tij.

Për këtë çështje Resulull-llahu thotë:" Lexone Kur'anin, meqë ai në Ditën e Kijametit do të ndërmjetësoj për ithtarët e tij. "(Transmeton , Muslimi). Në hadithin tjetër thotë:"Agjërimi dhe Kur'ani në Ditën e Kijametit do të ndërmjetësojnë për abdin (adhuruesin). "(Transmetojnë, Ahmedi dhe

Hakimi).

4. MIRËSJELLJET PËR LEXIMIN E KUR'ANIT

Ibni Kethiri thekson këto mirësjellje:qetësimi para se të fillohet me leximin e Kur'anit, veshja me rrobe të mira e të bukura, të kthyerit drejtë kibles, me rastin e gogësimit dhe hapjes së gojës të ndërpritet leximi,të mos ndërpritet leximi me bisedë (me përjashtim të nevojës reale), të ndaluri, në ajetet premtues, duke ju drejtuar All-llahut me kërkes për çështje të nevojshme, e në ajetet kërcnues të kërkohet ndihmën e Tij. Mos me e lërë Kur'anin të hapur dhe mos me vën diç mbi të. Nëse janë dy e më shumë persona mos me e penguar njëritjetrin me zë dhe mos të lexohet rrugëve e vende publike ku ka zhurëm.

5. PËR MUSLIMANIN ÇËSHTJE RELEVANTE JANË EDHE KËTO:

a)El-ilëm (ditunia). Dituni e pakontestuehme është ajo që buron nga All-llahu i Lartmadhëruar dhe Pejgamberi i Tij,të cilat përmbledhen në dituninë Islame. Meqë, nuk bën të adhurohet All-llahu pa dituni, e nëse veprohet pa të një veprim i tillë mer kahje të hutisë.

b) El-amel(veprimi). Një nga intrigat e djallit është të larguarit e njeriut nga ditunia, duke e mashtruar,gjëja se me padituninë e tij do të arsyetohet para All-llahut xh.sh. Mirëpo, këtu harrojnë faktin (djalli e edhe njeriu) se ai që ka patur mundësi të mësoj e nuk ka vepruar,në fakt e humbë të drejtën për arsyetim.Këtë lloj intrige e praktikoi edhe populli i Nuhut a.s., me pretekst që mos të ketë dëshmi kundër tyre. Megjithatë, për një sjellje të tillë ja që flet Kur'ani:"...ata i vënin gishtat e tyre ne veshë dhe mbulonin kokat me teshat e tyre..."(Nuh,7).

c) Emër bil-meëruf nehjun anil -munker (urdhër për të mirë e ndalim nga e keqja). Meqë dijetarët janë trashigimtarë të pejgamberëve, ndërkaq All-llahu i mallkoi Beni Israilët, për arsye se:" Ata ishin që nuk ndalonin njëri -tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar."(El-Maide,79). Kështu që,thirja në Islam dhe interpretimi i ditunisë është farz (obligim) kolektiv, nëse dikush këtë e bën e që është e mjaftueshme, obligimi bie prej të gjithë muslimanëve, e nëse askush nuk e bën me këtë rast të gjithë mbajnë përgjegjësi.

ç) Sabri (durimi) përballë vështirësive:gjatë vjeljes së ditunisë, gjatë veprimin me të dhe, gjatë thirjes në Islam.

Falënderimi absolut i takon All-llahut xh.sh.

Përktheu dhe përshtati nga gj.arabe: Atullah Aliu



Nuk ka dhunë në fe

"Në fe nuk ka dhunë. është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm". El-Bekare: 256

Me të vertetë All-llahu xh.sh. na e ka sqaruar ne besimtarëve musliman dhe të gjithë njerëzimit në përgjithësi se : " Në fe nuk ka dhunë . Shprehja "Ikrah" donë të thotë ta detyrosh dikën ta veprojnë një punë në të cilën punë personi i detyruar nuk sheh ndonjë dobi në veprimin e asaj pune, dmth i detyruari nuk sheh dobi nëse e vepron atë punë . Por ka disa punë të cilat i veprojnë apo i detyrojnë ti veprojnë personat që jan me ne për dobin e tyre, sikur që është detyrimi i fëmijëve dhe shtyerja e tyre që të lexojnë dhe mësojnë ,kjo punë është për të mirën e fëmijëve ,po ashtu detyrimi nga ana jonë për fëmijët që të i përdorin ilaqet kur janë të sëmur, këto punë dhe të tjera të këtij lloji nuk llogariten dhunë ,sepse këto punë të cilat po i detyrojmë i veprojmë jan për të mirën e tyre sepse askush nuk është i gëzuar që të mbetet i sëmur. "Ikrah" - Dhunë, detyrim në këtë rast në ajetin kur'anor don të thotë ta detyrosh dikën ta veprojnë një punë në të cilën punë ai person nuk sheh se ka dobi duke u bazuar në mendjen dhe logjikën e shëndoshë, për këtë All-llahu xh.sh. thotë: " Në fe nuk ka dhunë , dhe kutimi i kësaj është se All-llahu nuk i ka detyruar krijesat e tij (njerëzit) në fe ,edhe pse ka qenë e mundur të e detyroi njeriun të cilin e ka lënë të zgjedhë ta veprojnë apo most a veprojnë, ashtu siq i ka detyruar qiejt, tokën, shtazët , bimët dhe gjërat e ndurta dhe nuk do të mundëte askush të mos i nënshtrohej, në lidhje me këtë All-llahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë : " sikur të donte All-llahu, do t'i drejtonte në rrugë të drejtë të gjithë njerëzit " Errad: 31

Nënshtimi pa detyrim

Por All-llahu xh.sh. dëshiron ta dijë se kush po i nënshtrohet me dashuri dhe me zgjedhjen e tij të lirë dhe jo i detyruar, sepse i detyruari për një punë donë të thotë apo tregon përdorimin e forcës dhe nuk tregon deshuri për veprimin e bërë, ndërsa kush i nënshtrohet atij ndërsa ka mundësi të mos e bëjë kjo është argument për dashurinë e tij për atë veprim dhe thotë All-llahu xh.sh: " Në fe nuk ka dhunë, që donë të thotë une nuk i kam detyruar me dhunë edhe pse po të doja do të besonin të gjithë kush është në tokë , e të dërguarit e All-llahut xh.sh a kan ardhur që ti detyrojnë njerëzit të besojnë ? Jo , të dërguarit kanë ardhur që të

transmetojnë nga All-llahu xh.sh e jo ti detyrojnë njerëzit, sepse All-llahu xh.sh i ka lënë njerëzit të zgjedhje sepse po ti detyronte (nuk do tu lente vend për zgjedhje në besim) nuk do të dërgontë të dërguar dhe mu për këtë shkak All-llahu xh.sh thotë : " Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? Junus : 99 Të dërguarit e kanë për obligim transmetimin nga All-llahu sepse All-llahu xh.sh nuk i ka detyruar në besim njerëzit, atëherë transmetuesi nuk është ai që i detyron sepse atëherë do të kishe gabime dhe prishje. Ndërsa ka dallim në mes : Detyrimin në besim (që të shtyhesh besosh) dhe detyrimin në zbatimin e asaj qka kërkon feja nga ti (dërsa ti je nga besimtarët), këtu kemi keqkuptime në këtë aspekt.

Nëse i thua një muslimani pse nuk falesh ? ai të thotë : " Në fe nuk ka dhunë " të argumneton më këtë ajet në mënyrë që të dominoj dhe të largoj ty ,ndërsa ne i themi ; Jo, sepse "Në fe nuk ka dhunë" ka të bëjë me besimin dhe qështjet e besimit ndërsa derisa ti ke besuar dhe e ke shpallur se ja besimtar i All-llahut xh.sh dhe je bërë me ne musliman duhet ta dish se po qese ke lënë apo ke kaluar një rrëgull nga rregullat e islamit kërkohet nga ti ta kryesh atë rregull ,ta zbatosh atë rregull, ti je i lirë të besosh apo të mos besosh por nëse ke besuar dhe je i lidhur me besim atëherë ke përgjegjësi në zbatimin e asaj rregulle ka përgjegjësi në zbatimin e besimit ,nëse ti pin alkool ti je i lirë nëse je pabesimtar përshembull por nëse ti je musliman dhe konsumon alkool ! , Jo ,ti me këtë veprim ke thyer ke kaluar një kufij nga kufijt e vendosur nga Krijuesi dhe për këtë e meriton dënimin. Sepse me qenëse ti me logjik të pastër dhe mendje të plotë ke besuar udhëzimeve të islamit duhet që ti zbatosh kërkesat e islamit, dhu mu për këtë shkak islamit nuk e obligon njeriun derisa të jet i pjekur menërisht dhe të hyjë në moshën madhore ,në mënyrë që të mos thuhet se All-llahu xh.sh e ka obliguar me besim pra se të plotësohet mendërisht, por e ka lënë të lirë nga obligimet derisa të jet i pjekur mendërisht sepse kur të hyn në rrethin e obligimeve e kupton se qka kërkohet nga ai atëherë ai është i lirë të hyjë në besim apo jo, por nëse hyn llogarit për veprimet e tij. Atëherë

Të mos thotë askush: "Në fe nuk ka dhunë" kur të dëgjoj ndonjë rregull fetar sepse kjo rregull ky ajet ka zbrit për qështjen bazore të besimit, nëse e pason këtë besim kërkohet nga ti që ti zbatosh kërkesat e atij besimi, ndërsa armiqtë e islamit kan dëshiruar që përmes kësaj rregulle ta sulmojnë islamit duke thënë : Islami është përhapur me tehun e shpatës. Ne u themi atyre : Ka dasht All-llahu xh.sh që islami të jet i dobët në fillimin e tij dhe ata që na kan paraprirë me islam të sprovohen me të gjitha llojet e sprovave dhe të dënohen me lloj lloj dënimi, të largohen nga shtëpit e tyre dhe pasurit e tyre dhe familjet e tyre duke mos pasur mundësi të ndërmarrin ndonjë veprim, atëherë koha e dobët në të cilën ka kaluar islami në fillim ishte e qëllimëshme. Ne ju themi gjithashtu : Kush e ka shtyr dhe e ka detyruar përdoruesin e parë të shpates ta përdor atë ?!, ndërsa muslimanët ishin të dobët dhe të mundur në qdo qështje madje nuk mund të mbronin as shpirtërat e vet , ju jeni duke rënë në kundërshti kur thoni se islami është përhap me tehun e shpates, po ashtu flasin rreth Xhizjes duke refuzuar atë, ne u themi atyre : çfarë është ajo xhizja që e merr islami nga jo muslimanët si taksë për mbrojtjen e tyre ? , muslimanët e kanë marrur xhizjen prej vendeve të cilat i ka shlyruar islami, që kjo tregon se ka pasur njerëz të cilët kan mbetur në besimin e tyre në një vend që ka sunduar islami dhe me qenëse ka pasur njerëz që kan mbetur në besimin e tyre ky është argumenti më i mirë dhe më i qartë se islami nuk është përhapur me tehun e shpates dhe nuk ka ushtruar dhunë asnjëherë.

Udhëzimi

Fjala e All-llahut xh.sh: " Në fe nuk ka dhunë ", është për të treguar se udhëzimi është i qartë dhe humbja është e qartë dhe me qenëse udhëzimi dhe humbja jan të qartë atëherë nuk ka vend për detyrim, sepse detyrimi ndodhë në kohën nuk gjërat nuk jan të qarta dhe detyrohen ti besojnë ato gjëra për të cilat nuk jan njerëzit të qetë sepse I kan të pa qarta dhe të komplikuar dhe mu për këtë All-llahu xh.sh thotë : " është sqaruar e vërteta nga e kota", dhe me qenëse udhëzimi është i qartë dhe humbja është e qartë ska nevoj për detyrim, por All-llahu xh.sh ty o njeri të ofron argumente të qarta





dhe ti o njeri me mendjen tënde të shëndosh mbetesh të zgjedhë, në mënyrë që të kuptosh se nese ke hyrë në fe ke obligime dhe ke llogaridhënje për ato obligime.

" Në fe nuk ka dhunë. është sqaruar e vërteta nga e kota , " Errushdu" - rruga e shpëtimit, rruga e drejtë, ndërsa " Elgajj" - rruga e humbur, All-llahu xh.sh. e sqaronë shprehjen "Errushdu" në një ajet tjetër Kur'anor ku thotë: "Unë do t'i zbraps nga argumentet e Mia ata të cilët pa pasur drejtë bëjnë kryelaresi në tokë, të cilët edhe nëse shohin çdo argument nuk besojnë, dhe nëse shohin udhën e shpëtimit, nuk e marrim atë rrugë, nëse e shohin rrugën e gabuar atë e marrin rrugë. Këtë (këtë verbërim të tyre), ngase ata i konsideruan të rreme faktet Tona dhe ngase i lanë pas dore ato." Elaraf: 146

Vërtetë All-llahu xh.sh na mëson se mendjemëdhënjet në tokë nuk do të mund ti shohin argumentet e All-llahut xh.sh. dhe as argumentet që tregojnë fuqin e tij, edhe nëse e shohin rrugën e drejtë nuk do të mundin të ecin në te e nëse e shohin rrugën e humbur futen në te dhe e ndjekin me përpikmëri sepse ata i përgenjeshtronë argumentet e All-llahut xh.sh dhe tregohen të pa vëmendëshëm për argumentet e All-llahut xh.sh. " Elgajj" - Rruga e humbur ,kur një përsone ecë në shkretëtirë dhe gabon rrugën atij i thuhet " Filani rrug humbur " dmth e ka humbur drejtimin e duhur në ecje dhe për këtë shkak mund ti paraqiten rreziqe të ndryshme sikur takimi me egërsirat e shumë rreziqe tjera, All-llahu xh.sh na e sqaron edhe në një ajet tjetër rrugën e drejtë Tarik Errushdi nga një kënd tjetër kun ë një ajet Kur'anor All-llahu xh.sh thotë : " Ne nuk e dimë se me këtë (përgaditje të qiellit) është për qëllim ndonjë e keqe për ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre dëshiron që ata t'i udhëzojë". Elxhinn: 10

Xhinët dhe disa nga njerëzit kan menduar se All-llahu xh.sh nuk do ta ringjall asken pas vdekjes dhe as nuk do të dërgoj peygamber nga njerëzit që ti udhëzoj njerzimin, kanë kërkuar Xhinët nga All-llahu xh.sh që tui jap mundësin të ngjiten ne qiejë dhe kanë gjetur qiejët të mbushur me rojtar mborjtës nga melaiiket, xhinët nuk e dinë fshehtësin e kësaj ruajtje dhe a ka në këtë diqka të keqe për njeriun apo ka dashur All-llahu xh.sh me këtë të mira dhe udhëzim për njeriun, atëherë " Errushdu" në këtë ajet Kur'anor ka kuptimin qartësim I rrugës për në shpëtim që është e kundërta e shprehjes "Elgajj". Pastaj thotë All-llahu xh.sh : " E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë", këtu shohim si All-llahu xh.sh së pari ka thënë

kush nuk beson në Taguut pastaj ka thënë kush beson në All-llahun .xh.sh sepse qështja kërkon së pari pastrim e pastaj stolisje së dyti, domosdo njeriu duhet të pas-trohet nga mosbesimi sepse është e pa mundur të besoi njeriu e në zemren e tij të ketë mosbesim, ne para se ti hekurosim veshjet së pari i lajmë dhe i pastrojmë, pastrim pastaj zbukurim. çka donë të thotë " Et-taguut"- kjo shprehje rrjedhë nga shprehja " Taga" ,shprehja " Et-taguut" tregon armiqësi të madhe, " Et-taguut" përdoret për të treguar Djallin, përdoret për ata që i kan dhënë vetvetes prioritete që të gjykojnë me mosbesim dhe ti adresojnë ato gjykime në drejtimin kah dëshirojnë ata në përputhje me dëshirat e tyre dhe u japin kahje gjërave, ashtu siq dëshirojnë udhëheqësit e tyre të asaj kohe tek ata ,përdoret edhe për ata të cilët bëjnë sehir apo magji, përdoret për qdo përsone që ka kaluar qdo kufij në padrejtësi dhe dhunë.

" ET-Taguu"t tregon atë se pas nënshtrimit ndaj tij shëndrrohet në zullumqarë, nëse dikush të detyron për një gjë të vogël dhe i nënshtrohesh ky nënshtrim në syt ë tij shtohet dhe kalon në zullum për ty nga ana e tij, All-llahu xh.sh. thotë : "Dhe ashtu ai e frikësoi popullin e vet, e ata e respekuan, por ata ishin vërtet popull i shkatërruar", (Ezuhuf 54) i shtonë urdhërat derisa të bëhet zullumqarë i padrejtë ,nuk ka dikush të ketë lehtësuar gjërat me armiqësi dhe zullum e dhunë, por qështja shkonë hap pas hapi sikur qdo rregull dicatorial që fillon me një detyrim e nëse njerëzit bëjnë durim e shton një rregull tjetër dhe kështu me radhë derisa të kalon në zullum dhe padrejtësi, për këtë shprehja: "Taguut" përdoret për djallim e mallkuar sepse ai është bazë e kësaj dhe po ashtu përdoret për rata të cilët flasin në emër të fesë për udhëheqësin e tyre (në përputhje me dëshirat e udhëheqësve të tyre të asaj kohe) , nëse shikojmë shprehjen "Et-taguut" në Kur'anin famëlartë e vërejmë se është përdorur në gjinin mashkullore në disa raste ndërsa në gjinin femërore është përdorur në një ajet të vetëm në Kur'anin famëlartë: " Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe ju drejtuan All-llahut, ata kanë gëzim të madh, e ti përgëzoj robërit e Mi!" (Ezzumer 17)

Në këtë ajet kur'anor All-llahu xh.sh na tregon shumë qartë se ata të cilët kanë lënë qdo lloj padrejtësie e zullumi jan ata të cilët i drejtohen All-llahut xh.sh me ibadet të pastër dhe për ata ka përgëzime, ka të mira, " shprehja " Istemseke" dallon nga shprehja "Meseke" sepse "Istemseke" tregon për përpjekje të vazhdueshme

për kapje dhe mbajtje të fortë , e ata të cilët praktikojnë fenë kanë nevoj qdo herë për shpenzim energjie të vazhdueshme dhe përpjekje për kapje dhe qëndrim në fe sepse djalli i mallkuar nuk të lëshon të lirë që kuptohet se nuk mjafton vetëm të kapesish por vazhdimish të përforcohesh në kapje, qdo herë që djalli të ben vesvese në një qështje ke obligim të kapesish edhe më shumë për fenë, që argumenton për përpjekje të vazhdueshme në rëfuzimin e shejtanit të mallkuar.

"Ai është kapur për lidhjen më të forte"- "El-urveti" donë të thotë kapëse një gjë të cilën e kapë sikur që thuhet Doreza e kovës për të cilën e kapë kovën, që në kohërat e vjetra ka qenë e ndërtuar nga një litarë i fortë, dhe "El-Vuthka" - është një qështje në të cilën je i qetësuar pas kapjes së saj (je i bindur plotësisht në atë qështje) ,sikur me shprehjen " fekadis temseke bil urvetil vuthka" bënë një krahasim në mes kapjes së kapëses së kovës dhe kapjes për litarin e All-llahut xh.sh kapjes për fenë e All-llahut xh.sh sepse njeriu e përdor atë për ujë dhe në ujë është jeta trupore dhe në fe është jeta shpirtërore dhe morale. Dhe me qenëse " lidhja më e fortë ", " El-Urveti el vuthka" është feja dhe besimi në All-llahun xh.sh, dhe me qenëse feja është litarë i All-llahut xh.sh atëherë kapu fuqishëm dhe shumë sigurtë dhe mos të ketë asnjë lloj qarje apo luhatje në atë kapje.

Duhet ditur se ka dy shprehje me kuptim po thuajse të njëjtë në dukje të parë që tregojnë qarje ndarje largim siq është shprehja e përdorur në këtë ajet " El-infisam" ndërsa ekziston edhe shprehja : "El-inkisam" që në dukje kan të njëjtin kuptim, por shprehja "El-infisam" - donë të thotë pengim i lidhjes së brendëshme (qarje e brendshme) mu sikur dora e njeriu kur thyhet ashti në brendësi ndërsa ajo vazhdon të jetë e kapur edhe pse ashti është thyer, ndërsa shprehja " El-inkisam" - donë të thotë : të largohet qdo pjesë larg nga tjetra ,ndërsa All-llahu xh.sh në ajetin Kur'anor thotë : " e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm", sikur tregon se qështja e zullumit dhe e padrejtësis do të jët gjithmonë dhe e vazhdueshme por ti o njeri ti o zullumqar o ti që bën padrejtësi mos harro sepse: " All-llahu është dëgjues i dijshtëm".

الأدب الإسلامية في القرآن الكريم

me autor:

**Shejh Muhamed Muteveli
esh-Sharavi**

Përshtati në shqip:

**Zuhdi B. Hajzeri,
Kajro-Egjipt**

Muhamedi a.s. dhe mesazhi i tij i paqes

“

Për dallim nga Pejgamberët tjerë, Muhamedi a.s. nuk ka qenë i detyruar që ta mbron veten nga provokatorët dhe aferat e ndryshme që ishin pjellë e fantazmës dhe urrejtjes së armiqëve të tij dhe të fesë, por Allahu xh.sh është Ai i cili u është përgjigjur provokatorëve dhe shpikësve që plasonin të pavërtetat, kundërshtarëve të fesë Islame. Gjë e cila vazhdon në ditët e sotme, kur jemi dhe ne dëshmitarë të disa orvatjeve për të nxirë figuren më të ndritshme të njerëzisë Muhamedin a.s.

Ismet BYTYQI

"... Frikësohuni prej Meje (e bëra këtë) që të gjeni rrugën e drejtë dhe që të plotësojë mirësinë Time ndaj jush. (sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë, e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju mësojë atë që nuk e dinit." (El- Enfal: 150-151)

Muhamedi a.s. nuk ishte i dërguar vetem për një popull dhe për një vend me kohë të caktuar dhe me afat të caktuar, siç ishte rasti dhe te të dërguarit e tjerë para tij. Konsensusë i gjërë është në mes dijetarëve Islam, se Muhamedi a.s. është i dërguar për gjithë njerëzinë duke përfshirë këtu dhe krijesat e padukshme (xhinët), sa që disa prej tyre shkojnë dhe më largë duke thënë se Muhamedi a.s. ishte i dërguar dhe për Melaqet (Engjujt).

Ka ajete të shumta që flasin për pejgambërllekun e Muhamedit a.s.

duke paraqitur ate si i dërguar i përgjithshëm, për çdo popull, vend dhe kohë.

" Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhd-edhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë" (Sebe: 28)

" E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (El- Enbija: 107)

" Ai që ja shpalli Furkanin (Kur'anin dallues të së vërtetes nga e pa vërteta) robit të vet (Muhamedit) që të bëhet pejgamber i botës (këshillues), është i madhëruar." (El-Furkan: 1)

Transmetohet në dy sahihat e Buhariut dh Muslimit, se Muhamedi a.s. ka thënë: "Më janë dhënë pesë gjëra me të cilat nuk i janë dhënë asnjërit para meje: Jam ndihmuar me frikën sa një muaj udhëtimi, e gjithë toka më është bërë mesxhid dhe e pastër, kudo që e zë ndonjërin nga umeti im namazi, le të falet, më është lejuar preja e luftës që nuk iu lejua asnjërit para meje, më është dhënë shefa'ati (ndërmjetësimi) dhe pejgamberët e mëparshëm ishin të dërguar vetëm për popujt e tyre, ndërsa unë jam i dërguar për të gjithë njerëzit." (Sahih)

MUHAMEDI A.S. GARANCË DHE SIGURI PËR UMETIN

Një grup idhujtarësh në krye me Ebu Xhehlin në shenjë euforie e lutën Zotin t'i gurëzoi, ashtu dhe siç spjegohet në librin e shenjtë Kur'anin famëllartë: " Dhe (përkujto) kur thanë: "O Allah! Nëse është ky (Kur'ani) vërtet prej Teje, lësho gurë nga qielli kundër nesh, ose sillna ndonjë dënim të idhët." (El- Enfal: 32)

Ndëshkimi i Allahut xh.sh kundërt mizorëve e dhunuesve, nuk përfshinë vetëm fajtorët, ndodhë që dhe ndonjë i mirë të përfshihet në të dhe të pasojë bashk me fajtorët. Ligji i Allahut xh.sh ishte të mos shkatërrohet i tëri populli duke qenë në mesin e tyre Pejgamberi.

Andaj Allahu xh.sh. zbriti një ajete tjetër duke u përgjigjur në lutjen e idhujtarëve, me fjaët: " Po Allahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfar)." (El- Enfal: 33)

Prezenca e Muhamedit a.s. në mesin e as'habëve (shokëve të Muhamedit a.s.) ishte siguri dhe garancë për ta nga dënimi i Allahut

xh.sh.. për dallim nga pejgamberët e mëparshëm kur popujt e tyre kanë qenë të dënuarë dhe në prezencën e Pejgamberit të tyre.

Në tefsirin e Ibn Kethirit, Abdulla ibn Abasi komenton ajetin e lartëshkruarë, në këtë mënyrë: Allahu xh.sh. dhurojë këtij umeti dy garanca sigurie nga dënimi, kushtimisht derisa ato gjinden në mesin e njerëzve. Njëren nga ato garanca vetëm se ka marr Allahu xh.sh (mendon në Muhamedin a.s.), kurse garanca tjetër ende gjindet në mesin e tyre, e ajo është ashtu siç thuhet në Kur'an: " ... Allahu nuk do ti dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfarë)." (El- Enfal: 33)

ALLAHU XH.SH. SIGURON MBROJTJEN E MUHAMEDIT A.S.

" O ti dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyren (relevantërisalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon." (El- Maide: 67)

Allahu xh.sh nderojë Muhamedin a.s. me sigurimin e mbrojtjes së tij nga armiqët, tallësit dhe provokatorët.

Ismet ibn Malik El- hatemi, thotë: " Siguronim Muhamedin a.s. në ndërrimin e natës, gjersa nuk zbriti ajete: "Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve)..." (El- Maide: 67), manadej Ismet ibn Malik El- hatemi tregon se pas zbritjes së këti ajete: "kemi ndërperë rojen e natës".

Nga Ebu Hurejre, tregohet se: "Kur udhtonim me Muhamedin a.s., në mes të rrugës kur pushonim, i'a mundësonim uljen nën drunin ma të madh për shkak të hijes dhe fladit, për tu freskuar sa ma shumë Muhamedi a.s.

Një ditë Muhamedi a.s. u ulë nën hijen e një druri dhe varri shpatën e tij në dru. Një njeri arriti dhe morri shpatën dhe tha: O Muhamed, kush do të shpëton nga unë tash? i dërguari i Allahut xh.sh. iu përgjigj: Allahu dot më shpëton nga ti, lësho tash atë shpatë! Njeriu nga friga lëshojë shpatën. Pastaj Allahu xh.sh. zbriti ajetin: " Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve)..." (El- Maide: 67)

Për dallim nga Pejgamberët tjerë, Muhamedi a.s. nuk ka qenë i detyruar që ta mbron veten nga provoka-

torët dhe aferat e ndryshme që ishin pjellë e fantazisë dhe urrejtjes së armiqëve të tij dhe të fesë, porë vetë Allahu xh.sh është Ai i cili u është përgjigjur provokatorëve dhe shpikësve që plasonin të pavërtetat, kundërshtarët e fesë Islame. Gjë e cila vazhdon sot kësaj dite, kur jemi dhe ne dëshmitarë të disa orvatjeve për të nxirë figuren ma të ndritshme të njerëzisë, Muhamedin a.s.

Dallimi është shumë i qartë në këtë aspekt, duke marrë shembull Nuhin a.s. në Kur'an ku thuhet: "Paria nga populli i tij tha: " Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur!. (Nuhu) Tha: " O populli im, unë nuk kam kurrfarë humbje, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve." (El- A'rafë: 60-61)

Sa i përket Hudit a.s. në Kur'an, thuhet: " Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: " Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak. Tha: (Hudi): " O populli im, nuk jam mendjelehtë (nuk kam të metë mendore), por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve." (El- A'rafë: 66-67)

Ndërsa, personaliteti i Muhamedit a.s. ka qenë i mbrojtur nga shpifjet me Kur'anin famëllartë, me argumente të qarta dhe bindëse. Siç shifet nga ajetet në vijimë:

" Ne as nuk ia mësuam atij (Muhamedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë." (Jasin: 69)

" Pra Unë betohem në atë që e shihni! Edhe në atë që nuk e shihni. Se me të vërte tai (Kur'ani) është fjalë (e Zotit) që e lexon i dërguari i ndershëm. Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, po ju nuk besoni. Nuk është as fjalë e ndonjë falltorit, po ju nuk përkujtoheni. Është zbritje prej Zotit të botëve." (El- Haka: 38-43)

" Nuk është i marrë shoku juaj (Muhamedi)! Dhe se ai e pat parë atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë lindorë. Dhe ai nuk është që në të fshehtë (Shpalljen) ka dyshim (ose ua lë të mangu). Dhe ai (Kur'ani) nuk është thënie e djallit të mallkuar! Pra, ku jeni, kah shkoni? Ai (Kur'ani) s'është tjetër pos këshillë për njerëzit." (El- Tekvir: 22-27)

" Shoku juaj (Muhamedi që ju e njihni) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta). Dhe ai nuk flet nga mendja e tij." (En- Nexhm: 2-3)

" Pra ti përkujto (me Kur'anin) se me dhuntinë e Zotit tënd ti nuk je as falltor, as i çmendur." (Et- Tur: 29)

Mesazhi i fundit i MUHAMEDIT A.S.

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

-O njerëz! Dëgjoni çka do t'ju them, sepse nuk e di se a do t'ju takoj në këtë vend pas këtij viti.

-O njerëz! Kini frikë Zotin dhe respektojeni Atë. Bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve. Kjo është dita e fljimeve në emër të All-llahut. Me të vërtetë gjaku dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend.

-Ruajeni, respektojeni dhe nderojeni vlerën e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor.

-Njeriu është vepër madhështore e All-llahut dhe mjerë ai që e nënçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së All-llahut.

-Ju, o njerëz, pashmangshëm dhe pakthyeshëm do t'i ktheheni All-llahut të Amshueshëm dhe Ai do t'ju marrë në përgjegjësi për veprat dhe punën tuaj.

-O besimdrejtë! Ta dini, ta mbani mend dhe të jeni të bindur se përfundoi koha e mosdijes dhe traditave të këqija, që i sollën fatkeqësi të shumta gjinisë njerëzore. Unë ua kam treguar rrugën e shpëtimit, nëpër të cilën duhet të shkoni.

-Gjërat që u janë lënë amanet, ruani si të juajat dhe ktheni besnikërisht dhe me kohë tek ai që i takojnë.

-Gjakmarrja është e ndaluar. Të gjitha akuzat e këtilla që rrjedhin nga koha para Islamit, anulohen. Akuza e parë e këtillë që anulohet është gjakmarrja e xhaxhait tim, Amir b. Rebi' b. Harith b. Abdulmuttalibit, të cilin pa kurrfarë faji e mbytën njerëzit nga fisi Hudhejl. Kjo gjakmarrje le të harrohet dhe të gjitha të tjerat në të ardhmen le të falen.

-Fajdeja dhe kamata janë të ndaluara. Huadhënësi nga huamarësi duhet ta marrë vetëm atë që vërtet ia ka hauzuar. Huatë e para që i nënshtrohen këtij vendimi janë huatë e xhaxhait tim Abbasit, i cili ka pasur njaft borxhlinj.

-O besimdrejtë! Duhet t'ua falni kamatat borxhlinjeve. Dëgjoni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse juve ju mbetet kryegjësja për tregti dhe punë të ndershme.

-Nëse nuk e bëni këtë, duhet ta dini se do t'a zemëroni thellë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.

-Nëse borxhliu i juaj është në vështirësi, duhet t'ia vazhdoni afatin e pagimit, ndërsa nëse jeni në gjendje që t'ia falni borxhin, kjo do të ishte edhe më mirë për ju.

-O besimdrejtë! O njerëz! Frikësojuni asaj dite që me siguri do të vijë, kur të gjithë do të paraqiteni para All-llahut, Gjykatësit të Vetëm Suprem, kur ju pret drejtësia absolute.

-Kur të zotoheni se një borxh do ta paguani me kohë dhe kur ta lidhni marrëveshjen, të gjitha këto bëni me shkrim, saktë dhe me besnikëri theksoni afatin e pagimit...

-O të vdekshëm! Duajeni dhe dëgojeni Zotin, Krijuesin e tërë materiale dhe jomateriale, i Cili krijoi meshkuj dhe femra, prej të cilëve u zhvillua gjinia njerëzore.

-Kini frikë nga All-llahu, në ndihmën, prehjen dhe mëshirën e të cilit të gjithë jemi të udhëzuar. Ne jemi të vdekshëm dhe në çdo çast jemi gjithnjë e më afër vdekjes dhe takimit me Të, me All-llahun e Amshueshëm, me Gjykatësin e Drejtë.

-Shprehni respektin e duhur ndaj farefisërisë. Me përgjegjësi të thellë përmbushni detyrat dhe obligimet që ekzistojnë ndërmjet burrit dhe gruas, ndërmjet prindëve dhe fëmijëve.

-Fëmija e fiton xhennetin nën këmbët e nënës së tij.

-Ruajuni nga prostitucioni, tradhtia bashkëshortore dhe xhelozia. Prostitucioni dhe tradhtia bashkëshortore janë mëkate të rënda, ndërkaq xhelozia mund të shkaktojë prishjen e bashkëshortësisë.

-Martohuni me ato që i doni, e kur vullneti i Zotit t'ju bashkojë, atëherë respektojeni dhe duajeni nëri-tjetrit dhe jetoni në dashuri dhe harmoni të vërtetë.

-O bashkëshortë! Silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri.

-O besimdrejtë! Largohuni nga ngatërresat dhe përgojimet!

-Ata që shpifin për gratë e ndershme, le të jenë të mallkuara në të dy botët. Ata që i akuzojnë gratë e ndershme për tradhti në martesë ose për amoralitetin, ndërkaq që nuk mund për këtë t'i sjellin katër dëshmitarë të besueshëm, dënimi me tetëdhjetë goditje, dhe asnjëherë në të ardhmen në asgjë mos u besoni, sepse ata janë njerëz të degjeneruar dhe të këqij.

-Nëse mendoni se ndaj grave tuaja më nuk e ndjeni dashurinë e dikurshme, mos nxitoni, por mendoni mirë. Ndoshta All-llahu nëpërmjet këtij sprovimi ju udhëzon në rrugën e fatit të ri të madh, me të cilin dëshiron t'ju përgëzojë.

-Mos kërkoni shkurorëzim pa shkaqe të arsyeshme, meqë prej të

gjitha gjërave që All-llahu i ka lejuar, më së tepërmi e urren shkurorëzimin.

-Gratë tuaja u janë dorëzuar në besë të Zotit. Respektojeni, o besimdrejtë, atë amanet të Zotit.

-O njerëz! Sot djalli i mallkuar është i dëshpëruar, sepse ka pësuar humbje dhe më nuk mund të ndikojë në ju. Por ju megjithatë gjithnjë bëhuni të kujdesshëm, që ai i mallkuar të mos ju vë në lajthitje as për gjërat më të vogla.

-O besimdrejtë! Kur e caktoni dhe e ndani ndërmjet veti trashëgiminë, bëhuni të drejtë dhe përmbajuni librit të Zotit. Ruajeni pasurinë e bonjakëve, të paaftëve dhe të sëmurëve psikikë.

-Zoti çdonjërit ia ka dhënë të drejtën e vet, andaj nuk ka nevojë që trashëgimtarëve t'u lihet testament; ndërsa si testament nuk mund të lihet më tepër se një e treta(1/3) e pasurisë.

-Fëmija i takon atij, në shtratin e të cilit është i lindur.

-Kush pohon se i takon tjetërkujt përveq prindit, atë do ta arrijë mallkimi i Zotit.

-Nuk i lejohet gruas që të jap diç nga pasuria e burrit të saj pa lejen e tij.

-Borxhin duhet paguar, ndërsa sendin e huazuar duhet kthyer. Dhurata duhet të kthehet me dhuratë. Kush hyn dorëzan për dikënd, obligohet edhe me përgjegjësi për dorëzani.

-Me robrit dhe shërbëtorët silluni në mënyrë njerëzore. Ushqeni ata sikur që ushqeheni vetë, dhe vishni ata sikur që visheni vetë. Nuk guxoni t'i bëni keq, as t'i keqpërdorni. Edhe ata janë njerëz, edhe ata janë shërbëtorë të Zotit.

-O besimdrejtë! Ta dini dhe të mos harroni se të gjithë muslimanët janë vëllezër. Ju të gjithë jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe detyra. Nuk ka kurrfarë përparësie arabi ndaj joarabit, e as joarabi ndaj arabit, as i ziu ndaj të kuqit, e as i kuqi ndaj të ziut përveç me devotshmëri. Të gjithë jeni pasardhësit e Ademit, ndërsa Ademi është prej dheut.

-O muslimanë! Duhet të kujdeseni, të duheni dhe të ndihmoheni ndërmjet vete. Nuk guxoni ta ofendoni njëri-tjetrit, e as t'i merrni me dhunë njëri-tjetrit diçka. Këto janë mëkate të rënda. Merreni vetëm atë që me vetëdëshirë ju jepet. Respektoni pacenueshmërinë e pasurive tuaja derisa janë në frymën

e ligjeve të Zotit.

-Në punën tuaj Islami dhe interesi i përgjithshëm le të jetë mbi ju dhe interesin tuaj personal. Përkushtojani Islamit jetën tuaj dhe në punën për Islam jepeni prej vetes gjithçka që mundeni.

-Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e askujt. Vetvetes mos i bëni dhunë. Mos harroni se mëshira është një ndër bazat kryesore të Islamit.

-O njerëz! Dëgjoni çka po ju them dhe mbajeni mend mirë. Unë po ua lë librin e Zotit, Kur'anin, i cili, nëse i përmbaheni, gjithnjë do t'ju ruajë që të mos e humbni rrugën e drejtë, rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës. Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e All-llahut, fjalë e Tij, në vërtetësinë e së cilës nuk ka kurrfarë dyshimi.

-Para vetes e keni tërë jetën time, fjalët dhe veprat e mia. Gjithçka që kam folur dhe punuar, jam përpjekur që të jetë në pajtim të plotë me urdhrat e All-llahut.

-Ju vërtet nuk do të gjendeni në lajthitje përderisa t'i përmbaheni Kur'anit dhe sunnetit tim.

-O besimdrejtë! Thuajeni gjithnjë të vërtetën e pastër. Urretja asnjëherë le të mos ju largojë nga rruga e të drejtave dhe drejtësisë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësohuni nga All-llahu! Ai e sheh punën tuaj.

-O njerëz! I dëgjua porositë e mia, futni në zemrat tuaja, në jetërat e juaja.

-Të gjithë ata që i kanë dëgjuar kotë fjalë të mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar, sepse prej tyre mund të ketë më mbamendës së vetë dëgjuesit. (Pas një pauze të shkurtër, i Dërguari i Zotit me një zë më të butë ka thënë): "O Zot im! A e kam përmbushur detyrën dhe misionin e besuar?"

-O i Dërguari i Zotit! Ti besnikërisht e ke përmbushur misionin tënd dhe neve na ke komunikuar çka të ka urdhëruar Zoti, u përgjigjen më se 100. 000 njerëzit e pranishëm. (Atëherë Muhammedi a.s. me zë solemn tha

-O Zoti im, dëshmo (në këtë)!

(Të njëjtën ditë, Zoti i lavdishëm e shpalli edhe ajetin e fundit të Kur'anit):

"Sot ua kam përkryer besimin dhe kam plotësuar begatinë time ndaj jush, dhe jam i kënaqur që për ju Islami të jetë fe". (Maide,3).

IHVANUS-SAFA DHE MUZIKA

Mr. Abas Jahja

Ihvanus-Safa njihen si përfaqësues dhe ndjekës të filozofit të madhë antik, Pitagorës dhe Nikomahosit. Në shkrimet e tyre gjegjësishtë Risalet e tyre ata pohojnë se Pitagora është njeri i urtë. Si paraardhës i Pitagorës e konsiderojnë Hermes Totin.

Ihvanus-Safa është një rrymë filozofike që formohet në Basra, që në përkthim do të thotë: "Vëllezërit e pastër". Qëllimii i formimit të tyre është krijimi i një grupi mendimtarësh të pavarur "Libres pensuers" që sot i kultivojnë vlerat morale dhe shpirtërore.

RISALET

Veprat më të rëndësishme të tyre janë përmbledhjet enciklopedike të ashtuquajtura "Risale". Në fillim paraqiten si një grup i fshehur filozofiko-fetar.


Risalet e Ihvanus-Safas përbëhen prej 51 pjesëve. Në disa burime përmenden edhe 52 pjesë. Nuk kemi burime të sakta se kush i ka shkruar këta Risale, por sipas Ebu Hajjam et-Teuhidijut shkruesit e Risaleve janë: Ebu Sulejman bin Mesh'ar el-Besti, Ebul-Hasan Alij bin Harun ez-Zenxhani, Ebu Ahmed el-Mihrixhani, Zejd bin Er-Rrifai dhe Eufi el-Basri. Sipas një mendimi tjetër botëkuptimi i Ihvanus-Safas është hudhja e themeleve të metafizikës eklektike, ndërsa një mendim tjetër pohon se te ta hasim në një gnosticizëm eklektik.

Risalet ndahen në katër pjesë (lëmi): Matematika, Fizika, Psikologjia dhe Teologjia.

14 Risale flasin për Matematikën, 17 Risale për Filozofinë dhe Psikologjinë, 10 Risale për Metafizikën dhe 10 Risale për Astrologjinë dhe temat Mistike.

Në Risalen e pestë, Ihvanus-Safa, flet gjërësishtë në mënyrë shumë serioze i qaset çështjes së muzikës. Pas el-Kindiut, Farabiut dhe ibni Sinasë, Ihvanus-safa i kushton rëndësi shumë të madhe muzikës si në aspektin teorik po ashtu edhe në atë praktik. Në lëminë e muzikës janë ndjekës të shkollës Pitagoriane.

“*Ihvanus-Safa ndjek rrugen e Pitagorianëve. Pitagora jo vetëm që konsiderohej si themelues dhe baba i njohurisë mbi analizën e veprimit të numrave në natyrë (numerologjia), por ishte dhe mbetej mistiku, okulisti, matematikani dhe filozofi më i madhë i të gjitha kohërave.*



Në Risalet e Ihvanus-Safas flitet për ndikimin që ka dhe që mund të zgjoj zëri.

Zëri i bukur dhe i këndshëm ndikon pozitivisht në shumë aspekte, si qetësimi, guximi, gëzimi, dëshprimi etj.

Sipas Ihvanus-Safas, aq sa duhet ti kushtohet rëndësi diturisë dhe pajisjes nga ana intelektuale, gjithashtu paralelisht me diturinë, duhet ti kushtoj kujdes të madhë edhe artit në përgjithësi, e në veçanti artit muzikorë.

Ihvanus-Safa theksojnë se ç'do popull, siç e ka shijen e vetë të posaçme për haje, pije dhe veshëmbathje, po ashtu e ka edhe shijen e vetë për të dëgjuar muzikë.

Ihvanus-Safa pohojnë se edhe në gjithësi dhe ç'do kund ekziston një harmoni dhe lidhëshmëri në mes trupave qiellorë. Këta mendime i hasim edhe te popujt e

mëhershëm si p.sh. në Konfuçionizëm. Konfuçionizmi këtë sistem e quan "sistemi Pentatonik".

SHKALLA PENTATONIKE

Që në kohëra mjaftë të lashta në disa popuj një pjesë e muzikës bazohet në shkallën me pesë nota, shkalla e ashtuquajtur Pentatonike, e marur nga fjala e greqishtes së vjetër "Penta" që në gjuhën shqipe do të thotë: "Pesë", pra që do të thotë shkalla pesëtonike, e cila ndërmjetë pesë tingujve nuk ka as një gjysmëton.

Kjo shkallë përbëhet nga notat: DO, RE, FA, SOL, LA. Është një shkallë e gjymtë.

Ajo është përdorur gjërësisht në kohërat e lashta, jo vetëm për faktin se njohuritë e njeriut ishin të kufizuara ende, por edhe nga njëfarë dobësie mistike, superstitioze, që njerëzit kishin ndaj num-

rit pesë.

Edhe ndjekësit e Filozofisë së Pitagorës, të një filozofije idealiste e metafizike, kishin ndaj numrit pesë një ndjenjë drujtjeje, të turbullt.

Nëse kthehemi përsëri në shkrimet e Konfuçionizmit këtë lidhëshmëri dhe harmoni ata e sqarojnë kështu:

1. Nota (intonacioni) -Kung- simbolizon sunduedin;
2. Nota (intonacioni) -Sheng- simbolizon parinë;
3. Nota (intonacioni) - Shueh- simbolizon popullatën;
4. Nota (intonacioni) -Shih- simbolizon punët dhe
5. Nota (intonacioni) -Ju- simbolizon sendet ose gjërat.

Sipas tyre nëse në mesin e këtyre pesë tingujve nuk ka ndonjë shkëputje atëherë sistemi do të funksionoj në rregull përkundrazi nëse në mesin e këtyre tingujve ka shkëputje atëherë sistemi nuk do të kishte funksionuar në rregull, do të thotë sipas tyre muzika paraqet një lidhëshmëri dhe harmoni në mes tokës dhe qiellit.

Ihvanus-Safa në sistemin e tyre i japin një vend të posaçëm dhe të rëndësishëm edhe numrit tetë. Çdo qenie ka lidhëshmëri të ngushtë me tetë anë, dhe këtë mundohen që ta argumentojnë me argumente të ndryshme. Edhe sistemi i sodit muzikorë përmban tetë nota edhe atë duke e përsëritur notën e parë fillestare: DO, RE, MI, FA, SOL, LA, SI, DO.

Më lartë thamë se Ihvanus-Safa ndjek rrugen e Pitagorianëve. Pitagora jo vetëm që konsiderohej si themelues dhe baba i njohurisë mbi analizën e veprimit të numrave në natyrë (numerologjia), por ishte dhe mbetej mistiku, okulisti, matematikani dhe filozofi më i madhë i të gjitha kohërave.

Në fund mund të konstatojmë se shumë mësim të Pitagorës, edhe sot e kësaj dite konsiderohen si fshehtësi e madhe dhe se të gjitha shkathtësitë dhe praktikat okuliste të perendimit burojnë nga mistika Pitagoriane. Ai përveç tjerash shëtiti edhe vende të ndryshme si Egjiptin, Persinë, Indinë dhe vende tjera të lindjes.

PËRDORIMI I ALFABETËVE

Faik MIFTARI

Alfabeti latin është më i njohuri dhe më i përhapuri në botë, të cilët e përdorin popujt e ndryshëm anekënd botës. Popujt e shumtë të botës që e përdorin alfabetin latin e kanë trashëguar nga romakët e vjetër. Alfabeti latin është zhvilluar nga alfabeti i vjetër grek, i cili i ka rrënjët tek alfabeti fenikas. Ka shtrirje në të gjitha kontinentet, me të madhe përdoret në Europë, Amerikë Veriore e Latine, Australi, e më pak në Azi dhe Afrikë. Është në përdorim zyrtar në vendet e zhvilluara ekonomike si p.sh. në SH.B.A., Kanada, Britani e Madhe, Gjermani, Francë, Itali e kështu me rrallë. Alfabeti latin në përdorim dallon prej popullit në popull në nuanca të caktuara, në ndonjë zanore apo bashkëtingëllore.

Alfabeti kinez është i përhapur dhe në përdorim zyrtar vetëm në kontinentin e Azisë, por me numër më të madh të përqindjes së përdorimit të njerëzve në rruzullin tokësor. Kryesisht përdoret në Kinë, Japoni, Kore Veriore, Kore Jugore, Vietnam.

Alfabeti kinez është në përdorim në Kinë 3200 vjet, që nga koha e dinastisë së Shangut, alfabeti kinez karakterizohet me numrin e madh të shenjave, ka mbi 10.000 shenja, por më së shumti përdoren afro 3000 sosh dhe se në vend shkronjave janë shenjat dhe se çdo shenjë paraqet një term të caktuar.

Alfabeti arab është i përhapur kryesisht në botën arabe dhe myslimane, është zhvilluar nga alfabet nabatej në ndikim të pjesërisht të alfabetit të vjetër sirian. Shkruhet nga e djathta në të majtë, dhe ka forma të ndryshme kur shkronjat gjenden në fillim, në mes apo në fund të fjalës. Ka përdorim kryesisht në kontinentin e Azisë dhe Afrikës, ka qenë i përhapur edhe në një pjesë të Europës, në Ballkan, në fillim të shekullit XX, dhe kryesisht përdorej nga turqit, shqiptarët dhe boshnjakët, gjer te zëvendësimi i alfabetit arab me alfabetin latin, që nisi në vitin 1908 me vendimin në Kongresin e Manastirit për zëvendësimin e alfabetit arab me alfabetin latin tek shqiptarët, me ç'rast aplikim zyrtar gjeti në Shqipëri nga vitet njëzeta të shekullit të kaluar, ndërsa në trojet tjera etnike shqiptare të

“

Në rruzullin tokësor jetojnë me qindra e mijëra popuj, kombe, grupe etnike e fise të ndryshme të cilët flasin me qindra e mijëra gjuhë, por për shkrim e lexim përdorin alfabetet e njëjta apo të përafërta. Sot në botë, janë në përdorim 40 alfabetet, prej të cilëve më të përhapur dhe më të njohur janë alfabeti latin, alfabeti kinez, alfabeti arab, alfabeti cirilik dhe alfabeti hebraik.



okupuara nga serbët, si në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, nuk u lejua përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe alfabetit latin, por u imponua si gjuhë zyrtare gjuha serbe dhe alfabeti cirilik.

Tek në vitin 1941 me ardhjen e mësuesve nga Shqipëria dhe hapjen e shkollave shqipe në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare filloi mësimi dhe përdorimi i alfabetit latin.

Në Bosnjë e Hercegovinë, u zyrtarizua alfabeti latin, krahas alfabetit cirilik në vitin 1918, me rastin e themelimit të mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe slovenëve apo e ashtuquajtura Mbretëria SKS-së.

Në Turqi zëvendësimi i alfabetit arab me alfabetin latin u bë vitin 1928 me reformat e gjithanshme të ndërmarra nga themeluesi i shtetit të sapokrijuar të Turqisë Mustafa Ataturku. Ky gjenocid kulturor i ndërmor kundër këtyre tre popujve autokton të Ballkanit, turqve, shqiptarëve dhe boshnjakëve, la pasoja fatale afatgjate, ashtu që brenda natës mbetën analfabet, pa shkrim e lexim, këta tre popuj, të cilët me qindra vitesh kanë përdorur alfabetin arab. Kjo i bie njëjtë, tani, në kohën e sotshme dikujt ti bie ndër mend prapë, të bëjë zëvendësimin e alfabetit latin të tanishëm p.sh. me alfabetin kinez.

Librat, bibliotekat, arkivat të tëra me alfabet arab të grumbulluara me qindra vite u zhdukën apo u eliminuan nga përdorimi i tyre, edhe ato shkrime dhe libra të mbetura në arkiva, tani, kanë mbetur të papërdorura, pasi vetëm një numër vogël i ekspertëve të tanishëm mund të hulumtojnë dhe deshifrojnë këto shkrime, dokumente, libra të ndryshëm të cilët kanë pasqyruar historinë qindraveqare të këtyre 3 popujve autokton të Ballkanit, turqve, shqiptarëve dhe boshnjakëve.

Sa për krahasim, të cekim, se në vitin 1911 Perandoria e atëhershme Osmane dhe Perandoria Japoneze kanë qenë përafërsisht në të njëjtën stad të zhvillimit ekonomik, politik, ushtarak, kulturor, e tani, pas një shekulli, është dallim i madh në mes tyre, e sidomos në zhvillimin ekonomik e industrial. Japonia renditet në krye të shteteve më të zhvilluara ekonomike të botës, por e cila ka ruajt me plot fanatizëm alfabetin e

saj tradicional, i cili nuk i ka penguar fare në zhvillimin e saj, e i cili është në përdorim zyrtar që nga koha e lashtë e gjer në ditët e sotshme, kundruall Turqisë, e cila tek tani është duke përjetuar një zhvillim të hovshëm ekonomik, e si pasojë e ngecjes përveç tjerash, ka qenë edhe zëvendësimi i alfabetit arab me alfabetin latin në vitin 1928, një nga reformat e shumta të ndërmarra në shtetin e ri turk. Poashtu e njëjta gjë ka ndodhur me popujt mysliman të okupuar nga rusët me kohë gjatë historisë, që për dallim nga alfabeti latin, atyre i është imponuar alfabeti cirilik në përdorim zyrtar, ashtu që edhe në ditët e sotshme në Federatën Ruse, popujt ndryshëm mysliman e përdorin alfabetin cirilik, e njashtu edhe në shtetet e sapokrijuara pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, si në Azerbajxhan, Kazakistan, Uzbekistan, Tyrkmenistan, Taxhikistan, Kirgistan, është në përdorim zyrtar alfabeti cirilik. Alfabeti arab edhe pse në shikim të parë, duket i vështirë, është i lehtë për shkrim e lexim, e sidomos është i njohur bukurshkrimi arab apo kaligrafia arabe e cila është e vetmja dhe e veçantë në rruzullin tokësor.

Alfabeti cirilik është i përhapur kryesisht në Azi dhe një pjesë të Europës, kryesisht te popujt sllav të rritit ortodoks. Në përdorim zyrtar është në Federatën Ruse, Bjellorusi, Ukrainë, Bullgari, Serbi, Maqedoni. Vëllezërit Kirili dhe Metodi janë themeluesit të alfabetit cirilik, i cili bazohet në alfabetin e vjetër grek. Për dallim nga alfabeti latin shkronjat e alfabetit cirilik janë më të theksuara. Poashtu përdoret edhe në shtetet myslimane të sapokrijuara pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik.

Alfabeti hebraik është i përafërt me alfabetin arab, daton nga shekulli III para epokës së re dhe se rrënjët i ka nga alfabeti arameik, të cilën hebrejët e përdornin që nga shekulli VI para epokës së re. Alfabeti hebraik shkruhet nga e djathta në të majtë, njëjtë sikurse alfabeti arab. Është në përdorim zyrtar vetëm në Izrael, ndërsa e mësojnë edhe hebrej anekënd nëpër botë, e ruajnë me një fanatizëm të rrallë, dhe se përdorimi i tij asgjë nuk i ka penguar hebrej në zhvillimin e tyre si në fushën ekonomike, politike, ushtarake të shtetit izraelit të sotshëm.

Libri i Kafsheve

Vepra me e rendesishme e Al-Xhahiz është Libri i Kafsheve (Kitab al-Hajauan) i cili edhe pse i pambaruar, është në 7 volume të medha. Permban informacion shkencor të vlerave të medha. Duke paraprire një numër të madh konceptesh të cilat nuk ishin zhvilluar plotësisht deri në gjysmën e shekullit të 20-te, Al-Xhahiz diskuton rreth semundjes së kafsheve, duke vënë në dukje që disa parazitë të adaptohen ngjyres së kafshes në të cilën qendrojnë, dhe shkruan me gjere për influencën që kanë klima dhe dieta mbi njeriun, bimët dhe kafshët e zonave të ndryshme gjeografike. Ai diskuton komunikimin midis kafsheve, psikologjinë dhe shkallën e inteligjencës tek insektet dhe kafshët. Ai jep një pershkrim të detajuar rreth organizimit shoqëror të milingonave duke përfshirë, nga observimet e veta, një pershkrim se si milingonat ruajnë ushqimin në foletë e tyre në një mënyrë të atillë që nuk prishet gjatë periudhës së shirave. Ai e dinte që disa insekte janë të ndjeshëm ndaj drites, dhe përdor këto informacione për të sugjeruar një mënyrë me të zgjuar për të larguar mushkonjat dhe mizat prej dhomes.

Al-Xhahiz shkruajti 200 vepra, me gjashtë të ndryshme, dhe me një larmishmeri tëzash. Nga keto, vetëm 30 vepra kanë mbijetuar deri në kohët e sotme, të cilat megjithatë janë të mjaftueshme për të treguar kuriozitetin që kishte autori. Al-Xhahiz e cilesonte botën fizike si një shenjë e dukshme e dëshirës së Zotit. Qëllimi i tij që shkruajti "Librin e Kafsheve" nuk ishte vetëm për arsyen e argetimit, por ishte për të udhëhequr lexuesit e këtij libri në një vlerësim të mrekullive të krijesave të Zotit, të cilat ai besonte se shfaqeshin si në insektet e përendesishme ashtu edhe tek kafshët me të medha: Une dua t'u tregoj që edhe një guralec provon ekzistencën e Zotit ashtu sic e provon edhe një mal, dhe trupi njerezor është një provë po aq e fortë sa edhe universi që permban të gjitha botët tona - për këtë qëllim të vegjël dhe të lehtë kanë po aq peshe sa edhe të rendet dhe të medhenjtë.

STUDIMI I VEPRAVE TË NATYRËS

"Në cdo gjeneratë dhe midis cdo shteti, gjenden disa individë të cilët kanë dëshirë për të studiuar veprat e natyres; neqoftese këta nuk do të ekzistonin, keto shtete do të zhdukeshin," ka shkruar Abu Uthman Amr ibn Bakr al-Kinani

“*Ne cdo gjeneratë dhe midis cdo shteti, gjenden disa individë të cilët kanë dëshirë për të studiuar veprat e natyres; neqoftese këta nuk do të ekzistonin, keto shtete do të zhdukeshin,***”** ka shkruar Abu Uthman Amr ibn Bakr al-Kinani al-Fukaimi al-Basri, i njohur me mirë me emrin al-Xhahiz, në librin e tij "Libri i Kafsheve."

al-Fukaimi al-Basri, i njohur me mirë me emrin al-Xhahiz, në librin e tij "Libri i Kafsheve."

Vetë Al-Xhahiz ishte një nga këta individë. Ai jetoi, për më tepër, gjatë atyre epokave kohore të historisë intelektuale - periudha e transferimit të shkencës greke tek arabët dhe zhvillimi i procesit arabe - dhe u përfshi nga të dyja keto levizje.

Lindi rreth vitit 776, 14 vjet pas themelimit të Bagdatit prej kalifit Abasit al-Mansur. Ai u rrit në Basra, e formuar gjatë kohëve të para të Islamit si një qytet garnizon por tashmë rival me një qytet tjetër me emrin Kufa, një qendër intelektuale.

Basra ndihmoi shumë në zhvillimin intelektual të al-Xhahiz. Ishte në këtë qytet që ai shkoi për herë të parë në shkollë - duke studiuar me disa nga dijetarët me të medhenj të Islamit. Edhe pasi emigroi në Bagdat ai asnjehere nuk e humbi dashurinë për vendin e vet; pasi jetoi për 50 vjet në Bagdat, ai u kthye në Basra ku edhe vdiq. Sipas disa legjendave ai vdiq si pasojë e peshes së rëndë të disa librave të cilat i rane persiper në vitin 868.

Megjithatë është vetëm një legjendë, kjo histori pershkruan një fakt shumë të rendesishëm rreth botes në të cilën al-Xhahiz jetoi. Megjithatë letra u prezantua në botën islame vetëm pak kohë pas lindjes së al-Xhahiz, në kohën kur ai ishte rreth 30 vjet letrë zëvendësioi pergamenen.

Mundësia e një materiali të lire shkrimi u shoqërua prej një tjetër fenomeni shoqëror, produkt i të cilit ishte edhe vetë al-Xhahiz: shtimi i njerezve që lexonin. Për herë të parë që nga kohët e Perandorisë Romake, qytetet e Lindjes së Mesme permbanin një numër të madh njerezish që dinin të lexonin.

Al-Xhahiz dhe prinderit e tij për shembull ishin të varfër; kur ishte në moshën 20 vjeçare ai shiste peshkë për gjatë një prej kanaleve të Basras. Megjithatë, al-Xhahiz mesoi të lexonte dhe shkruante në moshë të re. Al-Xhahiz tregon historinë se si nëna e tij e prezantoi atë me një fletë letrë me

shenime dhe i tha atij që do të ishte nepermjet këtyre mjeteve që ai do të jetonte.

Al-Xhahiz filloi karrierën e tij si shkruar duke qenë akoma në Basra. Ai shkruajti një ese rreth institucionit të kalifatit dhe që prej asaj kohe mbeshteti veten e vet vetëm nepermjet penës. Fakti që ai asnjehere nuk mbajti ndonjë post në qeveri i lejoi atij një liri intelektuale që ishte e pamundur për dikë të lidhur me gjykatën - megjithatë ai i perkushtoi një numër të veprave të tij vezireve dhe qeveritareve të tjerë të rendesishëm, dhe mori 5,000 dinare ari prej zyrtarëve të cileve ai u dedikoi "Librin e Kafsheve."

Gjatë jetës së tij të gjatë - ai jetoi 92 vjet - al-Xhahiz shkruajti 200 vepra, me gjashtë të ndryshme dhe me një larmishmeri tëzash. Prej këtyre, vetëm 30 kanë mbijetuar kohëve tona - por që janë të mjaftueshme për të treguar kuriozitetin e autorit. Al-Xhahiz ka shkruar "Mendjelehtësia dhe Serioziteti", "Arti i të mbajturit se gojëse dikujt mbyllur", "Mizerja", "Ushqimi i heret arab", "Lavderimi i Tregtareve", "Kunder Sherbetoreve Civile", "Meritat e Turqve", dhe ndoshta me e rendesishmja "Libri i Kafsheve."

Al-Xhahiz ishte vecanerisht i interesuar në stilin dhe shprehjen korrekte. "Stili me i mirë," thoshte ai në një ese rreth mesuesve të shkollës "është me i qarti, stili që nuk ka nevojë për shpjegime dhe shenime, që i pershtatet subjektit të shprehur."

Ky interesim në stil ishte një karakteristikë e një grupi të dijetarëve nga Basra, të cilët gjatë shekujve të 8-te dhe 9-te, deshën të ruanin trashëgiminë letrare arabe duke regjistruar poezinë dhe theniet e Beduineve të Gadishullit Arab. Kjo levizje kishte parashikuar rezultatet: si pasojë e interesimit të tyre antropologjik rreth gjuhës dhe zakoneve të Beduineve, dhe në kushtet shoqërore të Arabisë gjatë periudhës para-islame dhe asaj islame, dijetarët e Basras arritën të vleresonin gramatiken e gjuhës arabe dhe poezinë para-islamike. Ata vazhduan të shkruanin komen-

time të sofistikuara të Kur'anit, edicione kritike dhe traktate rreth gramatikes, dhe të perpilonin fjalorë dhe lista fjalësh të specializuara.

Një mjeshtër i këtyre rregullave, al-Xhahiz ishte një nga shkruarët e parë arabe që përpunoi të gjitha shqetësimet e ndryshme të shkollave Basrane - gramatike, traditën profetike, retorike, leksikografi, dhe poezi - në një "literaturë"- që është, krijime në prozë për t'u lexuar prej jo specialistëve për kënaqësi dhe udhezim.

Rreth vitit 815, vetëm dy vjet pas formimit të Shtepisë së Diturisë, al-Xhahiz u transferua në Bagdat. Aty ai u ekpozua ndaj një influencë të re dhe të rendesishme: shkencë greke, vecanerisht mendimi Aristotelian. I terhequr prej teologjisë shkollorë, ai me pas përdori metodën dialektikore në shumë nga veprat e tij, zakonisht me qëllime humoristike.

Al-Xhahiz zhvilloi një stil shumë personal dhe karakteristik, i cili shkrinte anekdotën, subjektet serioze dhe shakane, në një përpjekje për të mbajtur interesin e lexuesve. Ai e pershkruajti stilin e vet duke thënë:

Librat e mi mbi të gjitha permbajnë anekdotë të pazakonshe, fjale të urta dhe thenie të shprehura shumë bukur të transmetuara prej shokëve të profetit, thenie të cilat çojnë drejt përvetësimin të cilesive të mira dhe kryerjes së punëve të mira ... ato gjithashtu permbajnë histori rreth sjelljeve të mbretërve dhe kalifave dhe ministrave të tyre, dhe gjithashtu ngjarjet me interesante nga jeta e tyre.

Në Bagdat, al-Xhahiz jo vetëm që shkriu shkencat islame me racionalizmin grek, por krijoi prozën arabe. Ai tregoi që gjuha arabe ishte aq fleksibel sa cdo temë mund të trajtohej me lehtësi, dhe megjithatë ai nuk ishte personalisht i shoqëruar me Shtepinë e Diturisë, arritjet e tij gjuhësore ishin paralele - në fakt tejkaluan - përpjekjet e dijetarëve që përpjekeshin të perkthenin tekstet shkencore greke në gjuhën arabe. Veprat e tij vertetoheshin përhapjen e theksuar të ideve greke midis lexuesve të zakonshëm. Ashtu si në rendesinë e subjektit edhe në fjalor ai konsideronte një ngjashmëri me Aristotelin terminologjinë teknike të teologjisë skolastike. Ai tregon shumë anekdotë të dijetarëve të Shtepisë së Diturisë, shumë prej të cileve duket se kanë qenë shoket e tij.

Libri që ilustron me mirë metodën e tij është "Libri i Kafsheve" i

cili edhe pse i paplotesuar, perbehet prej 7 volumesh te medha. Libri i Kafsheve nuk eshte ne asnje menyre zoologji konvencionale. Eshte nje koleksion i panumert faktesh rreth kafsheve - perfshire edhe insektet - te permendura prej Kur'anit, tradites se profetit, poezise se kohes para-islame, rrefimtare, lundertare, obzervime personale dhe vepres se Aristotelit, Gjenerata e Kafsheve. Duke i'u permbajtur teorise se tij se cregulimit te planifikuar, ai prezanton anekdota te njerezve te famshem, copeza historie, antropologji, etimologji dhe shaka. Shumllojshmeria e habitshme e permbajtjes se saj ka frikesuar gjithmone perkthyesit dhe me vone historianet. Al-Damiri i cili jetoi ne shekullin e 14-te dhe shkruajti nje enciklopedi te njohur te titulluar "Jetet e Kafsheve", perdorte shume nga informacioni shkencor dhe gjuhesor te marre prej al-Xhahizit, por eliminonte anekdotat, poezine, dhe shakate.

Cilesia letrare e Librit te Kafsheve nuk duhet te erresoje faktin qe permbante informacion shkencor te nje vlere te madhe. Duke parashikuar nje sere konceptesh te cilat u zhvilluan plotesisht ne kohen e Darvinit dhe pasardhesve te tij, al-Xhahiz diskuton mimiken e kafsheve, duke vene ne dukje qe disa parazite i adoptohen ngjyres se kafsheve ne te cilat ato qendrojnë, dhe vazhdon duke shkruar gjesisat rreth influences se klimes dhe dietes mbi njeriun, bimet dhe kafshe te zonave te ndryshme gjeografike. Ai madje futet edhe ne komunikimin midis kafsheve, psikologjine e tyre dhe graden e inteligjences tek insektet. Ai jep nje llogari te detajuar te organizimit shoqeror te milingonave duke perfshire nje perskrim se si ato e ruajne ushqimin e tyre ne fole ne nje menyre te atille qe nuk prishet gjate periudhes se shi-

rave. Ai e di qe disa insekte nuk mund ta durojne dot driten dhe e perdor kete informacion per te sugjeruar nje menyre te mcur per te larguar mizat dhe mushkonjat prej dhomes.

BOTA FIZIKE ËSHTË SHENJË E ZOTIT

Sherbimi i tij me i madh, ishte ndoshta ne popullarizimin e shkences dhe metodat racionale, dhe deshimi qe njeriu i shkolluar mund te preokupoje veten me cdo subjekt. Si nje musliman i devotshem, al-Xhahiz e cilesonte boten fizike si nje shenje te dukshme te deshires se Zotit. Qellimi i tij ne shkruarjen e Librit te Kafsheve nuk ishte thjesht per te argetuar por ishte edhe per te udhehequr lexuesit e tij drejt nje vleresimi te mrekullive te krijesave te Zotit, gje qe ai mendonte se shfaqej si ne me te parendesishmet ashtu edhe ne ato me permasa te medha:

Dua t'ju tregoj qe nje guralec provon ekzistencen e Zotit (Allah) po aq sa edhe nje mal, dhe trupi njerezor eshte prove po aq e forte sa edhe universi qe permban botet: per kete qellim me i vogli dhe me i lehti ka po aq peshe sa edhe me i madhi dhe me i rendi.

Fatkeqesisht vetem nje pjese e veprave te tij i kane mbijetuar viteve, por ato qe na bejne neve te pendohe mi me teper jane ato qe kane humbur. Se bashku ato prezantojne nje portret te gjalle te Bagdatit dhe Basras gjate Kohes se Arte te Islamit. Ai shkruan per vajza qe kendojne, vagabonde, dijetare, teologe, kalife dhe vezire, dhe nje paraqitje e detajuar e jetes se perditshme e Irakut te shekullit te 9-te mund te nxirrej nga veprat e tij. Me me rendesi eshte qe ai na komunikon neve shqetesimin e nje jo-specialisti inteligjent te perballuar me nje shkence radikale, spekulimet filozofike dhe

teologjike.

Ne te njeten kohe, al-Xhahiz mbeshteti disa aspekte te traditave greke, prej te cilave ai permendte Aristotelin. Ai kishte besim ne metodat shkencore dhe logjiken dhe arsyen e aplikuar ndaj disa fenomeneve te vrojtuar. Duke dashuruar nje histori te mire, ai asnjehere nuk mund ti rezistonte kalimit ne perrallat absurde te lundertareve dhe Beduineve.

Kjo mungese e nje plani racionel, nje karakteristike e puneve te tij, mund te kene qene pjeserisht e paramenduar, meqenese frika e tij me e madhe ishte te merziste lexuesin. Kjo nuk do te thote qe ai asnjehere nuk ka qene serioz ne veprat e tij por qe ne veprat e tij me te medha, serioziteti dhe humori kane qene te nderthurura; ndonjehere eshte e veshtire te dallohet kur ai eshte duke bere shaka dhe kur jo. Eshte gjithashtu e veshtire te gozhdosh al-Xhahiz ne nje teze te caktuar, sepse ai kishte shume deshire te prezantonte debate midis dy klasave shoqerore - dijetareve dhe tregtareve, mushkave dhe kuajve - debate ne te cilat meritat e cdokujt parakalojne perpara lexuesit. Edhe ajo qe vete autori mendon ndonjehere nuk eshte shume e qarte, dhe eshte e mundur qe ne keto dialoge ai ishte vecanerisht i interesuar ne tregimin e aftesive te veta duke marre te dyja anet e argumentit.

Ai i donte shume librat dhe "Libri i Kafsheve" fillon me nje paragraf te gjate ne lavderimin e tyre. Ai do te merzitej ne qofte se do te mesonte qe shume prej librave te tij jane zhdukur, por do te kenaqej me doreshkrimin nga i cili jane marre edhe keto materiale qe jane paraqitur ne kete artikull.

Ky doreshkrim i cili eshte i shekullit te 14-te eshte zbuluar ne librarine e Ambrisianes ne Milano ne vitin 1939 prej dijetarit

suedez Oskar Lofgren. Ky dokument ra rastesisht ne duart e tij, pasi nuk ishte ne katalogun e doreshkrimeve ne Ambrosiana, katalog ky i bere prej von Hamer ne vitin 1893. Ai e cilesoi tekstin si nje fragment te Librit te Kafsheve. Doreshkrimi nuk eshte vetem fragmentar por edhe i crregullt. Nje shenje pronies ne fleten e fundit shkruan qe kur doreshkrimi kaloi ne duart e nje-fare Abdul'Rahman al-Magribi ne vitin 1615, kishte 94 faqe, keshtu qe edhe ne ate date doreshkrimi nuk ishte i plote. Nuk dihet se kur dhe se si Libraria e Ambrosianes gjeti doreshkrimin.

Doreshkrimi i Ambrosianes eshte shume i rendesishem. Eshte shume e qarte qe eshte kopjuar nga nje shkruer i edukuar i cili ka treguar zanoret - qe zakonisht nuk shkruhen ne gjuhen arabe - gje qe e ben tekstin te kuptohet me saktesisht. Kjo eshte shume e rendesishme meqenese vetem pak doreshkrime te Librit te Kafsheve mbijetojne, dhe doreshkrimi i Ambrosianes eshte nga me te hershmit prej tyre. Akoma me e rendesishme se sa teksti, jane miniaturat e shkelqyera qe e ndricojne. Doreshkrime te ilustruara ne arabisht te cfaredo lloji jane shume te ralla, dhe kjo eshte kopja e vetme e nje vepre prej al-Xhahiz. Nje shfaqje e viteve te sotme rreth artit mamluk ne Galerine Freer ne Uashington prezantoi publikun amerikan me madheshtine e artit islam gjate dinastise se mamlukeve. Stili i miniaturave arrin te kape gjenden shpirtore te prozes se al-Xhahizit, ato jane te gjalla, shumengjyreshe, dhe me humor. Al-Xhahiz do ti pelqente keto miniatura vecanerisht duke qene ne dije per admirimin e arteve piktoreske te bizantineve dhe kinezeve - te cilat ai i permend ne Librin e Kafsheve.



ATOMI

Muhamet T. Sheqiri

Demokriti në shekullin -V- (460 p.e.s.- 370 p.e.s.) ka paraqitur tezën e tij mbi atomin e cila njihet si hipoteza e atomit si thërrim e pandashme. Edhe vet termi atomos, rrjedh nga gjuha greke që d.m.th i pandarë.

HISTORIKU I SHKURTËR MBI ATOMIN

Hipotezë të ngjajshme kishte dhënë edhe Lukrecie në shekullin -I- të epokës së re, e cila u emërtua si hipoteza e atomit si thërrim e pandashme. Këto hipoteza, si të Demokritit ashtu edhe të Lukrecies ishin hipoteza të mangëta për ta shpjeguar qartë definicionin mbi atomin dhe si të atilla ishin të paqarta dhe jo të

“Tendencat për ta sqaruar natyrën e atomit, strukturën e tij si dhe dhënien e një teorie mbi të vërtetën e atomit vërehen që nga kohërat e lashta, duke filluar që nga grekët e vjetër. Talkini është element që në asnjë mënyrë dhe në as një rast nuk konfrontohet me besimin tradicional islam. por për kundërazë është i dobishëm dhe vërtetohet nga faktet tradicionale islame

plota. Teori mbi atomin kanë dhënë edhe shkencëtarë të tjerë të ndryshëm si F. Bacon, R. Boyle dhe Isac Neewton si shkencëtarë të shekullit XVII.

Po ashtu në vitin 1801 John Dalton gjithashtu e kishte dhënë një përkufizim lidhur me atomin sipas të cilit del se atomet janë thërrmija diskrete të pandashme

të cilat nuk mund të ndahen nga proceset e njohura kimike”.

Nga zbulimet e mëtejshme që janë bërë në fushën e fizikës dhe të kimisë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, del se atomi si thërrim e pandarë hidhet poshtë.

Këto zbulime ndikuan në rënien e pikëpamjeve dhe

hipotezave të grekëve të lashtë si Demokriti e Lukrecie, por ato njëkohësisht ndikuan edhe në rënien e pikëpamjeve të Daltonit në vitin 1801.

Zbulimet që janë bërë në shekujt XIX-XX kanë treguar qartë se atomi nuk është thërrmija më e vogël ashtu siç ishte menduar deri në atë kohë, por ai





është thërrmi e përbërë nga shumë thërrmija të tjera (grimca) subatomike.

Sipas zbulimeve, pikëpamjeve dhe të arriturave bashkëkohore shkencore del se atomi përbëhet nga bërthama atomike e cila është shumë e vogël dhe ndodhet në qendrën në të cilën është e përqendruar tërë masa atomike dhe është e rrethuar nga elektronet të cilat sillen rreth bërthamës në një rrugë të përkufizuar.

Në Kuranin famëlart thuhet ``...Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe...``. (suretu -junus-61)

Allahu xh.sh. është ai që e shpalli Kur'anin si libër Hyjnor për njeriun në tokë dhe për qartësimin e shumë gjërave që e rrethojnë njeriun në këtë botë e njeriu nuk ka mundësi t'i shohë të gjitha gjërat me përjashtim të atyre që Zoti nga mëshira e tij e madhe i'a ka mundësuar që t'i shohë. Allahu Krijuesi ynë, Krijuesi i gjithësisë, por edhe krijues i atomeve (grimcave) e qartëson në Kur'anin famëlartë se çka në të vërtetë është atomi?

Allahu në Kur'an jep përgjigje për çdo gjë për ata që kanë mend.

Allahu në Kur'anin famëlartë na tregon se në gjithësinë që na rrethon ekzistojnë grimca apo atome siç quhen në shkencën bashkëkohore dhe njëkohësisht jep një teori mbi atomin dhe strukturën e tij të brendshme, jep përgjigje për njeriun shkencëtar,

por edhe për njerëzit e rendomtë, në mënyrë që ata të kuptojnë rëndësinë e krijimit të tyre, dhe rëndësinë e krijesave që janë në shërbim të tyre (njerzimit).

Në shkencën e kimisë ku flitet për atomin thuhet se atome ka në tokë e në qiell, por gjithashtu thuhet edhe se atome ka edhe në ato vende ku ne mendja nuk na shkon fare se mund të ketë diçka të atillë.

Nga pikëpamja fetare dhe të dhënat shkencore del se çdo gjë e krijuar në këtë botë është në përputhshmëri të plotë me fjalët Kur'anore sepse, Zotit nuk mund t'i fshihet asgjë, as në tokë e as në qiell as grimca më e vogël se atomi.

Në Kur'an dëshmohet në njërën anë për fuqinë e Zotit e cila manifestohet në çdo fenomen jetësor (krijes) dhe në anën tjetër për ekzistencën e grimcave (atomeve) në tokë e në qiell të krijuara për të dëshmuar fuqinë krijuese të Allahut fuqplotë.

Nga kjo pikëpamje ne arrijmë të kuptojmë se çdo fjalë e Kur'anit në vetën e vet përmban kuptime që vlejnë për çdo kohë, për çdo vend dhe për çdo njeri, fjalë me karakter të lartë dhe kuptim të gjër.

Njeriu me mend magjepset kur i sheh mrekullitë e krijuara nga Allahu xh.sh.

Allahu xh.sh. në fillim të Kur'anit e përmend qartë ekzistimin e grimcave (atomeve) në tokë e në qiell duke e dëshmuar kështu fuqinë e Tij.

Kur'ani e përshkruan në këtë mënyrë, të ekzistuarit e grim-

cave (atomeve) në një pjesë të ajetit kuranor: ``...as sa grimca e as ma e vogël se ajo...`` qëllimi apo objekti i kësaj pjesë të ajetit Kur'anor është që të jipet përgjigje mbi atomin dhe njëkohësisht të tregojë funksionalitetin apo strukturën e tij.

Shikuar nga pikëpamja teorike shumë nga shkencëtarët bashkëkohorë e definojnë atomin si grimcë të përbërë nga shumë grimca të tjera që nënkupton se janë në përputhshmëri të plotë me fjalët Kur'anore si dhe janë teori që janë me kuptim të njëjtë me fjalën Kur'anore, por dallojnë në aspektin gjuhësor dhe nga kjo del se pas shumë përpjekjeve ndoshta me shekuj të tërë për të përcaktuar teorinë mbi atomin shkencëtarët vijnë në përfundim identik me thënien Kur'anore se ``... as sa grimca e as ma e vogël se ajo ...`` dhe nga analiza e këtyre fjalëve apo zbërthimi i tyre del se grimca që përmendet në ajet është atomi dhe më të vegjël se atomi janë bërthamat dhe elektronet që sillen rreth tij. Ky është një zbërthim që ka të bëjë me të arriturat shkencore dhe pikëpamjet bashkëkohore mbi atomin. Allahu xh.sh. bukur e ka sqaruar në Kur'an këtë çështje me fjalë të pakta, por me shumë kuptime duke e përmendur në radhë të parë, grimcën në tërësi (atomin) e pastaj bërthamën e atomit apo elektronet që sillen rreth tij.

Shkenca bashkëkohore thotë se; vëllimi i bërthamës së atomit është sa 1/10000 e atomit që

nënkupton se është shumë më e vogël se atomi në përgjithësi.

Me shekuj e vite shkencëtarët janë përpjekur që ta definojnë se çka është atomi?

Ka shumë shkencëtarë e filozofë të cilët japin mendime për këtë grimcë të vogël atomi. Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë e sqaron në mënyrë të drejtë dhe precize çdo çështje. Shumë shkencëtarë dhe filozof grekë u përpoqën që ta definojnë teorinë mbi atomin, por teoritë e tyre nuk u përkrahën nga shkenca bashkëkohore dhe si të tilla u hodhën poshtë sepse, ishin të pasakta dhe nuk përkonin me të arriturat e shkencës bashkëkohore e cila të arriturat e veta i kishte bazuar dhe edhe sot e kësaj dite i bazon në Kur'anin famëlartë në të cilin shkenca zë një vend të veçantë.

Ç`KA NA MËSOJNË FJALËT KUR`ANORE DHE TË ARRITURAT SHKENCORE:

Të gjitha të arriturat shkencore që nuk dyshohet në vërtetësinë e tyre janë vërtetuese se Kur'ani famëlartë është e padiskutueshme se është zbritje prej Allahut xh.sh. dhe kjo është esenca, thelbi i këtij shkrimi, sepse 13 shekuj pas zbritjes së Kur'anit shkenca arriti vetem në atë nivel që ta dëshmon vërtetësinë e fjalëve të Kur'anit famëlartë për këtë çështje, të cilën çështje Kur'ani e zbërthen më një pjesë të ajetit apo me pak fjali, kjo është një nga shumë mrekulli të Kur'anit.

Fetarësia e Barack Obamës model edhe për liderët shqiptar

Emine A. Vezaj

Të gjithë ata që kanë përcjell telenovelën e udhëtimit të Barack Obamës ashtu sikurse edhe unë, kam përshtypjen se qenë dëshmitar të liberalizmit amerikan në përzgjedhjen e një udhëheqësi nga radhët e amerikanëve me anamnezë afriko - amerikane, por gjithsesi i vërtetuan me këtë përzgjedhje botës demokratike se Amerika ka potencial dhe mirëpret të gjithë ata që punojnë për mirëqenie të gjithëmbarshme. Piter Robinson si ish shkruesi i fjalimeve në Shtëpinë e Bardhë, ardhjen dhe inaugurimin e presidentit të parë afrikan - amerikan, e cilësoi në të njëjtën kohë edhe historik, për shkak se vuri në pah mirësinë e demokracisë amerikane. Barack Obama përveç kësaj shënoi në historinë e re edhe një eveniment tjetër të rëndësishëm, ai u bë presidenti i tret që bëri betimin për të dytën herë si President i Amerikës. Kjo ndodhi sepse gjatë ceremonisë në shkallët e Kapitolit, Xhon Roberts aksidentalisht ndryshoi radhitjen e fjalëve gjatë administrimit të betimit, me ç'rast tha: "Unë do të ushtroj funksionin e kryetarit të ShBA'së me besnikëri", në vend të renditjes "Unë me besnikëri do të ushtroj funksionin e kryetarit të ShBA'së". Për këtë shkak Obama bëri betimin e dytë. Presidenti Obama nuk është presidenti i parë që ka përsëritur betimin. Në të kaluarën këtë e kanë bërë edhe presidentët e tjerë si Calvin Coolidge dhe Chester Arthur.

BEKIMI

Ndalesa e parë e çiftit Obama para mbërritjes në Shtëpinë e Bardhë ishte kisha Saint Johns, pranë Shtëpisë së Bardhë. Në këtë kish, Barack dhe e shoqja e tij Michele morën pjesë në një shërbesë fetare. Ajo quhet ndryshe edhe kisha e presidentëve pasi ndalesa atje është traditë para inaugurimit. Në anën tjetër duket se fetarësia e Barack Obamës do të vërehet edhe në ditën e parë të punës së tij në Shtëpinë e Bardhë. Para se të filloj ditën me punë, zt. Obama fillimisht mbajti një mesh ku të pranishëm përpos besimtarëve katolik, protestant, kishte

“ *"Askush s'mund ta kuptoj njerëzimin pa kuptuar së pari fenë e tij, sepse feja përfshin jetën e njeriut prej kohës më të lashtë"*. Ninuan Suart



edhe disa prijës - lider shpirtëror mysliman, ku me këtë rast Obama mori edhe një herë bekimin e famullitarit të Shtëpisë së Bardhë, i cili e bekoji për punën e tij në vazhdimësi. Sa i përket fjalimit të dhe para vendosjes së Barack Obama në Shtëpinë e Bardhë, në fjalimin e tij i cili për disa do të duhej mbajtur në mend, e për disa nuk kishte gjë të vlefshme, ishte vërtet mbresëlënëse një citat i marrë nga Bibla. Në mes tjerash në atë fjalim thuhej "...sipas fjalëve të Biblës, ka ardhur koha për të lënë mënjanë sjelljet fëmijërore. Ka ardhur koha të riafirmojmë shpirtin tonë të fuqishëm, të zgjidhim një histori më të mirë, të çojmë përpara atë dhuratë të çmuar, atë ide fisnike, të trashëguar nga brezi në brez. Premtimin e Zotit se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë, të gjithë janë të lirë dhe të gjithë meritojnë shansin të jenë plotësisht të lumtur".

Të gjithë jemi të njohur se Amerika dhe shumica e vendeve në Botë janë në një sistem laik (sekular) ndërsa betimi në Librin e shenjt është pjesë e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Në anën tjetër e çuditshme se ky laicizëm i Amerikës nuk është transparent edhe aq sa duhet në institucionet përkatëse, dukshëm vërehet një fetarësi e amerikanëve. Përderisa në dollarin amerikan është mbishkrimi "In God we trust" - (Ne besojmë në Zot) dhe derisa betimi i presidentëve pararendës dhe i presidentit të sapo inauguruar bëhet në Bibël (e përdorur nga Abraham Lincoln në inaugurimin e tij në vitin 1861) atëherë çfarë do të thotë kjo? Mos ka ndonjë histori sekrete ky betim?! Sipas historianit Marwin Kranz; "Prania e Biblës gjatë betimit nuk është e domosdoshme, por një traditë e trashëguar që nga Xhorxh Washingtoni, të cilën e kanë ndjekur edhe shumë president". Cilado qoftë arsyeja e betimit, mjafton të kuptojmë të gjithë se edhe superfuqitë më të mëdha kthimin e kanë të burimi Hyjnor.

Rrjedhimisht, gjatë leximit të librit të Barack Obamës "Guxim për të shpresuar" është edhe një kapitull i librit i emërtuar "Feja". Përshtypja ime nga kjo pjesë e librit është shkëputja e një realiteti amerikan të cilin e jetësova edhe

unë për tre javë në disa qendra të Amerikës. Në vijim tekstualisht do të doja të informoj edhe lexuesin se opinioni i Barack Obamës ishte po ai që unë kisha nxjerr në tre javorësh'in tim atje. E favorshme të përmendet është paraqitja dhe mënyra aderimit që bëjnë intelektualët amerikan në një parti. Gjithnjë sipas Obamës; "Ndërkohë, dallimi më i madh që bëjnë amerikanët e bardhë kur vjen puna për regjistrimin në parti, nuk është ai gjinor - midis grave dhe burrave - as ai midis atyre që jetojnë në shtete e kuqe (e kuqja nënkupton animin nga republikanët) dhe atyre që jetojnë në shtete blu (blu'ja nënkupton animin nga demokratët), por midis atyre që shkojnë në kishë rregullisht dhe atyre që nuk shkojnë". Duke shkuar më tutje në këtë përshkrim zt. Obama vë në dukje edhe këtë aventurë të amerikanëve "Duket se çdo ditë amerikanët kryejnë punët e tyre të zakonshme - çojnë e marrin fëmijët në shkollë, shkojnë në zyra e punesa të ndryshme, i hipin avionit për të shkuar në një takim biznesi, bëjnë pazar në hipermarkete, mundohen të mbajnë dietë - por mendojnë se diçka iu mungon. Ata po arrijnë në përfundim se pasuria e tyre, gjithë sa kanë, argëtimi, bizneset gjigante, nuk mjaftojnë. Ata duan të ndjejnë se e kanë një qëllim në jetë, diçka që t'i shpëtojë nga vetmia kronike apo që t'i lartësojë e shkëpus nga stërmundimi i zakonshëm. Ata kanë nevojë të sigurohen se dikush kujdeset për ta, i dëgjon ata - se ata nuk janë të destinuar të ecin në një rrugë të gjatë që të çon drejt hiçit".

Tani, natyrshëm më duhet të shtroj një këso pyetje, a mund të kemi edhe ne shqiptarët një Obama shqiptar i cili do të ruaj tablonë e identitetit të tij? Mbase asgjë nuk është e pabesueshme, të gjithë ata që janë pjesë e politikës janë pjesë e planetit tokë, asnjëri prej tyre nuk na ka befasuar dhe nuk presim të na befason me ndonjë karakteristik ose veçori mbi njerëzore. Dhe duke qenë se të gjithë liderët tanë burojnë dhe ushqehen me realitetin shqiptar, ata natyrshëm edhe mbartin në vete realitetit pozitiv dhe negativ të kësaj shoqërie.

Sa do të donim që edhe ne shqiptarët të shihnim ndonjëherë liderët tanë institucional teksa i shtrijnë duart e bashkimit dhe urimit në ndonjë festë fetare në ndonjë objekt fetar (përfshijmish institucioneve zyrtare), p.sh xhamit, pasi pashmangshëm deshën apo nuk deshën ata, "mbulohen aksidentalisht me një identitet islam. Të nisur nga historia e shumëpërfolur, e presidentit të ndjerë të Kosovës Ibrahim Rugova, dhe identitetit të tij, jemi të detyruar në një farë forme që të bëjmë publike edhe një herë simpatinë e tij për krishterimin. Pa mos harruar asnjëherë edhe dishepujt e tij, duke përfshirë këtu edhe homologët e të ndjerit të cilët edhe më tutje vazhdojnë të ushqejnë



urrejte dhe antipati për identitetin e tyre islam.

PËRGJEGJËSIA

Asnjëherë nuk kemi bërë tifoza-lëk për Barack Obamën e për ta futur në radhët e myslimanëve, me gjithë se ka një bagazh të dhënash për një identitet gjysmë mysliman e gjysmë katolik, por ne çdoherë dimë të përkrahim njerëzit e punës dhe të vlerave të larta. Të jesh lider do të thotë të kesh përgjegjësi edhe për të tjerët. Barack Obama, hyri në histori tani edhe ndoshta për një fjalim më të butë karshi botës islame - kishte kohë që bota islame nuk e kishte dëgjuar nga një lider amerikan fjalime të tilla, mbase kanë një përjetim të hidhur me pararendësin e tij, Xhorxh Bushin! Pas vizitës dy ditore që Obama i bëri Evropës, në ndalesën e tij në Turqi, fjalimi e tij në mes tjerash theksonte: "Nuk dëshiron që marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara me botën myslimane të definohen nga lufta kundër Alkaidas" se "Shtetet e Bashkuara nuk janë në luftë me Islamin". Ç'është e vërteta Obama e ka cilësuar Turqinë si urë lidhëse mes Perëndimit dhe myslimanëve. "Te ecim përpara me jep besimin se ne jo vetëm që do të përmirësojmë marrëdhëniet tona, por do të krijojmë strategji për të

ndërtuar urën, që mund të lidhë botën myslimane me perëndimin, që mund të na bëjë më të begatë dhe më të sigurt", shtoi Obama. Krenarin e identiteti të tij presidenti Obama nuk e fshehu as në vizitën e tij që e bëri në Irak. Duke e cilësuar vetveten si njëri që në familjen e tij ka edhe mysliman, dhe se në një farë forme tregon edhe liberalizmin amerikan. Ai nuk heziton ta thotë edhe këtë "Mendoj se njerëzit u nxitën të zgjedhin dikë si unë, që ka jetuar një pjesë të kohës përtej oqeanit, që ka mysliman në familjen e tij, pasi besojnë se mund të ndërtojnë ura me pjesët e tjera të botës", përfundoi Obama në fjalimin e tij përcjell popullit arab.

Megjithëse do të duhej ndërgjegjësuar edhe liderët tanë se mozaiku i trashëgimisë tonë kulturore dhe identiteti ynë islam është shenjë e forcës e jo dobësisë. Nuk kemi as dyshimin më të vogël se përkatësia tri fetare, përpos se e bënë më të pasur dhe më të përbërë, mund ta bëjë edhe më të plagosshim identitetin ton kombëtar shqiptar, dhe natyrisht, nëqoftëse ndonjëra prej këtyre feve do të favorizohej veçantë prej institucioneve politike e shtetërore, siç edhe bëhet kohë pas kohe sot. Të dhënat të cilat dëshmojnë se shqip-

tarët i takojnë qytetërimit islam e që lehtësisht vërehet në dëshmitë dhe të dhënat historike, etnografike, kulturore, gjuhësore etj. Mënyra e jetës së pjesës më të madhe të qytetarëve shqiptar, arkitektura e qyteteve dhe fshatrave, objektet e kultit, veshjet popullore, këngët dhe vallet, kuzhina, ceremonitë rreth lindjes dhe martesës, ritualet e varrimit, dëshmojnë, për më tepër se qytetërimi islam është më i shtrirë në jetën e shqiptarëve se sa ai katolik. Të mëtohet se feja islame si fe e shumicës është pengesë për integrimin e Kosovës, Shqipërisë e Turqisë në Bashkimin Evropian do të thotë të bëhesh propagandist fetar a politik fetar, që nuk e thotë të vërtetën dhe nuk i kontribuon bashkëjetesës dhe harmonisë fetare. Ne nuk mohojmë se jemi një vend me mysliman e krishterë dhe të gjithë së bashku kontribuojmë për një mirëqenie të gjithëmbarshme, por edhe kërkojmë nga liderët tanë që këtë përgjegjësi tonën ndaj vendit ton ta shpërblejnë së paku dy herë në vit, me shkuarjen në xhami për ndonjë festë (Bajram ose Ramazan) ose ndonjë kulti tjetër ku ata ndihen më komod me përkatësinë dhe identitetin e tyre fetar.

Roli mobilizues i fesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit

Prof. Dr. Muhamet Pirraku

Për ta kuptuar më drejtë problemin e shtruar, duhet të vëmë në spikamë faktin historik se: Nxënia (uniteti) fe-kombësi në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe të formimit të shteteve nacionale kudo në Evropë, ka qenë Një dhe e pandashme, sikurse edhe në të gjitha luftërat nacionalçlirimtare. Ndaj, nga kjo nuk mund të ishte i privuar as populli shqiptar, veçanërisht kur dihej se në rrethana të robërisë nën akëcilin pushtues ballkanik ortodoks apo evropian katolik, pjesës absolute të kombit shqiptar i rrezikoheshin të dyja, feja dhe kombësia. Dhe, kur të kihet parasysh fakti se shqiptarët myslimanë arrinin mbi katër të pestat e numrit të përgjithshëm të shqiptarëve, del qartë se kombi shqiptar realisht ishte komb mysliman, ndaj është plotësisht logjike pse forcën mendore dhe ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e përbënin shqiptarët myslimanë.

KOMITETI I PRIZRENIT

Nga burimet e sigurta dihet se në themele të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit qëndron "Komiteti i Prizrenit" i ngritur nga fundi i vitit 1877, në krye me Myderriz Ymer Prizrenin. Këtë Organizatë politiko-ushtarake shtypi i Evropës i fillimit të vitit 1878, e kualifikoi si "Lidhje të Rrezikshme Shqiptare". Për këtë fakt fliste edhe konsulli i Greqisë në Shkodër, Mavrommati, më 18 shkurt 1878.

Fitorja ruso-ortodokse në të ashtuquajturën Lufta Ruso-Turke të vitit 1876/77, do të kurorëzohet me Traktatin e Shën-Stefanit të 3 marsit 1878, në dobi të interesave të pansllavizmit. Copëtimi ndërkombëtar evropiano-rus i rreth dy të tretave të Njësisë etnokulturore e gjeopolitike të Shqipërisë për interesa të Serbisë, të Malit të Zi, të Bullgarisë dhe të Greqisë, përpos rrezikimit të qenies shqiptare të banorëve rrezikonte qenin Islame të shumicës absolute të kombit shqiptar, dhe kulturën shqiptare të



proveniencës myslimane, e cila realisht ishte faktori integrues historik i kombit shqiptar. Traktati i Kongresit të Berlinit i pajtoi interesat midis botës së krishterë ortodoksisë e katoliko-protestante, por ndau për Malin e Zi, Serbinë dhe Greqinë mbi një të tretën e Njësisë Etnokulturore e Gjeopolitike të Shqipërisë, toka këto kryesisht të banuara me shqiptarë myslimanë.

Për themelimin e këtij realiteti historik politik dhe ushtarak kombëtar shqiptar, kundër vendimeve të Traktatit të Shën-Stefanit, pati rol vendimtar inteligjencia shqiptare islame; myderrizët, mualimët, hoxhallarët, shehlerët e efendilerët. Konsulli gjerman në Vjenë, më 1 prill 1878, i shkroi kancelarit Bismark se "Shqiptarët janë shumë të shqetësuar dhe se pritet ndonjë Kuvend i tyre i madh, i cili do të kërkojë autonomi dhe pavarësi nga Turqia" dhe i paralajmëronte se "së shpejti do të bëhet bashkimi i shqiptarëve". Konsulli anglez Kirby Green në Shkodër, më 3 maj 1878, duke pasqyruar lëvizjen e rezistencës shqiptare në viset: Plavë - Guci - Beranë - Graniq, dhe në shumë vise të tjera të Shqipërisë Veriore

përballë Malit të Zi sllav ortodoks, konstatonte: "Lidhja ka depërtuar në mes të myslimanëve, duke i lidhur kolektivisht dhe individualisht për të rezistuar deri në vdekje, të gjitha përpjekjet, pa marrë parasysh a janë ato përpjekje të jashtme ose të Portës, përpjekje këto që duan ta ndryshojnë gjendjen e tanishme të territorit të tyre".

Konsulli Green e informonte Londrën se po realizohej përpjekja shqiptare për bashkimin e organizimeve, të lidhjeve krahnore, në një Lidhje Gjithëshqiptare kundër zgjerimit të Bullgarisë në tokat shqiptare. Dhe, derisa konsulli vjenez në Shkodër, Lippich, më 7 prill 1878, fliste për një "Lëvizje popullore në kuptimin e shquar të fjalës", më 11 maj 1878, do të informojë për zgjerimin e lëvizjes në vise të Dibrës, të Matit, të Gjakovës, të Pejës, të Prizrenit, të Gucisë, të Beranës, të Rozhajës, të Bjellopoles dhe të Sjenices - "kundër aneksimeve bullgare - serbe - malazeze, të stipuluara në Traktatin e Shën - Stefanit".

Nga të dhënat del se Muderriz Ymer Prizreni e hartoi Memorandumin e banorëve të Prizrenit, të 12 majit 1878, drejtu-

ar përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha në Stamboll, ku midis të tjerash, thuhej: "Jemi të informuar me hidhërim të madh, nëpërmjet gazetave, se disa pjesë të krahinës sonë të cilat janë të populluara me gegë, do t'i bashkohen Serbisë, Malit të Zi ose do të përfshihen nga ana e Bullgarisë së re.

Serbet dhe bullgarët, të cilët i kanë okupuar disa kaza të Vilajetit tonë i kanë dhunuar familjet tona, e kanë cenuar nderin dhe pasurinë tonë. Faltoret dhe varrezat tona janë poshtëruar dhe rrënuar; varrezat e të parëve tanë janë çnjerëzuar..."

Ndërgjegjësimi i lëvizjes politike e luftarake shqiptare do ta detyrojë përfaqësuesin francez në Shkodër ta informonte Parisin, më 17 qershor 1878, se "Lidhja, që formohej nga banorët myslimanë të Shqipërisë së Sipërme kundër çdo lëshimi ndaj Malit të Zi, është sot një fakt i kryer. Delegatët nga të gjitha rrethet janë mbledhur në Prizren dhe po krijojnë Komitetin Qendror..."

Meqë tashti Perandoria Osmane, për ta ruajtur Stabollin, Boforin dhe Mesdheun ishte e

“

Historia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është shpalosur dhe është studiuar nga studiues të huaj e shqiptarë. Objektiviteti i historishkruesve të saj është në vartësi dhe në përputhshmëri me qëndrimin antiislam dhe antishqiptar të qarqeve prej nga vinin studiuesit. Madje në periudhën e sundimit të njëmendësisë komuni-ste u krijua një klishe e paraqitjes me ndikim edhe sot, e veçanë-riht u hesht, u neglizhua dhe u nëpërkëmbë roli mobilizues i fesë Islame dhe i Myderriz Ymer Prizrenit në Lidhjen Shqiptare.

detyruar t'i plotësonte kërkesat e Traktatit të Kongresit të Berlinit në dëm të Njësisë Etnokulturore e Gjeopolitike të Shqipërisë, Forcat mendore e ushtarake të Lidhjes Shqiptare, pra pjesa më e madhe myslimane, i dha botës mesazhe politike e luftarake se para interesit jetësor të kombit shqiptar nuk njih interes tjetër. Këtë qëndrim sublimonte qartë Fetfaja e Myderriz Ymer Efendi Prizrenit, themeluesit dhe mbarëvajtësit jetësor të Lidhjes Shqiptare 1877-1887: "Çdo shqiptar asht i detyrueshëm me luftue kundër ushtrisë turke, mbasi Turkija don me ja lëshue tokën shqiptare shk-jaut".

INTELEGJENCA SHQIPTARE

E pathyeshme dhe dinjitoze mbi këtë kërkesë do të tregohet veçanërisht pjesa më e ditur nga radhët e inteligjencies shqiptare islame. Të përmendim këtu vetëm vigjilencën dhe guximin patriotik të Myderriz Salih Efendisë së Ulqinit, i cili duke u ngritur kundër Fetfasë së Shejh-Ul-Islamit, që i lejonte Sulltanit të përdorte forcën kundër mbrojtësve të Ulqinit. Ai u thërriti "botërisht myslimanëve se, sipas fesë islame, nuk ishte mëkat por

detyrë e shenjtë të luftonin për mbrojtjen e atdheut, qoftë edhe kundër Sulltanit-Kalif".

Mesazhin historik të Fetfasë së Myderriz Ymer Prizrenit e përjetësoi kënga popullore për Ymer Efendi Prizrenin: "Kush ja jep Mbretit ni plum", ku midis të tjerash, thuhet: "Efendi, na çka me ba, /A ban turkut (mysliman-it-M.P.) pushkë m'i ra?/ Myderrizi kish pas thanë:/ - Kur asht fjala për Vatan,/ Jo veç turkut e ati tjetrit,/ Po ni plumb kush ja jep Mbretit,/ Ka me shkue në lula të xhenetit!"

Të gjitha xhamitë, të gjitha medresetë, të gjitha teqetë u kthyen në vatër të veprimtarëve e të luftëtarëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Mesazhet nga dy Fetfatë dhe kënga e cituar, krahas plumbave që iu dhanë misionarit të Portës së Lartë, Mmehmet Ali Pashë Maxharrit, në Gjakovë, ua morën nga duart adutin kishave dhe diplomacive ruse, evropiane e ballkanike, të cilat sa e sa herë bënë turrë, tinës e hapur, për ta kualifikuar Lidhjen Shqiptare si fundamentaliste islame kundër krishtere dhe si instrument të Sulltanit për të penguar planet ruso-evropiane kundër copëtimit të Perandorisë Osmane në Ballkan.

Këtu duhet të theksohet fakti se nga truri politik e ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të përkatësisë fetare Islame, dolën të thuash të gjitha iniciativat dhe veprimet për ruajtjen e unitetit politik kombëtar shqiptar të elementeve me përkatësi islame, ortodokse e katolike, si dhe shumica e dëshmimeve politike dhe programatike relevante për unitetin politik të popullit shqiptar drejtuar Kongresit të Berlinit dhe qarqeve diplomatike e publicistike ndërkombëtare. Edhe në Memorandumin e Pashko Vasës, të Komiteteve të Arbëreshëve, dhe të mjedisëve të krishtera, ishte e pranishme dora e kokave shqiptare islame në Stamboll, në Janinë, në Shkodër, në Manastir,

në Shkup, në Podgoricë e gjetkë. Rilindësit nga lagjja ortodokse: De Rada - Dora D'Istria-Vretoja-Kullurioti, si edhe shtypi botëror, kryesisht u bënë jehonë vetëm opini-o-neve politike të mendjeve të shquara myslimane të Lidhjes Shqiptare në Atdhe.

Elementi shqiptar ortodoks dhe katolik i ndikuar nga propaganda kishtarë e diplomatike ballkanike e evropiane antiislame, në të gjitha fazat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit qëndroi bukur indiferent. Pati edhe raste të mbajtjes së qëndrimit armiqësor pro austro-hungarez dhe proitalian në Veri, apo progrek në Jug. Madje mund të konstatojmë se shumë ftohtë, deri në dezertim nga qenia shqiptare dhe Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, vazhdonte të mbetej elementi shqiptar ortodoks në viset e Toskërisë ku pretendonte Greqia. Asnjë prift ortodoksë nuk iu bashkua komiteteve të Lidhjes Shqiptare, asnjë kishë ortodokse nuk i hapi dyert për veprimtarët e Lidhjes Shqiptare. Kjo qartë pasqyrohej edhe në raportin e Furnié-s, agjent konsullor i Francës në Artë, i cili, pas udhëtimit hetimor të frymës politike e kombëtare të banorëve të viseve të Artës-Prevezës, shkroi, më 15 tetor 1879: "Në të gjithë fushën e Fanarit flitet më shumë shqip sesa greqisht dhe, në përgjithësi, fanariotët konsiderohen shqiptarë të krishterë pak të përzierë me elementin grek. Sidoqoftë, cila-do që të jetë raca (kombësia) në të cilën bëjnë pjesë, konstatova se, në kundërshtim me thëniet e krerëve të Lidhjes Shqiptare (myslimanë-M.P.), ata kanë simpati vetëm për Greqinë".

As priftëria dhe paria katolike në Gegëri nuk mori pjesë në komitetet e Lidhjes Shqiptare. Ata ishin komprometuar para popullit shqiptar në përgjithësi me Kryengritjen e Mirditës të vitit 1876, të nxitur nga Rusia, me ndihmë të drejtpërdrejtë të Malit

të Zi, të Serbisë dhe të Komiteteve të Garibaldit në Itali. Në komitetet e Lidhjes në Prizren e Shkodër pati edhe përfaqësues të katolikëve, por jo nga qarqet intelektuale. Asnjë kishë katolike nuk i hapi dyert për veprimtarët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

PROPAGANDA

Kundër definimit qartë kombëtar shqiptar të Lidhjes së Prizrenit, përpos ndërhyrjeve të fshehta e të hapëta të Portës së Lartë dhe të Malit të Zi, vepronin propagandat katolike austriake e italiane. Qysh më 15 qershor 1878, në kohën kur Kuvendi Themelues i Lidhjes po debatonte për aktet themelore programore dhe statusore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kapedani i Mirditës, Prenk Bib Doda, në krye të 58 bajraktarëve katolikë, i shkroi Kongresit të Berlinit një telegram me të cilin kërkonte sigurimin e autonomisë ekzistuese, osmane, të Mirditës, duke potencuar se "mirditasit si shqiptarë të besimit katolik i kanë disa veçori, të cilat prora janë respektuar edhe se edhe në të ardhmen ato duhet të respektoheshin".

Sipas shënimeve të adjutantit të Bismarkut, "shumë nga delegatët e kongresit treguan interesim dhe kërkuan që (telegrami i Dodës) të lexohet. Posaçërisht për të u interesuan austro-hungarezët dhe italianët. Edhe anglezët dhe francezët nuk qenë gjithaq të painteresuar për të." Më 18 qershor 1878, krerët e popullsisë katolike të Mirditës, të Pukës, të Kthellës, të Malësisë së Lezhës e të Lurës, shkuan edhe më larg, kërkuan nga Fuqitë e Mëdha që Kongresi i Berlinit të parashihte autonominë e viseve "të tyre" nën drejtimin e "kryetarit tonë shumë të dashur, të natyreshëm dhe trashëgimtar, Prenkë Bib Dodës". Mirëpo, Kongresi i Berlinit aprovoi autonominë tradicionale osmane, që përputhej me kërkesën e kreut Bib



Doda. Në Protokollin 13 të kongresit u saktësua se: "popullatat e Mirditës do të vazhdojnë të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që zotërojnë ab antique".

Të shtyrë nga propaganda austro-hungareze, katolikët e viseve të Gjakovës morën pjesë masivisht në mbrojtjen e misionarit të Portës së Lartë, Mehmet Ali Pashë Maxharrit, i cili kishte ardhur për të përgatitur terrenin për dorëzimin e Plavë-Gucisë Mali të Zi. Me forcat e Lidhjes Shqiptare në Gjakovë u përballë edhe famullitari i Zymit, Fra Pjetri me Tonin, birin e Prenk Gulisë, muselim ky i Gjakovës për katolikët. Një burim thotë se në mbrojtje të Pashë Maxharrit: "Përveç krerëve të përmendur dhe Hoshi i Nures" morën pjesë edhe "nja 300 djem katolikë të Fanit të Mirditës. Të gjitha këto u organizuan me një strategji të përgatitur më parë me qëllim të përçarjes Lidhja".

Vërtet, konsulli francez A. Lé Ré në Shkodër, më 6 tetor 1879, informonte Parisin se propaganda vjeneze kishte arritur që elementin katolik të viseve të Gjakovës ta mbante larg Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në lidhje me këtë element qëndronte konsulli vjenez Lippich, i cili i ftonte shqiptarët katolikë "të kenë durim", sepse "brenda disa muajsh ata do të çliroheshin nga një fuqi e huaj"!?! - pra nga Austro-Hungaria, të cilën shumica absolute shqiptare myslimane e konsideronte okupatore të padëshirueshme.

Të shtojmë edhe këtë fakt: Vjena, në periudhën e Lidhjes Shqiptare, Prizrenin e bëri qendër të propagandës austro-hungareze krahas Shkodrës, në dobi të planeve për shtrirjen e Austro-Hungarisë në tërë Gegërinë, aspiratë kjo e mirëpritur nga shumica e shqiptarëve katolikë. Kjo propagandë në Prizren do të mbështetet hapur në tregtarin Balto Tarabullusi, i vendosur këtu kohë më parë. Ai e dinte gjermanishten, ndaj ishte marrë për përkthyes (dragoman) në konsullatën austro-hungareze. Meqë kryente detyrën e informatorit dhe të spionit në dëm të bashkimit shqiptar pa dallim feje, Komiteti Qendror i Lidhjes vendosi ta likuidojë. Këtë detyrë do ta realizojë Ramadan Zaskoci, më 12 gusht 1880, duke e vrarë në shtëpi, së bashku me gruan.

Se elementi katolik në Gegëri nuk ishte i vullnetit t'i bashkohej Lidhjes Shqiptare në unitet të plotë me shumicën shqiptare myslimane e hetoi qartë edhe bullgaro-serbi antishqiptar, Jovan Haxhi Vasileviq, i cili ka konstatuar se: fillimisht "edhe vetë shqiptarët veriorë nuk e kuptuan njësoj Lidhjen dhe detyrat e saj. Derisa flitej për dorëzimin e Plavës dhe Guçisë Malit të Zi",



vende këto me shqiptarë myslimanë, "shqiptarët e krishterë (katolikë) nuk kanë dashur as të lëkunden kundër asaj". Do t'i bashkohën thirrjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, krahas shqiptarëve myslimanë, vetëm sapo do të rrezikohen tokat e banuara me katolikë në Hot, Grudë etj. Faktor mobilizues, tashti, ishte feja e krishtere katolike. Ndërkaq, shqiptarët ortodoksë në Veri të Vilajetit të Shkodrës: kuqët, palabardhët, pipërit etj., sipas Spiridon Gopçeviqit, do të bashkohën me Malin e Zi pa kundërshtim kundër Lidhjes. Faktor mobilizues në këtë drejtim ishte feja e krishterë ortodokse. Dhe, sapo do të largohet rreziku i copëtimit të Hotit e të Grudës, në thirrjen e Komitetit të Lidhjes Shqiptare në Shkodër për mbrojtjen e Ulqinit do të përgjigjen vetëm burrëria shqiptare myslimane, kurse shqiptarët katolikë do të tregohen "të pasigurtë", Prenk Bib Doda më nuk do të lëvizë fare, ndërkaq "Malësorët" thirrjes së Lidhjes Shqiptare "iu përgjigjen me diplomaci", e "Kelmendët u tërheqën plotësisht" në guackën e tyre.

Meqë përpjekjet luftarake dhe diplomatike ruso-evropiane për dekompozimin dhe grabitjen e tokave të Perandorisë Osmane në fakt ishte aleancë e krishterë kundër ardhmërisë së islamit në botën myslimane, përkrahja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për rezistencën boshnjake kundër okupimit Austro-Hungarez të Bosnjës dhe Hercegovinës ishte në fakt përpjekje shqiptare për ta ruajtur tërësinë e njësisë kulturore dhe gjeopolitike historike të Shqipërisë, aq më parë pasi boshnjakët në shqiptarët, thënë më së buti, shihnin vëllamët besnikë. Mbështetja e rezistencës boshnjake kundër okupimit antiaustro-hungarez realisht ishte Luftë e Lidhjes Shqiptare për ti pritur sa më larg pretenduesit serbë, malazias, austro-hungarez dhe italianë që synonin viset e Vilajetit të Kosovës dhe të Shkodrës.

TABANI HISTORIK

Kërkesa e shumicës absolute

shqiptare për bashkimin e armëve me boshnjakët, në luftën për ekzistencë kombëtare e fetare, kishin mbështetjen e fortë në tabanin historik të lidhjeve të moçme shpirtërore dhe luftarake midis shqiptarëve e boshnjakëve. Ata i lidhte gjaku ilir, jeta shtetërore shekullore osmane e përbashkët, feja islame, kujtesa historike nga cikli i këngëve të kreshnikëve: Mujit e Halilit, Tale Budalinës, Gjergj Elez Alisë e Arnaut Osmanit, traditat e ngjashme kulturore, perceptimet psikologjike të përafërta, vlerat shpirtërore shumë identike, lidhjet martesore të qëndrueshme, lidhjet etnike shqiptare dhe të gjakut, miqësitë tradicionale, interesat ekonomike, ndjenja e sigurisë së njërit pranë tjetrit, interesat gjeo-politik shtetëror. Boshnjakët pranoni kornizën shtetërore në kuadër të Shqipërisë, pranonin shtetësinë shqiptare.

Këto Kërkesa sublimonte edhe Nenit 16 i Kararnames të aprovuar nga Kuvendi Themelues i Lidhjes së Prizrenit, më 17 qershor 1878, e cila kishte domethënie të madhe për interesat e kombit shqiptar, veçanërisht shikuar konstelacionin e forcave të implikuara në Çështjen Shqiptare aso kohe dhe më vonë. Në dokument, midis të tjerash, thuhej: "Në përputhje me vendimin e Lidhjes, me besën e lidhur dhe me situatën e pastajme, ne, përfaqësuesit e trimave të pathyeshëm të Gegërisë, të Toskërisë dhe të Bosnjës, të cilët qysh kur u lindën nuk njohën tjetër mjeshtëri përveç asaj të armëve dhe të cilët qenë gati ta derdhin gjakun për Perandorinë dhe atdheun, kemi zgjedhur për kryeqytet tonë Prizrenin, dhe, pasi jemi bashkuar fatbardhësisht, tani e tutje nuk do të lejojmë kurrë, që ndonjë sundimtar të na tiranojë e shtypë banorët e atdheut tonë. Këtë nuk do ta lejojmë në asnjë mënyrë, në asnjë kohë dhe pavarësisht nga rrethana-nat...". Mbi këtë platformë politike e luftarake Këshillit Qendror i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 5 gusht 1878, mori vendimin edhe "për angazhimin e një pjese të forcave luftarake

përkrah forcave boshnjake".

Këtu duhet të konstatojmë edhe këtë fakt: Shteti që do të lindte nga Lidhja e Prizrenit do të sillte në fuqi Ligjin që garantonte diversitetin kulturor e fetar shekullor, liritë individuale dhe kolektive, sigurinë e jetës dhe të mirëqenies dhe paprek-sh-mërinë e pronës dhe të dinjitetit njerëzor, barazinë midis mysli-ma-nëve dhe të krishterëve. Ky ishte "Sheriati".

Vendimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për kthimin e "Sheriatit" në gjyqë ishte akt politik largvajtës që kishte për qëllim anulimin e ligjeve të proveniencës politike evropiane të krishtera antiislame, të Tanzimatit, të cilat krijuan rrëmujën e panjohur në Perandorinë Osmane, të cilat goditën njëninë e Njësisë etnokulturore e gjeopolitike të Shqipërisë. Ato krijojnë hapësirë për krijimin e oazave autonome të rajoneve sipas përkatësisë së fesë, duke i dhënë përparësi getoizimit të mjediseve katolike e ortodokse në mjediset shqiptare ku myslimanët ishin pakicë. Me "Sheriatin" ruhej uniteti i vendit dhe ruhej harmonia konfesionale shqiptare e domosdoshme për përballimin si unitet, të aspiratave separatiste të elementeve të krishtera jo shqiptare të përkrahura nga Rusia, Anglia, Austro-Hungaria, Gjermania, Italia, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi, Greqia etj. Kombi shqiptar dhe Shqipëria ishin në luftë për ekzistencë, ndaj duhej unitet mbi aspirata të kombësisë me prani të diversitetit fetar shekullor, duhej forcë dhe ndërgjegje shtetformuese kombëtare.

Vërtet, Lidhja Shqiptare e Prizrenit e projektuar nga truri shqiptar mysliman, me përpjekjen maksimale të trurit dhe të masave shqiptare myslimane u mbajt në jetë si Lidhje Kombëtare Gjithëshqiptare dhe përfundimisht truri dhe gjaku shqiptar mysliman i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u përball përfundimisht me mizoritë e ushtrisë anadollake turke në prill dhe në maj të vitit 1881.

Themeluesi dhe kryetari i parë dhe i vetmi i Shqipërisë Etnike, Myderriz Haxhi Ymer Efendi Prizreni me bashkëvep-rim-tarët, themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryesisht ulema, intelektualë dhe krerë të dalluar, i treguan botës dhe Portës së Lartë se Shqipëria nuk është miraz i Perandorisë Osmane që duhet ndarë nga të tjerët, se ekziston kombi shqiptar i konsoliduar politikisht dhe ushtarakisht, se tërësia e Shqipërisë në shtrirjen e katër vilajeteve osmane: Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë, është amanet i shqiptarëve dhe jo i Sulltanit, i cili kishte kohë që në sytë e kombit shqiptar përjetohej si sovran dhe halif i padëshiruar

Hafiz Ali Korça

Vajtimet e Atdheut

(Kushtuar bombardimit të Drenicës nga Serbët
në Qershor 1924)

Më s'tu nda zjarri, më s'tu nda flaka
Më s'tu nda vrasja, ndjekja, shuplaka,
Më s'tu nda therja, mbytja grabitja,
Më s'tu nda shtypja, vajtja, drobitja.

Gra, burra, foshnja për ditë vriten,
Nga vendi vet zhveshur po qiten;
Digjen katundet e përvëlohen,
Ah, shpirti më këputet, prej kujt s'ndalo-
hën.
U germadhove, u copëtove,
Krejt u trondite krejt u shkretove.

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Qytetërimi ku asht vallë?
Përse Europa nuk i sheh hallë?
Si s'po dëgjohet topi i shkretë?
Si s'shihet flaka qi del mbi retë?
Si nuk dëgjohet rënkimi i shpirtit?
Pse s'këshillohet kombi gjakpirës?
Në botë, thua, s'ngeli bamirës.
Qysh u shurdhua bota e terë?
S'shohin barbari gjer sot ç'ka berë

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Me top u shuan vëllezërit tanë,
Malet dhe fushat ndër gjak i lanë.
I vranë, i shuan, i handakosën.
Në vend të tyre tjetër vëndosën.
Sa pasuri që patën ua perlanë.
S'di me ç'të drejtë dreqvet ia dhanë!
Më digjet shpirti, kam shumë frikë,
Se do t'i sosje kjo politikë,
Fill shqiptari nuk do te lenë?
Fatzijtë e gjorë ku do te vejnë?

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Në këtë shekull kjo politikë
Mrekulli, quhet e them pa frikë,
Kjo politikë racëmbaruese
Për ditë grin pleq, trima, nuse
Kjo politikë lugate shtrigë
Dhëlpër dinake, kuçedër e ligë
Faroj vëllezër me qindra mijë
I madh i Vogël duhet ta dijë
Fol, o moj botë e qytetërimit
Përse po shkulet kjo racë e trimit.

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Kosovë e bukur, oj shpresa jonë
Bujare, trime, ke qenë si i thonë
Sot të zu halli, në zgjedhë ngele,
Kurban po bëhesh për ditë si dele.
Kurban po bëhesh ditë bajrami,
Në Ballkan therret veç shqiptari.
Kështu pse s'duket Xhebraili?
Të të shpëtonte nga thojntë e mprehtë
Të të shpëtonte nga zjarri i nxehtë
Ty moj Kosovë, e madhe shpresë

Se ndaj ty ruhet edhe sot besa,
M'i madhi krahu i Shqipërisë!
M'e madhja çerdhe e Trimërisë!

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Pjesa më e madhe e Shqipërisë
Iu dha Serbit e Greqisë
Vetëm i ardhni keq Perëndisë
Për atë gjakun e foshnjërisë,
Dua t'i lutem pak qeverisë
Të marrë masat e ligjësisë:
T'i lutet Frances dhe Anglisë
T'i pritët hovi pake Serbisë
Dhe për Çamërit, fqinjë të Greqisë.

Qani Kosoven dhe Çamerinë
Për gjëmëzëzet zgjatëni zinë!

Nip i Pellazgut, o komb i vjetër!
Nga ti m'i i vjetër nuk ndodhet tjetër,
Dyzet ke patur milione frymë
Te pakoi koha, te çkriu si brymë.
Le Arijanen, Durrës u mbështete,
Nga fati i shkrete si nje grusht mbete.
Edhe këtuze shprehje nuk gjete.
Mento ku ishe, ku je, ku vete,
Tashti pa krahe ke mbetur fare
Për një të vjetër komb, turp e marre

Qani Kosoven dhe Çamerinë
Se i këmbëjnë si bagëtinë!

Ka vdekur fare civilizimi;
Sot veç një lustër ka Perëndim.
Iku mëshira erdhi rrënimi!
Po del mbi qiejt nga do rënkimi,
Në fund te tokës hyfte gëzimi!
Kur po shfaroset një komb ma trimi,
Kurse ka vdekur krejt njerëzimi,
Kurse nuk paska babë a vëlla jetimi,
Fare mos qoftë shtypi dhe shkrimi!

Qani Kosoven dhe Çamerinë
Për gjëmëzëzet zgjatëni zinë!

Mos i ndaj lotet, qaj Vardar plaku!
Nat'e ditë ecën të lahet gjaku
Gjaku i shenjtë që derdh barbari,
Me te ushqehet sot çdo fill bari,
O shale i shkretë, qysh duron valle?
Pse nuk po shkrihesh, qysh je i gjal-
lë?
Shembuni male, mbetët te shkretë!
Shembuni bashkë me gjithë tepetë!
Kur komb bujari për ditë po shuhet,
Ty, moj Kosovë, jeta ç'të duhet?
Kur dhe Evropa s'po ta sheh hallin
Për ditë ju therin, ju marrin mallin
Për ditë ju derdhet gjaku
Shpresa ka mbetur vetem te Hakku.

Qani, vëllezër, Kosovën, qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani!

Tiranë, Gusht 1924

